



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË
KOSOVËS, E MBAJTUR MË 28 MARS 2013**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 28. MARTA 2013. GODINE**

**MARS - MART
2013**

Rendi i ditës

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme,
4. Raportimi i kryeministrit të Kosovës, z. Hashim Thaçi, për takimin e tij të shtatë me kryeministrin e Serbisë në Bruksel,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për transplantimin e indeve dhe qelizave,
6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ansamblin kombëtar të këngëve dhe valleve “Shota” dhe për ansamblet tjera,
7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për veprimtari kërkimore-shkencore, inovacione dhe teknologji,
8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për sigurinë e përgjithshme të produkteve,
9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për minierat dhe mineralet,
10. Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës,
11. Formimi i Komisionit Hetimor Parlamentar, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të LDK-së, mbështetur edhe nga deputetë të tjerë,
12. Zgjedhja e nënkryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës nga radha e komuniteteve joshumicë.

Dnevni red

1. Vreme za deklarisanja izvan dnevnog reda,
2. Vreme za parlamentarna pitanja,
3. Usvajanje zapisnika sa prethodne sednice,
4. Izveštavanje premijera Kosova, g. Hashim Thaçi, o njegovom sedmom susretu sa premijerom Srbije u Briselu,
5. Prvo razmatranje Nacrta zakona o transplantaciji tkiva i ćelija,
6. Drugo razmatranje Nacrta zakona o Nacionalnom ansamblu pesama i igara "Shota" i za druge ansamble,
7. Drugo razmatranje Nacrta zakona o istraživačkim i naučnim delatnostima, inovacijama i tehnologiju,
8. Drugo razmatranje Nacrta zakona o izmeni i dopuni Zakona o opštoj sigurnosti proizvoda,
9. Drugo razmatranje Nacrta zakona o izmeni i dopuni Zakona o rudnicima i mineralima,
10. Formiranje Ad - hok komisije za selekciju članova Borda Radiotelevizije Kosova,
11. Formiranje Parlamentarne istražne komisije, po zahtevu Parlamentarne grupe LDK, podržane i ostalih poslanika,
12. Izbor potpredsednika Skupštine Republike Kosova iz redova nevecinkse nacionalnih zajednica.

Seancën e drejtoi kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
Të nderuar zëvendëskryeministra,
Ministra të Kabinetit qeveritar,
I hap punimet e mbledhjes plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës sipas rendit të ditës, të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit me kryetarët e grupeve parlamentare.

Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës:

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Diskutimet në emër të grupit 5 minuta, në emër të deputetit 3 minuta. Replika nuk ka. Fjalën në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike e ka deputetja Flora Brovina.

FLORA BROVINA: Faleminderit, i nderuar kryetar!
Përshëndetje Kabinet qeveritar,
Zëvendëskryeministra, ministra, deputetë dhe deputete,
Në emër të Partisë Demokratike të Kosovës, të Grupit Parlamentar dhe në emrin tim personal distancohem nga akti i dhunshëm që u bë kundër aktivistes së “Vetëvendosjes”, një aktivisteje të shquar, e cila ishte në të kaluarën anëtare e Lidhjes së Gruas Shqiptare, pastaj kryetare e Gruas së Partisë Demokratike dhe pasi ndërroi parti u bë udhëheqëse e Gruas në “Vetëvendosje”.

Ne sigurisht që pajtohemi dhe jemi të interesuar për të gjitha gratë e abuzuara gjatë luftës dhe punojmë së bashku vazhdimisht. E dimë se zonja Nazlie ka marrë pjesë edhe si dëshmitare në Gjyqin e Hagës, prandaj u bashkohemi gjithë aktivitetëve që ajo ka në mbrojtje të gruas së dhunuar në Kosovë, si një akt kundër njerëzimit. Ne, edhe një e herë e përsëris, distancohem nga ky akt dhe e shohim si një akt barbar, për të cilin nuk ka asnjë diskutim.

Me akte të tilla nuk zgjidhen çështjet dhe mendojmë se çështja e grave të abuzuara ka rrugëzgjidhje. Kemi plan konkret për t’u dalë në ndihmë këtyre grave edhe një herë Nazlies i dëshirojmë shërim të shpejtë dhe aktivitet të ndershëm. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, fjalën e ka deputetja Afërdita Berisha-Shaqiri.

AFËRDITA BERISHA-SHAQIRI: I nderuar kryetar,
Kabinet qeveritar,
Të nderuar deputetë,
Të nderuar qytetarë të komunës së Dragashit,
Sipas “Alsat-Makedonija”, më 28 shkurt 2013, drejtori i Agjencisë së Rrugëve të Maqedonisë ka porositur studim fizibiliteti për ndërtimin e aksit të ri të rrugës Tetovë-

Prizren. Studimi duhet të jetë gati deri në fund të marsit. Rruga e re do të jetë më e shkurtër sesa ajo ekzistuese.

Nga ky studim fizibiliteti pritet të shihet nëse ka apo jo leverdi nga një aks i tillë rrugor, që do ta lidhë Tetovën me Prizrenin. Duke u nisur nga ky lajm, e shfrytëzoj rastin të kërkoj nga Qeveria e Kosovës, respektivisht nga ministri i Infrastrukturës, zoti Mujota, një bashkëpunim me Agjencinë e Rrugëve të Maqedonisë, me Komunën e Prizrenit dhe me Komunën e Dragashit që rruga t'i përshkojë fshatrat boshnjake, do të thotë komunën e Prizrenit, Zaplluxhën, komunën e Dragashit, pastaj ajo duhet të lidhet me Gurin e Zi, atje ku terrenet janë madhështore dhe qendra për skijim si zona strategjike për turizëm. Rruga pastaj duhet të vazhdojë për në Veshallë, afër kufirit me Maqedoninë.

Një projekt i ngjashëm kishte filluar të realizohet në mbështetje të kryetarëve të komunave fqinja, Qeverisë dhe bashkësisë ndërkombëtare në vitin 2007. Në përgatitjen e shtegut të kësaj rruge janë derdhur 3,5 milionë euro. Sot rruga e pashtuar u kthye në gjendjen fillestare të saj, hotelet vazhdojnë të jenë të zbrazura dhe të papërfunduara, ndërsa qendra për skijim mbetet ende e largët.

Ky projekt, i cili do të ishte damar i zhvillimit të këtij regjioni do të mundësonte lidhjen e Opojës, komunës së Dragashit dhe Prizrenit me Tetovën dhe viset të tjera të banuara me shqiptarë në Maqedoni.

Po ashtu, kjo rrugë i plotëson kushtet për një zhvillim të qëndrueshëm të këtij regjioni, duke i shfrytëzuar bukuritë natyrore dhe terrenet te Guri i Zi, që janë të shkëlqyeshme dhe më të përshtatshme se terrenet e Brezovicës.

Po ta bëj një krahasim, në sezonin e dimrit më shpejt arrihet nga Prishtina për në Prizren, se sa nga Opoja për në Prizren, edhe pse në vijë gjeografike Prishtina e Prizreni janë shumë më larg, krahasuar Opojën me Prizrenin.

Këtë çështje në këtë Kuvend po e ngre për të dytën herë, duke shpresuar që kryeministri, Qeveria dhe ministri Mujota do ta mbështetin këtë projekt sepse të paktën këtë rrugë do ta kalojnë të gjithë qytetarët, pa marrë parasysh se cili subjekt politik i takojnë.

E di që ky projekt e ka përkrahjen e komunitetit, prandaj nevojitet vetëm një mbështetje më e madhe nga institucionet qeveritare që të përfundojë sa më parë. Pozicioni gjeografik ua bën më të vështirë ekzistencën këtyre qytetarëve, prandaj të mundohemi që ne t'ua përmirësojmë atyre jetën. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të “Vetëvendosjes”, fjalën e ka nënkryetari Glauk Konjufca.

GLAUK KONJUFCA: Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Mbrëmë, rreth orës 20:30, u sulmua fizikisht aktivistja shumëvjeçare dhe drejtuesja e Sekretariatit të Gruas Aktiviste në Lëvizjen “Vetëvendosje”, zonja Nazlie Balaj. Ajo u sulmua në hyrjen e banesës së saj.

Një akt i tillë nuk është kurrësi ndonjë incident i izoluar personal, por paraqet zhvillimin e një krimi të planifikuar me prapavijë politike.

Gjithçka filloi pas kalimit në këtë Kuvend të ligjit për njohjen institucionale të statusit të viktimave të dhunës gjatë luftës, për të cilin zonja Balaj e ka dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm.

Ajo që na bën edhe më shumë të jemi të bindur se pas këtij sulmi qëndron motivi politik, është edhe kërcënimi që erdhi nga Zyra e Kryeministrit pas pjesëmarrjes së zonjës Nazlie Balaj në një emision në Radiotelevizionin e Kosovës.

U kërcënua drejtuesja e emisionit me arsyen pse e kishte ftuar Nazlie Balajn në emision. Po ashtu, Nazlie Balaj para një jave e kishte gjetur një letër të vendosur në derën e banesës së saj, nëpërmjet së cilës kërcënohej me vdekje për shkak të ligjit për viktimat e dhunës.

Ne jemi të bindur se gjuha e ashpër kundërshtuese e disa deputetëve të pushtetit këtu ndaj kësaj nisme ligjore, është sinkronike me kërcënimin dhe dhunën fizike ndaj drejtueses së Sekretariatit të Gruas Aktiviste, Nazlie Balaj, dhe kërcënimet edhe ndaj drejtueses së emisionit “Kërkim” në Radiotelevizionin e Kosovës, Edona Hajrullahu.

Një akt i tillë është frymëzuar nga ligjërimi i pashembullt përçmues i zyrtarëve të pushtetit ndaj viktimave të dhunës gjatë luftës.

Nazlia, në emisionin në RTK kishte paraqitur fakte, dëshmi, e të dhëna për çështjen e dhunimeve, si dhe kishte shpalosur qëndrimet e Lëvizjes “Vetëvendosje” në lidhje me këtë çështje.

Nazlie Balaj është aktiviste e Lëvizjes dhe qëndrimet që ajo i ka shprehur në këtë emision janë qëndrime të “Vetëvendosjes”.

Prandaj, kërcënimet dhe sulmin fizik i konsiderojmë si kërcënime dhe sulme kundër Lëvizjes “Vetëvendosje”.

Nisur nga kjo, pavarësisht deklarimeve formale se e dënojnë aktin e kërcënimit, ne e mbajmë si frymëzues dhe si përgjegjës për këtë që po ndodhë kryeministrin dhe këta deputetë që i përmenda.

Këto kërcënime dhe akte të dhunshme kurrësi nuk do të na ndalin në rrugën tonë për vendosjen e drejtësisë lidhur me gratë, burrat dhe fëmijët e dhunuar gjatë luftës së fundit në Kosovë.

Një seri ngjarjesh, të cilat e kanë karakterizuar vitin 2013, tregojnë se Kosova po hyn në një marrëdhënie të re ndërmjet pushtetit dhe shoqërisë. Ky relacion po bëhet gjithnjë e

më autoritar. Në fillim, keqpërdorën dhe u bënë milionerë, pastaj milionat po i shfrytëzuan për më shumë fuqi.

Kjo fuqi sot ndikon kush të punësohet në Kosovë e kush jo, prej pastrueses në shkollë, e deri te Banka Qendrore e Kosovës. Por, tash jemi në fazën kur familjet e tyre po ndihen aq më të fuqishme, më të fuqishme se shteti, sa jetojnë mbi ligjin dhe e rrahin edhe shtetin. Dhe tash, kush nuk pajtohet me ta, e kërcënojnë edhe nëpër hyrjet e banesave.

Zonja dhe zotërinj,

Ky është një hap larg përpara se të na hyjnë edhe brenda në familje.

KRYETARI: Në emër të AAK-së, fjalën e ka deputeti Burim Ramadani.

BURIM RAMADANI: Faleminderit, zoti kryetar i Kuvendit!

Të nderuara deputete dhe deputetë,

Krahas zhvillimeve tjera negative që po i shohim për çdo ditë, më lejoni ta kthejmë vëmendjen edhe te një problem që për ne është jashtëzakonisht i madh, sidomos gjatë javëve të fundit, e ka të bëjë me vjedhjet nëpër shtëpitë e qytetarëve të Kosovës anekënd vendit, të cilat janë shpeshtuar jashtëzakonisht. Për më keq, siguria ose mungesa e sigurisë publike definitivisht ka arritur në nivel shqetësues.

Janë shumë e shumë qytetarë të ndryshëm nga të gjitha anët e Kosovës, të cilët kanë kërkuar që ta ngremë këtë çështje në Kuvendin e Kosovës, por janë shumë e më shumë qytetarë dhe familje që janë vjedhur në shtëpitë e tyre, qoftë në mëngjes, qoftë në pikë të ditës, qoftë në mbrëmje.

Kjo nuk është asgjë më pak se sa shkelje e dinjitetit njerëzor dhe kjo nuk është asgjë më pak se sa dështim për të ofruar siguri për jetën dhe pronën e qytetarit.

Si është e mundur sot, në vitin 2013, po thuajse secila familje në Kosovë duhet ta mbyllë derën nga brenda gjatë tërë kohës? Edhe kur janë në shtëpi duhet t'i kenë dyert e mbyllura, sepse u hyjnë hajnat në shtëpi për t'i vjedhur.

Mund ta paramendoni se si ndihet një burrë, një grua dhe fëmijët e tyre kur e shohin se shtëpitë e tyre janë vjedhur edhe gjatë kohës kur kanë qenë brenda. Nuk janë të pakta rastet kur fëmijët nuk guxojnë të lëvizin lirshëm brenda shtëpisë së tyre për shkak se kanë marrë traumë nga vjedhjet që kanë ndodhur. Edhe çfarë po ndodh? Më gjatë intervistohet i dëmtuari sesa i dyshuari. Edhe në raste kur të dyshuarit identifikohen ose kapen, ata merren dhe lirohen pas 24 orëve, ose 48 orëve, ndërsa procedurat e të dëmtuarve shkojnë shumë më gjatë se kjo periudhë.

Duhet ta themi qartë dhe hapur se duhet t'i japim fund kësaj mungese të sigurisë për jetën edhe pronën e qytetarit.

Qytetari i Kosovës sot është i rrezikuar, jo vetëm prej papunësisë dhe mungesës së perspektivës, por edhe prej grabitjeve të armatosura, edhe prej armëmbajtjes pa leje, prej

aksidenteve të shumta me fatalitet, infrastrukturës së dobët rrugore, gjendjes teknike të automjeteve për shkak të kontrollit fiktiv që u bëhet këtyre, dhe moskoordinimit të aktorëve kryesorë institucionalë, në nivelin qendror dhe atë lokal.

Më lejoni të përsëris edhe një herë se ne besojmë se siguria e jetës dhe pronës së qytetarit është thelbi i ekzistencës së shtetit. Prandaj, kjo është detyrë primare, është detyrë e Qeverisë, e cila nuk krahasohet me motive tjera që po i shohim për çdo ditë. Shumë më mirë dhe shumë më e qëlluar do të ishte sikur Ministria e Punëve të Brendshme të kujdesej për sigurinë publike, sesa ta lejojë të nëpërkëmbët kështu, si me aferën e pasaportave dhe me skandale të njëpasnjëshme.

Është e qartë që ministri i Brendshëm nuk është këtu dhe besoj se të gjithë e dinë. Ministër, mirë se erdhe! E dimë që do të reagosh, të thuash nuk jap dorëheqje. E kemi të qartë se nuk ke dhënë dorëheqje për 1001 skandale deri tash. Besoj se mund ta shohësh edhe sigurinë e qytetarëve, edhe shtëpitë e tyre si asgjë hiç, por duhet ta keni të qartë se detyra juaj është siguria e jetës dhe pronës së qytetarëve. Prandaj, nuk e di çfarë po pritni. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka kryetarja e Koalicionit për Kosovë të Re, Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, kryetar!

Përsëritje për Kabinetin qeveritar dhe për deputetët,

Duke e parë rastin e mbrëmshëm të zonjës Nazlie Balaj dhe duke u nisur nga aktet më të larta të shtetit nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës, mund të themi se të gjithë qytetarët e Kosovës janë të barabartë para ligjit dhe si Koalicion për Kosovën e Re distancohemi nga rastet e dhunës, pavarësisht se për kënd është fjala, për zonjën Nazlie Bala, apo këdo tjetër, prandaj i ftoj organet e drejtësisë që sa më parë që të jetë e mundur ta zbardhin rastin, për arsye se Kosova është një shtet demokratik dhe në demokraci secili ka të drejtë ta shprehë mendimin e vet. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Shaip Muja.

SHAIP MUJA: I nderuar kryetar,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Spekulimet e tanishme që janë duke u bërë më kanë detyruar të dal në këtë foltore dhe njëherësh t'i ftoj organet e drejtësisë që të merren me rastin e zonjës Balaj, e cila ka qenë një aktiviste e devotshme e Partisë Demokratike të Forumit të Gruas dhe e cila nuk meriton që të jetë objekt i trajtimeve të interesave politike të formacionit politik të Lëvizjes "Vetëvendosje".

Prandaj, Lëvizja "Vetëvendosje" e ka huq rrugën dhe nuk po gjen metoda si ta krijojë identitetin e vet politik, duke devijuar edhe nga foltoret tona këtu, prononcimet tona, duke i devijuar edhe konkludimet, të cilat ne i kërkojmë për këtë kategori shumë sensitive edhe për të cilën kemi plan dhe kemi arsyeshmëri se si të trajtohet.

Ju e devijoni prononcimin tim për ekzaminim gjinekologjik. Ju jeni spekulantë, jeni analfabetë dhe joprofesionistë!

Unë kam kërkuar dhe është në procesverbalin trajtimin e PTSD-së. Quhet “Pos Trauma Sindroma”, për të cilën edhe ju jeni të goditur në këtë mënyrë, siç janë edhe ato tjerat. Ju duhet ta pyesni dikë çka është “Pos Trauma Sindroma” dhe pasta mund të vini në konkludim, të solidarizoheni me shoqatat, të cilat kanë prapavijë financiare nga institucionet e dyshimta. Prandaj, ju nuk mund të jeni kujdestar të kombit. Emisioni “Në kërkim” është emision i “Vetëvendosjes” në RTK. Këtë e dinë fort mirë këta që janë të ulur, kush ka intervenuar që të jetë ky emision dhe ky sinkronizim, i cili ka qenë i përgatitur disa muaj dhe, nëse doni, mund t’i japim edhe me emra. Prandaj, lërimi këto spekulime, le të merret drejtësia me zonjën Balaj dhe le të të zbardhet ky rast, e jo të merreni me spekulime, të cilat nuk janë të qëndrueshme. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Salih Morina.

SALIH MORINA: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Unë sot do ta ngre një çështje, e cila është shqetësuese pothuaj për tërë opinionin dhe për tërë qytetarët e Kosovës, sepse ka të bëjë me çështjen e operatorëve ilegalë, apo siç quhen ndryshe të seperacioneve të gurthyesve, me të cilët Kosova është një shembull shumë i keq në rajon dhe bile përtej rajonit, meqë po e dëmtojnë dhe po e degradojnë në përgjithësi ambientin dhe natyrën në tërë territorin e Kosovës.

Është shqetësuese pikërisht se ka të bëjë me banorët e fshatit Astrazub të komunës së Malishevës, ku në një afërsi të fshatit janë të vendosur katër operatorë, ku duke përpunuar, këta gurthyes po krijojnë pluhur të madh që po depërton drejtpërdrejt nëpër shtëpitë e këtyre banorëve dhe njëkohësisht po rrezikohet direkt shëndeti i qytetarëve.

Andaj, unë kërkoj nga ministri, i cili është i pranishëm këtu që t’i dërgojë inspektorët në terren për të parë numrin e operatorëve që, sipas siç thuhet sipas statistikave, janë në numër jashtëzakonisht të madh që nuk i plotësojnë kriteret dhe janë në kundërshtim me ligjet, sepse një operator i cili fillon ta përpunojë çështjen e këtyre gurthyesve duhet ta ketë pëlqimin mjedisor nga Ministria e Mjedisit, pastaj nga Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale licencë për shfrytëzim, nga Agjencia e Pyjeve pëlqimin për shfrytëzim dhe lejen e punës nga Komuna.

Këta operatorë nuk gjenerojnë vende të reja të punës, por thjesht kanë të bëjnë me përfitime profesionale të grupeve të interesit.

Prandaj, unë insistoј dhe kërkoј që çështja e tyre duhet të eliminohet dhe njëkohësisht ky numër i këtyre operatorëve ilegalë duhet të pengohet, e këtë mund ta bëjë vetëm ministria përkatëse, në bashkëpunim me autoritetet komunale në secilin territor të komunave, në përgjithësi, e veçanërisht në komunën e Malishevës, pasi ka të bëjë me rastin e fshatit Astrazub. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Afrim Hoti.

AFRIM HOTI: Faleminderit, kryetar!

Jemi dëshmitarë nga e kaluara se Qeveria e Kosovës ka ndihmuar shtete të ndryshme në raste emergjente, ndërsa më duhet ta ndaj një shqetësim të banorëve të Klinës, me saktë të disa zonave të prekura nga përmbytjet e fundit.

E dimë që natyra di të jetë e pamëshirshme, por e dimë se qytetarët e presin një minimum të sigurisë. Më 13 dhe 14 mars 2013, fshati Zajm i Klinës është përmbytur nga vërshimet e shkaktuara nga reshjet e mëdha të shiut.

Është përmbytur një pjesë e fshatit Grabanicë, rruga e Deiq-Poterc-Pataqan-Leskoc, kompleksi i hoteleve të Guri i Zi dhe lagjja 'Dukagjini', duke shkaktuar dëme të mëdha në ekonomitë familjare dhe në bizneset lokale, si në pajisjet shtëpiake, në bagëti, në hoteleri, në fabrikën AMO e tjera.

Atë ditë, një qytetar, të cilën duhet ta nderojmë të gjithë, e ka përdorur barkën e tij private për t'i evakuuar më se 35 familje që ngelën të ngujuara nëpër shtëpitë e tyre, ngase katet e para ishin të mbushura më ujë dhe se rreziku për përmbytje të mëtejme dhe rreziku i rrymës ishte real. Këto familje, përveçse të rrezikuara, ishin edhe pa kurrfarë përkrahjeje dhe mbështetjeje, pa ushqim dhe pa ujë të pijshëm. Këta qytetarë e kaluan natën në mëshirën e kohës. Të mos e përmendim emrin e këtij banori që u doli në ndihmë banorëve, por ai e meriton respektin e organeve të shtetit dhe falënderimet e secilit nga ne.

Presidentja shkoi atje pas disa ditësh dhe atë vetëm sa për ta bërë një fotografi, ngase nuk e vizitoi as edhe një familje të vetme. Edhe Qeveria e Kosovës veproi njëjtë. Kryeministri nuk doli me asnjë fjalë të vetme, e lëre ta vizitonte zonën e përmbytur dhe familjet atje. Nuk u ndihmua qytetari i Klinës, nuk u ndihmua qytetari i Pejës, as ai i Drenicës.

Ndërsa FSK-ja, edhe pse dihej që rajoni i Dukagjinit ishte i mbushur me ujë, në Klinë ndërhyri vetëm në orën 11:30, atëherë kur banori Faruk Raci me barkën e tij i nxori të gjithë anëtarët e familjeve nga shtëpitë e tyre.

Ndërsa Komuna e Klinës, e cila njihet për shpenzime enorme të parasë publike për dreka dhe derivate, nuk i ka plotësuar as gjërat më elementare, njësitin e ndërhyrjes, apo zjarrfikësit. Vetëm gjatë vitit 2012, Komuna e Klinës ka harxhuar 10 981,73 euro për telefon; për naftë për ngrohje qendrore 78 093,32 euro, për mirëmbajtje dhe riparim të veturave 26 627,48 euro dhe për darka zyrtare 27 246,70 euro. Dihet që zona në Zajm është në mënyrë permanente në rrezik, por nuk shihet që qeveria lokale ka plane preventive, por vetëm sanimin e pasojave me mbylljen e gojës, derisa qytetarët presin ndihmën...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Teuta Haxhiu.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

Çështja që dua ta ngre sot ka të bëjë me angazhimin e qeverisë lokale të Komunës së Gjakovës për zgjedhjen e statusit të Aeroportit Ushtarak të Gjakovës.

Unë në këtë rast nuk do të merrem shumë me Qeverinë për formimin e një komisioni për këtë çështje, por dua të ju them se dikujt i ka dalë vonë gjumi.

Në kohën kur kanë filluar shqyrtimet lidhur me mundësinë e dhënies së Aeroportit të Prishtinës me koncesion, më 28 korrik 2009, kryetari i Komunës së Gjakovës, doktor Pal Lekaj, u është drejtuar me shkresë zyrtare presidentit të Kosovës, Fatmir Sejdiu, kryeministrit Hashim Thaçi, dhe ministrit të Ministrisë së Transportit dhe Telekomunikacionit, zotit Fatmir Limaj, për mundësi të pezullimit të çdo procedure eventuale për dhënien me koncesion edhe të Aeroportit të Gjakovës dhe të përfshirjes së tij nën administrimin dhe menaxhimin e Aeroportit të Prishtinës.

Aeroporti i Gjakovës në të gjitha dokumentet strategjike, në planin hapësinor të Kosovës, si dhe në planin zhvillimor komunal është trajtuar si potencial për zhvillimin ekonomik.

Për më shumë, strategjia e zhvillimit hapësinor, sipas planit hapësinor të Kosovës, e parasheh territorin e Gjakovës me rrethinë si urë lidhëse, pra urat e Kosovës që do të thotë janë potencial për veprimtari shërbyese tregtare, turistike, agroindustriale dhe industri e lehtë.

Pra, pozita gjeografike afër kufirit është determinuese për këtë potencial.

Komuna e Gjakovës e ka formuar bordin për transformimin e aeroportit. Gjakova ka vizion se si duhet të zhvillohet ky aeroport, janë bërë shumë hulumtime për gjetjen e modelit më të volitshëm për ekonomizimin e këtij aseti, duke u bazuar në eksperiencat rajonale dhe evropiane.

Janë disa prej propozimeve, që janë bërë, si:

Në një, si aeroport rezervë për Aeroportin “Adem Jashari”.

Nën dy, si aeroport civil komercial ose aeroport ushtarak civil, që operohet nga autoritetet civile dhe ushtarake. Të gjitha opsionet i kanë përparësitë e veta, por edhe kostot për ndërtim dhe për mirëmbajtje.

Opsioni i tretë është konsideruar si opsioni më i leverdishëm për shkak të ndarjes së kostos së mirëmbajtjes dhe shfrytëzimit më racional të infrastrukturës së aeroportit për aeroplanë civilë dhe aeroplanë ushtarakë.

Një aeroport i përbashkët ushtarako-civil do të mund të operohej bashkërisht nga autoritetet ushtarake dhe civile, do t'i ndanin objektet e kontrollit të trafikut ajror dhe

shërbimet emergjente për terminale të veçanta, zona e parkimi, hangarë dhe zona tjera të nevojshme për operim.

Pra, me një fjalë, Komuna e Gjakovës është njëra prej komunave që ka pësuar më së shumti gjatë luftës. Prandaj, ky aeroport e ka një histori zhvillimore, është potencial i pashfrytëzuar që për Komunën e Gjakovës është një aset që premtan punësim dhe ringjallje, gjë me rëndësi të madhe jetike për këtë komunë.

Pra, edhe një herë, për ta përfunduar, Komuna e Gjakovës, në krye me kryetarin Pal Lekaj, nuk ka reshtur me shkresa, që unë i kam para vetes, shumë e shumë shkresa që u janë drejtuar qoftë Qeverisë, apo ministrive përkatëse, dhe asnjëherë nuk do të pushojë, e kjo është një pasuri e Gjakovës dhe e qytetarëve të saj, në radhë të parë.

KRYETARI: Deputeti Ramiz Lladrovci e ka fjalën.

(Reagim nga salla)

Unë e bëj rendin këtu!

RAMIZ LLADROVCI: Faleminderit, kryetar!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Dua të adresoj para jush një shqetësim, për mua tronditës, lidhur me një informacion që mora dy ditë më parë nga një familjar i të dënuarve të rastit “Kiçina”.

Zoti Fadil Syleviqi, nyja e këtij procesi të montuar dhe i shumë proceseve tjera në Kosovë, i kishte kërkuar takim familjarit të këtij rasti.

Ata kishin pasur gjithsej tri takime.

Në takimin e parë dhe të dytë, zoti Syleviq synoi ta arsyetojë veten e tij, duke provuar t’i motivojë familjarët e dënuarve kundër ndërkombëtarëve, se gjoja ata e kanë montuar atë proces.

Në takimin e tretë, ai e kishte zbuluar qëllimin e tij të vërtetë, duke tentuar t’i inkriminojë ata realisht me propozim-zgjidhje makabre. Citoj: “Po të isha unë në vendin e vëllezërve tuaj, do të ikja nga burgu, do të armatosesha mirë dhe do të hyja në një shkollë fillore, do t’i merrja peng nxënësit e saj dhe do ta vija kushtin që lënda të kthehej në rigjykim”.

Kjo, sipas zotit Syleviq, ishte mënyra më e mirë, më e lehtë dhe më e shpejtë për të ardhur deri te rigjykimi dhe pafajësia e tyre.

Të nderuar deputetë,

Pas gjithë këtyre konsultimeve të zotit Syleviq, e quaj të domosdoshme ta denoncoj publikisht edhe rastet tjera të rënda dhe shumë të përfolura në opinion, që lidhen me krimet e tij edhe pas luftës.

Ende është i padëgjuar rasti i vrasjes së ushtarit të UÇK-së nga zona operative e Llapit, në lagjen Matiqan të Prishtinës, edhe pse dihet që vrasësi i tij është zoti Syleviq, i cili edhe e kishte djegur kufomën e tij të mbështjellë në tepihun e shtëpisë.

Njëjtë, ky “hero” i krimit, menjëherë pas çlirimit të Kosovës e kishte vrarë publikisht një oficer të policisë serbe, koleg të deriatëhershëm të tij. Rastin e kishte bërë afër pompës së benzinës, te Qafa.

Këtë krim, sipas bindjes sime, ai e kishte bërë për dy arsye.

E para, të tregohej patriot në sytë e shqiptarëve dhe, e dyta, të pamundësonte zbulimin e mundshëm të krimeve të veta të bëra kundër popullsisë civile para, gjatë dhe pas luftës.

Nëpërmjet malverzimeve të shumta, zoti Syleviq e kishte fituar tinëzisht dhe rrejtshëm besimin e kolegëve vendorë e ndërkombëtarë si “specialist” i zbulimit të veprave të rënda kriminale.

Kolegët e tij nuk e kuptuan se ai me të vërtetë ishte bërë vetë specialisti i krimeve dhe i montimeve të tyre.

Në njërën versionet e tij prej “specialisti”, ai e bindi një dëshmitar me dosje kriminale recidive të dëshmojë kundër këtij grupi, duke i premtuar se do ta dërgojnë në SHBA.

Ky gjykim fatmirësisht po udhëhiqej nga një gjyqtar i respektuar ndërkombëtar, zoti Norbert Coster, që falë ekspertizës së tij të mirëfilltë profesionale, nuk ra në lajthitje të dëshmitarit të sajuar...

(Ndërprerje nga regjia)

Pjesë e diskutimit e dorëzuar me shkrim

... nga z. Syleviq.

Këtë dëshmitar z. Syleviq, madje e kishte dërguar gjatë hetimeve qëllimisht në Burgun e Dubravës, ku po mbaheshin edhe 13 të burgosurit e grupit të 17 marsit 2004, me qëllim të identifikimit sa më të mirë të çdonjërit prej tyre, që gjatë ballafaqimit në gjyq t'i inkriminojë sa më bindshëm në lidhje me rastin.

Në këtë kuadër, dëshmitari e pranoi edhe vetë se ishte dëshmitar i rrejshëm, i shtyrë me dhunë dhe i joshur nga z. Fadil Syleviqi dhe z. Gojart Kelmendi, një ish-polic i SHPK-së.

Si rrjedhojë, gjyqtari ndërkombëtar i liroi të gjithë të akuzuarit, dy vjet e gjysmë më pas, si të pafajshëm, ndërsa dëshmitarin e dënoi me një vit burg për deklaram të rrejshëm.

Pas kësaj, edhe vetë z. Syleviq e kishte tërhequr deklaratën e tij kundër këtij grupi.
Faleminderit!

Ramiz Lladrovci, d.v.

KRYETARI: Faleminderit! Ju lutem, asnjë fjalë!

Janë të lajmëruar edhe nëntë deputetë për të folur jashtë rendit të ditës. Grupet Parlamentare të mos adresojnë kërkesa të paarsyeshme tek unë, le të merren vesh dhe nuk mund më shumë se tre veta të flasin, bile tre veta mund të flasin vetëm nga një grup parlamentar, por jo të tjerët. Kështu që kush do ta marrë fjalën me rend, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike e bën vetë renditjen e deputetëve që donë të diskutojnë. Le ta bëjnë edhe grupet tjera, këtu për ne është më lehtë. Nëse seanca do ta marrë një vendim që t'u jepet fjala të gjithë mund ta marrim, por gjysmë ore është harxhuar. Do të thotë, seanca nuk është e gatshme të vazhdojë më tutje. 30 minuta është kjo pikë!. Merruni vesh grupet parlamentare.

Vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës:

2. Koha për pyetje parlamentare

Për këtë seancë janë parashtruar 11 pyetje parlamentare.

Koha e paraparë është 60 minuta. Vazhdojmë me pyetjen e parë. Deputeti Mursel Haljilji, pyetje për ministrin Dardan Gashi.

MURSEL HALJILJI: Hvala predsedniçe Skupštine!

Uvaženi članovi Vlade,

Dame i kolege poslanici,

Ja sam na prošoj sednici postavio pitanje za gospodina ministra, vezano za moje izlaganje od pre godinu dana, koja je bilo vezano za tragediju koja pogodila selu Restelica, odnosno porodicu Reka.

Tada sam postavio i pokrenuo jednu pitanje oko matiranja kriznih tačka na celoj teritoriji Kosovo, u smislu prevencije od mogućih šteta i žrtava. To je bio slučaj sa rekama koji se izlivaju, odronjom kamenja na putevima, takođe i lavina u zimskoj periodu, i mislim da smo svedoci da se događaju i dan danas žrtve ovih elementarnih nepogoda, pa sam mislio da li je Ministarstvo pokrenulo nekakvu akciju vezanu za mapiranih kriznih tačaka, samim tim i mogućnosti zaštite od ovih elementarnih nepogoda? Hvala!

KRYETARI: Ministri nuk është këtu. Deputeti Bekim Haxhiu, pyetje për ministrin Memli Krasniqi. Ministri nuk është këtu, deputet do ta bësh pyetjen?

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Kërkoj që këto pyetje të transferohet për seancën e radhës, kur ministri të jetë këtu.

KRYETARI: Mirë, faleminderit! Ti i ke dy pyetje, e kalojmë edhe tjetrën. Deputetja Salihe Mustafa, pyetje për ministrin Ramë Buja.

SALIHE MUSTAFA: Faleminderit, kryetar!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Qeveria e Republikës së Kosovës, më 6 mars të këtij viti, në kuadër të vendimeve për themelimin e universiteteve publike në Kosovë, mori vendim edhe për themelimin e Universitetit Publik të Gjilanit si institucion i arsimit të lartë.

Ky vendim i Qeverisë prek kërkesën e kamotshme të Anamoravës me qendër Gjilanin si një lidhëse e trekëndëshit të Kosovës Lindore, Kumanovë, Preshevë dhe Bujanoc.

Pyetja ime për ju zoti ministër, është: Deri ku kanë arritur përgatitjet rreth fillimit të punës së këtij universiteti dhe a do ta fillojë punën Universiteti Publik i Gjilanit me fillimin e vitit të ri akademik?

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën.

MINISTRI RAMË BUJA: I nderuar, zoti kryetar,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

E nderuar deputete Mustafa,

Qeveria e Kosovës, siç e thatë edhe ju, më 6 mars 2013, ka marrë vendim për hapjen edhe të tri universiteteve të reja publike, atij të Gjilanit, Mitrovicës dhe Gjakovës.

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë është në fazën fillestare të përgatitjes së themelimit të organeve udhëheqëse të Universitetit të Gjilanit, është bordi themelues që do bëhet.

Është përgatitur një bazë e mirë infrastrukturore që nga viti i kaluar. Përveç bazës infrastrukturore, MASHT-i ka pasur parasysh edhe përvojën shumë të gjatë të ish-Shkollës së Lartë Pedagogjike në këtë qytet dhe në 4 vjetët e fundit edhe të njësive akademike nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Ekonomik dhe Juridik. Të gjitha këto na kanë sjellë deri te një gjendje e tanishme në procesin e themelimit dhe të marrjes së vendimit nga Qeveria e Republikës së Kosovës për hapjen e kësaj qendre të re universitare, e cila me kapacitetet që ka dhe me ndihmën me universiteteve tjera në Kosovë, besoj që do të jetë një hap i suksesshëm për të gjithë qytetarët e rajonit të Gjilanit, me theks të veçantë për vendbanimet shqiptare edhe përreth Gjilanit.

Ministra e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, së bashku me Komunën e Gjilanit dhe Universitetin e Prishtinës, po punon intensivisht që më 1 tetor 2013 të fillojë mësimi në këtë institucion të arsimit të lartë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, ministër! Deputete, ke pyetje shtesë?

SALIHE MUSTAFA: Faleminderit, kryetar!

Zoti ministër, a mund të na thoni se me cilat drejtime, përveç atyre aktuale, do të fillojë viti i ri akademik në këtë universitet? A keni në plan që edhe drejtime tjera shtesë të ketë

në këtë universitet, në mënyrë që maturantët të kenë mundësi qysh tash të përgatiten për drejtimit e tyre?

KRYETARI: Ministër, urdhëro!

MINISTRI RAMË BUJA: E nderuara deputete, Aktualisht, ky institucion ka dy degë - Ekonomikun dhe Juridikun, dhe një pjesë të Fakultetit të Edukimit, që vepron atje. Ata kanë bërë kërkesë në Agjencinë Kosovare të Akreditimit dhe programet që akreditohen ne jemi të detyruar ta ekzekutojmë vendimin e tillë. Faleminderit!

KRYETARI: Deputetja Ganimete Musliu, pyetje për ministrin Nenad Rashiq. Deputete, e ke fjalën.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar përfaqësues të Kabinetit qeveritar,

Kolegë dhe ju kolegë deputetë

Fatmirësisht, në Kosovë i kemi funksionale qendrat sociale, të cilat janë në shërbim të qytetarëve për nevojat e ndryshme dhe në këto qendra, përveç tjerash, në masë të madhe trajtohen edhe problemet familjare, siç e kemi rastin e ndarjen të qifteve, kur qendra asiston në negocimin e palëve dhe ndërmjetësimin e tyre kur ata kanë fëmijë.

Duke marrë parasysh që në këto qendra organizohen edhe takime të prindërve të ndarë me fëmijët dhe shpeshherë këta fëmijë janë edhe të traumatizuar nga problemet e çifteve, i nderuar zoti ministër, këto qendra sociale që operojnë në Kosovë a kanë të punësuar psikologë për trajtimin e këtyre çështjeve të ndjeshme?

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën.

MINISTAR NENAD RAŠIĆ: Hvala gospodine predsjedniče!

Poštovani zamenici premijera, poštovani ministri,

Hvala na pitanju gospođo Musliju,

Pre svega, hteo bi da znate da je od 2008. godine, Ministarstvo za rad preuzelo nadležnosti od UNMIK-a, i od tog dana funkcionisalo po sistemima Kosova, dok je od 1. januara 2009. godine izvršena totalna decentralizacija na nivou svih opština. To je urađeno u jednom trojnom prebacivanju nadležnosti od strane Ministarstva za rad, Ministarstva lokalne samouprave i Ministarstva financija, koja je imala zadatak da sve nadležnosti koje se tiču socijalnog staranja i socijalnih usluga prebace se na novoformirane ili opštine koje se već postojale.

I samim tim, samo načelo, odnosno samo formulacija koje se tiče zvaničnih socijalnih usluga, bi trebalo da imaju kvalifikovane osobe ili profesionalce u sledećim oblastima: u socijalnom radu, o oblasti psihologije, oblasti sociologije, oblasti prava, oblasti pedagogije ili neke druge oblasti koja direktno je povezano sa socijalnim uslugama.

Znači ovo je samom decentralizacijom trebalo da bude odgovornost opštine, da oni kadrijaju, odnosno upošljavaju odgovarajuće profesionalce u svom delu posla, i samim tim smo utvrdili da ta decentralizacija, odnosno broj profesionalaca u centrima socijalni rad nije odgovarajući. Mi smo od 2012. zajedno sa jednom italijanskom nevladinom organizacijom, koje se zove 'Amicidae Bambini', što bi trebalo znači 'prijatelji dece', pokrenuli projekat koje će trajati 28. meseci, u kome smo poslali 13 psihologa, koji će raditi do momenta dok sami centri za socijalni rad nemaju mogućnost da nastave taj njihov započeti rad. Znači 13 psihologa ne mogu da pokriju sve opštine, i za sad je manje više od prilike da svaki psiholog ide u poseti u tri opštine, i tamo obavlja svoje zadatke, ali mislim da sami tim što je to počeo od novembra 2012., rok trajanje će biti 28 meseci. Mislim da i opšte nemaju šansu u ovom pogledu da naprave prostor da posle tih to perioda od 28 meseci...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Edhe një minutë, ministrit!

MINISTAR NENAD RAŠIĆ: Hvala, predsedniče!

...da opštine same mogu da preuzmu odgovornost, koji je predviđen i zakonom gde će oni sami zaposlih psihologe posle toga. Znači ima jedan kratak odgovor, i ima jedna podrška sa naše strane, ali opštine m konačno bi morale da preuzmu odgovornost. Hvala!

KRYETARI: Deputete, ke pyetje shitesë?

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, zoti ministër!

Me të vërtetë, unë çmoj dhe respektoj shumë lart stafin që punon nëpër këto qendra, mirëpo nga ankesat e prindërve që kanë ardhur ose që janë trajtuar në këtë qendra, del që shpeshherë fëmijët e tyre, në vend që ta marrin shërbimin adekuat, ata dalin të traumatizuar nga këto qendra. Prandaj, ky ishte shqetësimi im ose i qytetarëve, të cilët sot e adresojnë nëpërmjet meje në këtë seancë.

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën.

MINISTAR NENAD RAŠIĆ: Ja još jednom samo mogu da potvrdim da od strane Ministarstva, mi ćemo apsolutno uvek biti spremni da pomognemo, ali je takođe vrlo bitno da znate da, ponavljam, u centrima za socijalne usluge, Centar za socijalni rad, mi sad nemamo nadležnost direktno oko upravljenja. Mi imamo monitoring, i imamo dobru volu da im pomognemo. Kao što sam rekao iz ovog projekta sa italijanskom nevladinom organizacijom, mi nismo bili u obavezi da to radimo. Mi smo mogli da kažemo to je decentralizovano, to je vaš problem, ali naravno da centralna institucija treba da se trudi da pomaže lokalnim institucijama. Znači, imate moju privrženost i moju predanost za pomoć, ali i same opštine trebalo, posle 4. godine, da preuzme malo inicijative. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit, ministër! Deputete Musliu, e ke edhe një pyetje për ministrin Ibrahim Makolli. Ministri nuk është këtu.

GANIMETE MUSLIU: Pasi pyetja nuk e humb aktualitetin, kërkoj që kjo pyetje të bartet për seancën e radhës.

KRYETARI: Deputetja Time Kadrijaj, pyetje për ministrin Çeku. Ministri ka njoftuar se nuk do të jetë i pranishëm në këtë seancë.

TIME KADRIJAJ: Kryetar, e bartim për seancën tjetër, meqenëse kërkoj një përgjigje prej ministrit Çeku.

KRYETARI: Deputetja Time Kadrijaj, pyetje për ministrin Ramë Buja.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar ministër Buja,

Më herët jua kam bërë një pyetje parlamentare për pagat e stafit akademik. Pas asaj pyetje, pagat për vitin akademik 2012/2013, për muajt tetor, nëntor dhe dhjetor janë paguar për stafin akademik, kurse pse nuk u janë paguar pagat për muajin qershor 2012 të kontratës së lidhur ndërmjet Universitetit të Prishtinës dhe stafit akademik të angazhuar për vitin shkollor 2011/2012.

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën.

MINISTRI RAMË BUJA: E nderuara deputete Kadrijaj,

Me Rregulloren për të ardhurat personale të Universitetit të Prishtinës, numër 1126, të datës 27.4.2012, është precizuar çështja e pagesës për stafin akademik të angazhuar, ku neni 12 i kësaj rregullore thotë se për çdo orë që paraqitet për pagesë duhet të arsyetohet me listat e studentëve të pranishëm, të verifikuar nga personi i autorizuar i fakultetit, raportet duhet të paraqiten deri në datën e caktuar të muajit vijues.

Duke pasur parasysh që në muajin qershor nuk mbahet mësim, sepse është muaji i organizimit të provimeve, sipas Statutit të Universitetit të Prishtinës, nuk ka pasur bazë ligjore që personelit akademik të angazhuar t'i kompensohet për muajin qershor të vitit akademik 2011/2012. Në rastet kur ka pasur shtyrje të mësimit dhe mësimi ka vazhduar të mbahet edhe gjatë muajit qershor, atëherë sipas realizimit të orëve, përkatësisht mbajtjes të mësimit, është kompensuar edhe afati akademik i mbajtur i mësimit gjatë kësaj kohe. Faleminderit!

KRYETARI: Deputete, ke pyetje shtesë?

TIME KADRIJAJ: Ministër, personat e kontaktuar thonë që ata e kanë përmbushur planprogramin e mësimit, ashtu siç është paraparë me ligj dhe për këtë kanë edhe kontrata. Nuk është eliminuar një, dy ose tre, por është eliminuar komplet i gjithë stafi, që gjithsej janë 700 punëtorë të këtij niveli. Pse nuk u është paguar kjo pagë? Del se kanë humbur diku rreth 250 mijë euro për pagat që nuk i janë paguar personelit akademik, sepse ata e kanë kontratën dhe fakt është dashur të paguhen, ministër. Ku janë ato para?

KRYETARI: Ministër, urdhëro!

MINISTRI RAMË BUJA: E nderuar,

Para së gjithash, kjo është çështje ekskluzive e Universitetit, por, megjithatë, meqë unë jam këtu, e rektori nuk mund të jetë, unë po ju përgjigjem në njëfarë forme. Unë ju thashë që profesorët e angazhuar kanë të drejtë ta marrin pagën në bazë të kontratës gjer në qershor, kur nuk kanë mësim plotësues, ku ka mësim plotësues kompensohen për të gjitha orët. Ata kanë mundësi të marrin edhe kompensim tjetër 0,60 centë për secilin student që paraqitet në provimin e tyre edhe ata janë vlerësues të këtij provimi. Por, Universiteti nuk ka detyrë tjetër, obligim tjetër për t'i paguar ata. Kontratën e kanë të qartësuar mirë. Le ta shikojnë edhe një herë nëse eventualisht nuk e kanë parë, por kjo është e saktësuar mirë me Rregulloren e brendshme të Universitetit të Prishtinës. Ju lutem!

KRYETARI: Faleminderit! Deputetja Donika Kada-Bujupi, nuk qenka këtu. Ajo ka pasur pyetje për ministrin Enver Hoxhaj. Deputetja Vjollca Krasniqi, pyetje për ministrin Bajram Rexhepi. Deputete, e ke fjalën.

VJOLLCA KRASNIQI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar ministria,

Ministër Rexhepi,

Të nderuar kolegë deputetë,

Po e përshëndes ministrin, në veçanti, sepse pyetja i është drejtuar atij.

Në bazë të Ligjit për zjarrfikje dhe shpëtim, si dhe bazuar në udhëzimin administrativ, të nxjerrë në qershor të vitit 2012, lidhur me transferimin e Shërbimit të Zjarrfikjes dhe Shpëtimit nga komunat nga Agjencinë për Menaxhimin e Emergjencave, si dhe të pajisjeve dhe aseteve tjera, ju keni nënshkruar marrëveshje me komunat vitin e kaluar për këtë transferim.

Zoti ministër,

Pse nuk po zbatohet ligji, udhëzimi administrativ, të cilin e keni nxjerrë ju si ministri, si dhe marrëveshja ndërmjet komunave lidhur me transferimin e kësaj kategorie të punëtorëve?

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën.

MINISTRI BAJRAM REXHEPI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

E nderuara deputete Krasniqi,

Ministria e Punëve të Brendshme për zbatimin e Ligjit numër 04/L-049 për zjarrfikje dhe shpëtim ka ndërmarrë një varg masash që njësitë profesionale të zjarrfikësve të funksionojnë në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, përkatësisht Agjencisë së Menaxhimit Emergjent, siç përcaktohet me ligj.

Fillimisht, është nxjerrë udhëzimi administrativ numër 21/2012 për transferimin e Shërbimit të Zjarrfikjes dhe Shpëtimit në njësi profesionale nga komunat në Ministrinë e Punëve të Brendshme, përkatësisht Agjencinë e Menaxhimit Emergjent.

Më pas, pas konsultave paraprake me të gjitha komunat përkatëse, janë nënshkruar memorandume të mirëkuptimit, ku kryetarët e secilës komunë përkatëse janë pajtuar për transferimin e Shërbimit të Zjarrfikjes dhe Shpëtimit, nga niveli komunal në nivelin qendror, përkatësisht në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe në Agjencinë e Menaxhimit Emergjent.

Në rrjedhën e memorandumeve të mirëkuptimit, përkatësisht nenit 3 të Memorandumit të Mirëkuptimit, me vendim numër 497/2012, të datës 18.7.2012, është themeluar komisioni për transferimin e shërbimeve të zjarrfikjes dhe shpëtimit nga komunat në Ministrinë e Punëve të Brendshme, i cili në bazë të detyrave që ka pasur në secilën komunë ka konstatuar gjendjen buxhetore për të gjitha kategoritë buxhetore të Shërbimit të Zjarrfikjes dhe Shpëtimit në komunat përkatëse, numrin e stafit me të dhënat personale të Shërbimit të Zjarrfikjes dhe Shpëtimit sipas listës së pagave për vitin 2012 dhe hapësirën e punës, lokaleve, inventarin, të gjitha mjetet dhe pajisjet e punës.

Pas të gjitha këtyre përgatitjeve dhe grumbullimit të gjitha të të dhënave, grupi punues, i përbërë nga përfaqësues të departamenteve ligjore të Zyrës së Kryeministrit, Ministrisë së Punëve të Brendshme, Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal e kanë analizuar gjithë procesin dhe e kanë përgatitur gjithë pakon e dokumenteve të nevojshme për ta paraqitur për miratim në Qeveri, propozim-vendimin për ndryshimet buxhetore dhe bartjen e aseteve të Shërbimit të Zjarrfikjes dhe Shpëtimit nga niveli lokal në nivelin qendror, përkatësisht në Agjencinë e Menaxhimit Emergjent.

Tashmë janë ndërmarrë të gjitha hapat e duhur dhe janë sqaruar të gjitha çështjet, si dhe janë siguruar të gjitha të dhënat e duhura dhe sapo të merret vendimi për ndryshime buxhetore dhe bartjen e aseteve të Shërbimit të Zjarrfikjes dhe Shpëtimit, nga niveli lokal komunal në nivelin qendror, do të jetësohet i gjithë procesi, që njësitë profesionale zjarrfikëse të funksionojnë në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, përkatësisht...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit, ministër! Pyetje shtesë, deputete?

VJOLLCA KRASNIQI: Faleminderit, kryetar!

Kam pyetje shtesë dhe komente shtesë.

Ne si komision, ia kemi bërë një vizitë Agjencisë për Menaxhimin e Emergjencave dhe është mendimi im personal, meqë kemi konstatuar se kjo agjenci, së pari nuk ka kushte pune, dhe nuk ka kuadro profesionale. Dhe, kam dyshim që kjo agjenci të menaxhojë edhe me këta shërbyes, sepse ata nuk mund ta menaxhonin me vetveten.

Sipas një emisioni në njërin nga televizionet tona, thuhet se ju, përkatësisht institucioni të cilin e udhëhiqni ju keni harruar ta bëni planifikimin buxhetor për paga, për shërbime e mallra dhe për investime kapitale. Andaj, këta zjarrfikës në një farë forme kanë mbetur me status pezull.

Bartja e pronave, a do të jetë falje nivelit qendror, apo vetëm shfrytëzim i këtyre aseteve, si dhe a keni bërë aneks marrëveshje me komunat tjera, sepse marrëveshja e arritur gjatë vitit të kaluar, besoj që ka rënë në ujë dhe nuk...?

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Ministër Rexhepi, e ke fjalën.

MINISTRI BAJRAM REXHEPI: Së pari, Shërbimi i Zjarrfikjes ka qenë kompetencë e transferuar në nivelin komunal nga niveli qendror, në bazë të procesit të decentralizimit dhe është parë se në rastet kur ka pasur katastrofa natyrore, vërshime e të tjera, nuk ka mundur të bëhet koordinimi regjional ose qendror dhe me ligj është paraparë që kjo kompetencë t'i kthehet sërish Ministrisë së Punëve të Brendshme. Ka pasur pengesa në atë kohë edhe nga ICO, edhe nga Ministria e Pushtetit Lokal që këto mos të transferohen. Çështja e buxhetit ka qenë edhe nga Ministria e Financave, që është transferuar në nivel komunal, ka shkua me 'copy paste', edhe pse është bërë kërkesë që të kthehet në Ministrinë e Punëve të Brendshme, e kjo pritet pas vendimit të Qeverisë.

Sa i përket objektit, ata janë me qira. Ka filluar procesi i ndërtimit të objektit të Agjencisë së Menaxhimit Emergjent në Hajvali, për të krijuar kushte më të mira. Ndërsa si agjenci e ri, pajtohem edhe unë që ende nuk janë plotësuar kapacitetet e plota, por ky është proces. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, zoti Xhavit Haliti.)

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Enis Kervan, pyetje për ministrin Ramë Buja. Nuk është Enisi. Atëherë, konstatoj që pyetjet e deputetëve janë shteruar. Sipas Rregullores, pyetjet e deputetëve që nuk marrin përgjigje në dy seanca plenare do të publikohen në revistën e Kuvendit, sipas nenit 45, paragrafi 11, të Rregullores së Kuvendit.

Vazhdojmë me pikën e tretë të rendit të ditës:

3. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve plenare, të mbajtura më 8, 12, 14, 15 dhe 19 mars 2013

Të nderuara zonja dhe zotërinj,

Pyes nëse ka vërejtje në procesverbale? Janë paraqitur tre veta. Zonja Sahatqija e ka fjalën.

TEUTA SAHATQIJA: Faleminderit, kryesues!

Desha të tërheq vëmendjen se transkripti i seancës së datës 28 shkurt 2013, i cili ka pas të bëjë me pensionet mungon dhe kërkoj prej Administratës që ta plotësojë këtë transkript dhe ta publikojë në ueb-faqen e Kuvendit.

KRYESUESI: Faleminderit! Shpresoj që Administrata e ka dëgjuar këtë dhe do ta korrigjojë pjesën e cila pati vërejtje. Zonja Emilija Rexhepi e ka fjalën.

EMILIJA REDŽEPI: Zahvaljujem predsedavajući!

Nemam primedbu na transkript sa prethodne sednice, ali imam primedbu na današnji dnevni red, odnosno tačka pod rednim broju 12, gde stoji 'Izbor potpredsednika Skupština republike Kosova iz redova nevećinskih nacionalnih zajednica'. Odnosno, pitam vas gospodine predsedavajući i vaše tehničko osoblje, zašto svi poslanici u Parlamentu Kosova nisu dobili materijal, koji u nekoliko navrata podnet Predsedništvu na razmatranje ispred Parlamentarne Grupe za Novo Kosovo, koga je podnela šefica Myzejene Selmani, a pre svega jako važna podrška predsednice Foruma žena u Parlamentu Kosova, gospođa Teuta Sahatćija. Molim vas, to nije individualni zahtev, nego je zahtev velikog broja poslanika u Parlamentu Kosova različitih nacionalnosti i polne zastupljenosti. Od vas zahtevam da to ispravite, i da to uđe u današnjem dnevnom redu.

Dobili smo materijal koji je podnela Parlamentarna grupa "6", kao da je to rotaciona mesto za zajednice u toj grupi, a u ostavci gospodine Enisa Kervana na pisanoj ostavci koju imamo na stolu stoji da je to mesto za...

KRYESUESI: Ju lutem, është pika e 12-të, e cila sipas radhës është caktuar për këtë çështje. Në pikën e 12-të të rendit të ditës e keni të drejtën për të diskutuar për këtë çështje. Tani e kemi vetëm miratimin e procesverbaleve. Në qoftë se keni vërejtje se nuk është shkruar fjala e juaj diku në procesverbal mund ta thoni, kurse këto nuk janë çështje për pikën në fjalë. Faleminderit! Zoti Sabri Hamiti e ka fjalën.

SABRI HAMITI: Faleminderit, zoti kryesues!

Kjo që do të them unë është vërejtje për procesverbalin e mbledhjes plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të mbajtur më 15 dhe 19 mars 2013.

Vërejtja ime ka të bëjë me votimin për rekomandimet, pas debatit Parlamentar të LDK-së rreth çështjes së energjisë dhe faturimit të saj.

Në fund thuhet rezultati i votimit ishte si vijon: për 35, kundër 25, abstenime 2, pastaj konstatohet se në bazë të nenit 51.6 të Rregullores, kur një kërkesë ose mocion hidhet në votim dhe nuk e merr më shumë se gjysmën, ose merr vetëm gjysmën e votave, nuk kalon. Unë kërkoj që le të mbetet formulimi kështu, veçse le të thuhet e vërteta, që në këtë votim nuk janë marrë parasysh votimet me dorë. Kaq! Unë kërkoj që të shkruhet, sepse kjo është e vërteta. Atëherë e themi të vërtetën e gjithë këtij votimi. Domethënë të shtohet: "Nuk janë marrë parasysh votimet me dorë". Pikë.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Shaip Muja e ka fjalën.

SHAIP MUJA: I nderuar kryesues,

Lidhur me procesverbalin, unë kisha kërkuar që procesverbalet të zbardhen sa më shpejt në internet dhe të mos lejohen forma të spekulimeve, siç janë duke ndodhur në kohët e fundit nga procesverbalet, se çfarë deklarojnë deputetët. Për shembull, në procesverbalin, i cili është edhe sot faktik, edhe të gjithë deputetët e dinë, dhe lus Sekretarinë që t'ua ndajë të gjithë deputetëve procesverbalin tim se çfarë kam deklaruar unë për viktimat e luftës dhe për gratë e dhunuara, e Grupi i "Vetëvendosjes" dhe një pjesë e shoqërisë

civile mundohet ta devijojë fjalën “ekzaminim”, e në këtë mënyrë janë duke spekuluar për interesat e veta materiale. Prandaj,...

KRYESUESI: Zoti Muja, për çështjen...!

SHAIP MUJA: ...ju lus që procesverbali të jetë sa më shpejt i pasqyruar, e jo pas dy javësh, sepse për dy javë këta spekulantë politikë po bëjnë edhe tema politike të paqëndrueshme. Faleminderit!

KRYESUESI: E ke të drejtën ta marrësh krejt procesverbalin vetë dhe stenogramin dhe t’ua shpërndash të gjitha medieve. S’ta ndalon askush! Zoti Vataj e ka fjalën.

RAMË VATAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Unë e kam një vërejtje në transkriptin e seancës plenare të 15 marsit. Ndër tjera, është përvjedhur një gabim, kur unë kam deklaruar “krim i shëmtuar”, ndërsa në transkript ka dalë “krim i shumëzuar”. Është dallim shumë i madh, prandaj kërkoj që të korrigjohet. Ndërmjet “krim i shëmtuar” dhe “krim i shumëzuar” ka shumë dallim dhe domethënie. Prandaj, kërkoj që transkripti të korrigjohet.

KRYESUESI: Besoj që Administrata do ta ketë parasysh dhe do ta shihni edhe vetë të përmirësuar. Tani ju lus që t’i miratojmë procesverbalet me votim, me vërejtjet që i thanë deputetët. Në sallë janë 72 deputetë. A jeni për të miratuar? Kundër nuk ka.

Konstatoj që Kuvendi i miratoi procesverbalet e mbledhjeve plenare të mbajtura më 8, 12, 14, 15 dhe 19 mars 2013.

Vazhdojmë me pikën e katërt të rendit të ditës:

4. Raportimi i kryeministrit të Kosovës, zoti Hashim Thaçi, për takimin e tij të shtatë me kryeministrin e Serbisë në Bruksel

Kryeministri i Republikës së Kosovës, zoti Thaçi, e ka shprehur gatishmërinë që të raportojë në Kuvendin e Republikës së Kosovës për takimin e tij të shtatë me kryeministrin e Serbisë në Bruksel me ndërmjetësimin e përfaqësueses së lartë të Unionit Evropian për Politikë të Jashtme dhe Siguri, baroneshës Eshton. E ftoj kryeministrin e Kosovës, zotin Hashim Thaçi, që ta marrë fjalën. Zoti kryeministër, e keni fjalën.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: I nderuari kryesues i Kuvendit të Republikës së Kosovës, zoti Haliti,

Të nderuar deputetë të Parlamentit të Republikës së Kosovës,

Kabinet qeveritar,

Zonja dhe zotërinj,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Javën që shkoi, në Bruksel, me ndërmjetësimin e baroneshës Eshton, u mbajt takimi i shtatë ndërmjet meje si kryeministër i Kosovës dhe kryeministrit të Serbisë, Ivica Daçiq.

Është e qartë tashmë se kemi hyrë në fazën më të ndjeshme, më substanciale dhe njëkohësisht më të vështirë për Serbinë. E them më të vështirë për Serbinë, sepse tani jemi në fazën kur Serbia duhet t'i shpërbëjë pa kushte strukturat paralele të sigurisë.

Është e qartë se ky është një ballafaqim jo i lehtë, sepse duhet të ballafaqohen me një problem që e kanë krijuar dhe ushqyer vetë tani e 13 vjet. Megjithatë, ka një pajtueshmëri edhe nga Serbia që këto struktura duhet të shpërbëhen shpejt dhe pa kushte.

Procesi i shpërbërjes së tyre do të mbikëqyret nga një mekanizëm ndërkombëtar, sipas të gjitha gjasave nga EULEX-i, KFOR-i dhe institucionet e Republikës së Kosovës.

Ne si delegacion kemi siguruar që të gjithë ata që nuk kanë qenë të përfshirë në aktivitete kriminale, do të mund të inkuadrohen më pas në institucionet e Kosovës, pasi t'i jenë nënshtruar një procesi individual të verifikimit, të bazuar në kualifikimet e tyre.

Qartë, mospajtimet më të mëdha dhe arsyeja kryesore pse edhe ky rund u përmyll pa marrëveshje, janë mospajtimet fundamentale lidhur me kompetencat e asociacionit të komunave me shumicë serbe.

Serbia insiston që ky asociacion të ketë kompetenca ekzekutive. Serbia synon që në Kosovë ta themelojë një nivel të tretë pushteti, duke e rrënuar kështu tërë infrastrukturën ligjore dhe kushtetuese, që me shumë mundësi kemi ndërtuar në bashkërisht.

Më lejoni të them shumë hapur dhe qartë, një gjë e tillë nuk do të ndodhë kurrë. Asnjëherë dhe në asnjë rrethanë nuk do të lejojmë diçka që do ta cenonte rendin tonë kushtetues e ligjor. Nuk do të zgjidhet një problem, duke e krijuar një problem tjetër edhe më të madh. Nuk do të lejojmë që në Kosovë të riciklojë modelet e shkuara të rajonit, qoftë ajo e Republika Sërpse, ndonjë ndarje e Kosovës, ndonjë autonomi, ndonjë status special, ndonjë status të veçantë, ndonjë Ahtisari plus, apo ndonjë status i modelit të modelit të terrorit apo Katalonisë.

Më lejoni ta them shumë hapur para jush, të nderuar deputetë, qytetarë të Republikës së Kosovës, se ne nuk kemi ama asnjë lloj presioni nga askush, sidomos nga partnerët tanë ndërkombëtarë, që të pranojmë diçka të tillë.

Presioni tani është në Beograd dhe gishtit është drejtuar kah Beogradi. Ata duhet ta ndërrojnë qasjen e tyre ndaj Kosovës, ata duhet të fillojnë të sillen në mënyrë evropiane në raport me Kosovën.

Të nderuar deputetë,

Takimi që zgjati për më shumë se 12 orë u mbyll pa marrëveshje, pikërisht pse Serbia nuk ishte ende në gjendje ta pranonte ofertën që ishte në tavolinë.

Dua ta falënderoj, në emër të institucioneve të Republikës së Kosovës, baroneshën Eshton për ndërmjetësimin e shkëlqyer të takimit dhe për qëndrimin e saj parimor.

Takimi i radhës është caktuar për datën 2 prill dhe Kosova shkon në Bruksel e gatshme për marrëveshje.

Marrëveshja do të përfshinte, jo vetëm çështjen e asociacionit dhe shpërbërjes pa kusht të strukturave paralele, por edhe çështje të tjera shumë të ndjeshme, si ajo e personave të pagjetur, e telekomunikacionit, energjetikës dhe çështje të tjera.

Pjesë integrale e marrëveshjes do të jetë edhe plani implementues, me agjendë, afate dhe akte të definuara qartë, për çka Kosova është e përgatitur.

Marrëveshjen eventuale nuk do t'ia lëmë vetëm vullnetit të mirë. Kosova dhe partnerët e saj duan ta shohin implementimin e saj të menjëhershëm.

Në këtë drejtim, si delegacion i Kosovës, e kemi pasur një takim shumë produktiv me Sekretarin e Përgjithshëm të NATO-s, z. Rasmusen, nga i cili morën zotimin se në rast marrëveshjeje, KFOR-i do ta marrë rolin në kuadër të mandatit që ka për të siguruar dhe ndihmuar implementimin.

Ne me të drejtë presim që në të ardhmen e afërt, pas normalizimit të marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, edhe KS i OKB-së të përgatisë dhe miratojë një rezolutë të re, e cila do ta bëjë Kosovën anëtare të barabartë të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, si një shtet paqedashës dhe i gatshëm ta respektojë rendin dhe përgjegjësitë ndërkombëtare.

Sot, shteti i Kosovës e ka forcuar subjektivitetin ndërkombëtar.

Është e qartë që 2 prilli do të jetë vendimtar për marrëveshjen.

Po e përsëris, ne jemi shumë komodë në atë që është në tavolinë, sepse çdo gjë që është aty është në përputhje të plotë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me ligjet dhe Pakon e presidentit Ahtisari dhe me standardet më të larta evropiane.

Ne shkojmë në Bruksel të gatshëm për ta përmbyllur këtë kapitull dhe për të vendosur që ta hapim një etapë të re për Kosovën dhe rajonin në paqe dhe bashkëpunim.

Për këtë kemi mbështetjen e pafund të mikut dhe partnerit tonë strategjik, Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Gjatë takimit jashtëzakonisht miqësor që pata me zëvendëspresidentin Bajden, javën e shkuar në Romë, gjatë inaugurimit të Papës së ri, morëm mbështetjen e tij të plotë për këtë proces.

Në të njëjtën kohë, dua të theksoj se gjatë kësaj periudhe, në dhjetëditëshin e fundit, gjatë inaugurimit të Papës së ri, Vatikani, për herë të parë, Selia e Shenjtë e ka ftuar

delegacionin e Kosovës si delegacion i vendit të pavarur dhe sovran me trajtim dhe protokoll të shtetit të pavarur dhe sovran, bile të trajtuar në mënyrë afirmative.

Po ashtu, zëvendës-presidenti i SHBA-së, z. Bajden, na siguroi edhe një herë se Shtetet e Bashkuara të Amerikës nuk do ta mbështetnin asnjëherë asnjë proces dhe asnjë zgjidhje që do ta dëmtonte shtetësinë tonë. Dhe s'ka si të ishte ndryshe.

Shteti ynë i ri është rezultat i sakrificës sonë shekullore, por edhe i partneritetit tonë shumë të fuqishëm me SHBA-të, vendet e Bashkimit Evropian dhe NATO-n.

Për këtë arsye, ne shkojmë në Bruksel, të nderuar deputetë, qytetarë të Republikës së Kosovës, me vetëbesim dhe pa frikë, përderisa i kuptoj edhe shqetësimet, por ju lus që të jemi të gjithë të përgjegjshëm. Të mos ndjellim panik e frikë, sepse nuk ka arsye për këto. Prandaj, besojuni më shumë Uashingtonit, Berlinit e Londrës, e më pak asaj që trumbetohet në mediumet e Beogradit.

Besoni në ne, besoni në vetvete. Marrëveshja përfundimtare do ta marrë vulën në këtë Parlament dhe ajo që ju garantoj është se kjo marrëveshje do të jetë në dobi të Kosovës dhe të ardhmes së saj euroatlantike. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti kryeministër! Radha është te grupet parlamentare, fjalën e ka zoti Bajrami.

ARSIM BAJRAMI: I nderuar nënkryetar i Kuvendit,
Zoti kryeministër,
Ministra,
Kolegë deputetë,

Tani më jemi gati në finalizimin e një procesi shumë të rëndësishëm, një procesi shtetëror të Republikës së Kosovës, proces ky i cili do t'u japë fund destruksioneve të Serbisë në Kosovë dhe do ta hapë një rrugë të normalizimit të raporteve me Serbinë dhe do ta hapë një agjendë evropiane për Kosovën. Ne e dëgjuam raportimin e rregullt të kryeministrit, që është një praktikë jashtëzakonisht e mirë kushtetuese dhe parlamentare dhe Grupi ynë Parlamentar i jep një mbështetje të plotë vazhdimi të procesit dhe është i sigurt se ky proces do t'i mbrojë interesat kombëtare, do të mbrojë rendin unik kushtetues dhe Qeveria është plotësisht duke vepruar konform edhe me Rezolutën e Kuvendit të Kosovës.

Të nderuar kolegë,

Tani më po shihet se sa kanë qenë spekulative thëniet apo idetë që nga ky proces do të krijohet një status special, një Republika Sërpska, një Ahtisari plus, dhe po shihet se këto kanë qenë krejtësisht të pabaza, sepse ne, jo një herë, por disa herë e kemi thënë në këtë Kuvend që çdo ide e tillë do ta përmbyste krejt sistemin tonë kushtetues dhe idetë e tilla janë plotësisht të papranueshme, sepse Kosova i ka bërë të gjitha kompromiset e mundshme me rastin e shpalljes së pavarësisë dhe është jashtëzakonisht mirë që ne po e ruajmë partneritetin dhe koordinimin me partnerët tonë strategjikë, me të cilët edhe e kemi shpallur pavarësinë, dhe është plotësisht një praktikë e mirë që me ata që e kemi

krijuar shtetin, me ata po e zgjidhim edhe problemin e mbetur të shtetkrijimit, problemin e veriut, dhe jemi të sigurt se ky proces do të mbështetet nga bashkësia ndërkombëtare dhe do të mundësojë që vërtet atje të funksionalizohet sovraniteti dhe integriteti kushtetues.

Integrimi i veriut është një interes kombëtar i Republikës së Kosovës. Ajo është Kosovë, ajo është pjesë e Kosovës. Fatkeqësisht, këto 13 vjet ne nuk kemi mundur ta shtrijmë as Kushtetutën, e as sovranitetin tonë, e po i vjen fundi kësaj bllokade serbe dhe ne jemi të sigurt që po përfundon edhe destruksioni i fundit serb për ta mbajtur peng veriun dhe pas procesit të normalizimit, do të kemi sovranitet në veri, do të kemi veprim të Kushtetutës, do të kemi një gjendje kushtetuese.

Ky proces gjithë kohën është trajtuar si një proces shtetëror dhe Kosova ka ditur që në momente historike të krijojë një unitet politik në politikat kombëtare, në politikat shtetkrijuese dhe mendoj se është një proces, i cili është karakterizuar me faktin që kryeministri i ka mbajtur të njoftuara të gjitha institucionet kushtetuese. Parlamenti ka qenë në vazhdimësi i informuar, por e tha edhe sot, dhe e konfirmoi që Parlamenti do ta ratifikojë cilëndo marrëveshje dhe do të krijohet uniteti shumë i nevojshëm për këtë proces shumë të rëndësishëm.

Tanimë duhet ta kuptojmë se kjo nuk është një marrëveshje që do të koncentrohet vetëm te asociacioni i komunave, por do të jetë një marrëveshje gjithëpërfshirëse me disa elemente, një marrëveshje me garancitë ndërkombëtare dhe plan të implementimit. Momenti i parë dhe më i rëndësishëm është marrëveshja për shpërbërjen e strukturave ilegale dhe jokushtetuese të sigurisë, struktura këto që kanë qenë burim dhe gjenerator i të gjitha krizave dhe të gjitha problemeve që kemi pasur atje, që janë shfaqur edhe në forma të ndryshme të krimit, të krimit të ndryshëm dhe tanimë këto struktura do të shpërbëhen dhe atje do të vendosen autoritetet legjitime ndërkombëtare të sigurisë, të cilat kanë mandat ta ushtrojnë funksionin e sigurisë në Kosovë, në bazë të Kushtetutës së Kosovës.

Elementi i dytë atje do të krijohet pushteti lokal, qeverisja lokale legjitime, sepse kjo qeverisje lokale atje nuk është legjitime, nuk ka dalë nga Kushtetuta e Kosovës, nga legjislacioni i Kosovës, e marrëveshja parasheh mbajtjen e zgjedhjeve lokale dhe atje do të krijohen strukturat legjitime plotësisht në pajtim me legjislacionin zgjedhor të Republikës së Kosovës, natyrisht në fazën e parë ndoshta të ndihmuara nga OSBE-ja, që është një organizatë që asiston në të gjitha elementet tjera zgjedhore.

Është shumë me rëndësi që atje do të funksionalizohet edhe sistemi gjyqësor, pra do të kemi vendosjen e sistemit të gjykatave dhe thjesht do të kemi veprim të shtetit ligjor, i cili ka munguar shumë atje. Sa i përket të ashtuquajturit asociacion të komunave, për të cilin nganjëherë edhe gabimisht po koncentrohet debati vetëm te asociacioni i komunave, pra nëse serbët nuk kanë mundur ta mbajnë gjallë idenë e ndarjes së krijimit të një statusi special, ata janë koncentruar tani për një asociacion të komunave, që për mua është një alibi politike për t'u shfajësuar para popullit të vet që provuam dhe ata tani po provojnë përnjëherë nëpërmjet asociacionit të komunave të krijojnë një ide dalëse nga iluzionet

dhe mitet që kanë krijuar për Kosovën dhe që tani po shihet se kanë qenë iluzione dhe po pajtohen me realitetin e ri.

Sa i përket asociacionit të komunave, ne e kemi parë gatishmërinë edhe të Bashkimit Evropian, që ky asociacion të funksionalizohet sipas praktikave të Kartës Evropiane për Qeverisje Lokale sipas praktikave të legjislacionit të Kosovës për qeverisjen lokale, që mund të jetë një legjislacion më i avancuar evropian sa i përket qeverisjes lokale dhe nga ajo që është bërë publike, kemi parë se ky asociacion nuk del aspak nga kornizat e ligjeve të Kosovës dhe nuk kemi pushtet të tretë, sepse po të kemi pushtet të tretë, ne duhet ta ndërrojmë Kushtetutën. Kushtetuta e Kosovës e njeh organizimin territorial të Kosovës në dy nivele, në nivel të komunës e në nivel të Republikës, dhe asnjë pushtet i tretë apo asnjë pushtet ekzekutiv dhe legjislativ nuk mund të ndërrohet pa u ndërruar Kushtetuta e Republikës së Kosovës.

Çdo metodë tjetër do të ishte një lloj ataku në sistemin kushtetues dhe do të ishte krejtësisht e palejueshme dhe ne insistojmë që në takimin e mbetur më 2 prill të finalizohen finesat juridike sa i përket këtij asociacioni, të mos lihet asnjë pakuptimësi, asnjë dualizëm, asnjë mundësi e interpretimit të ndryshëm. Serbët le ta quajnë “zajednica”, për ne është asociacion i komunave. Nëse atyre ju pëlqen, ata le ta quajnë ashtu, por ne duhet të jemi shumë të qartë te finalizimi juridik i marrëveshjes dhe nuk duhet lënë dykuptimësi çfarë për shembull ka pasur Rezoluta 1244, e cila në shumë zgjidhje ka qenë duale dhe ka shkaktuar probleme dhe ka bërë që UNMIK-u shpeshherë ta interpretojë atë rezolutë në mënyrë subjektive.

Kështu, ne insistojmë që kjo marrëveshje të finalizohet dhe në aspektin juridik të spastrohet plotësisht nga çfarëdo dileme juridike apo dykuptimësia.

Në fund, më lejoni, në emër të Grupit Parlamentar, t'i paraqes katër sugjerimet për delegacionin e Kosovës.

E para, u tha që marrëveshja duhet të jetë me garanci të fuqishme ndërkombëtare, pra do të jenë garancie të nivelit të Bashkimit Evropian, të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe kjo është një marrëveshje ndërkombëtare që u jep fund destruksioneve dhe probleme në veri.

E dyta, ne kërkojmë që plani i implementimit të jetë i sofistikuar, sepse nuk u besojmë praktikave serbe për një implementim. E kemi pasur rastin edhe me këto marrëveshje teknike dhe ne kërkojmë që ky plan të jetë pjesë e paketës së marrëveshjes dhe ky plan të jetë plotësisht i afatizuar me muaj, me ditë, që të përfshihen edhe detyrimet dhe obligimet e të gjithë partnerëve ndërkombëtarë në implementimin e kësaj marrëveshjeje.

E treta, si grup parlamentar, kërkojmë që Bashkimi Evropian të ketë qasje shumë më afirmative ndaj Kosovës dhe ta trasojë një rrugë të integritit evropian, të filloj ta ndërtojë plotësisht një agjendë të qartë të integritit të Kosovës në Bashkimin Evropian, ta vlerësojë këtë qasje të moderuar të delegacionit të Kosovës dhe ta shpërblejë Kosovën ndoshta me një status të privilegjuar sa u përket integritimeve evropiane.

Dhe, sugjerimi i katërt i Grupit Parlamentar, e tha edhe kryeministri, është një rast ndoshta i mirë që të kërkohet nga sponsorët e pavarësisë së Kosovës, në radhë të parë nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Anglia, Franca dhe Gjermania që ta fillojnë eventualisht idenë e draftimit të një rezolute për Këshillin e Sigurimit, me të cilën do të fuqizohej dhe do të nxirrej jashtë fuqie Rezoluta 1244 dhe kjo marrëveshje do të implementohej nëpërmjet një rezolute të re të Këshillit të Sigurimit, e cila në një mënyrë edhe do ta forconte këtë marrëveshje, do ta bënte jo vetëm marrëveshje të Bashkimit Evropian, por marrëveshje obligative edhe për OKB-në dhe njëkohësisht nëpërmjet saj do të trasohej rruga për anëtarësimin e plotë të Republikës së Kosovës në Organizatën e Kombeve të Bashkuara dhe atëherë nuk do ta kishim problemin e njohjeve, sepse rezoluta, e cila do ta pranojë rezultatin e normalizimit, në fakt do ta hapë edhe rrugën e aplikimit të Kosovës për anëtarësim në OKB dhe pranimin final të këtij procesi.

Duke i dhënë edhe një herë mbështetje procesit, ne e dimë që ky proces nuk ka qenë aspak i lehtë, por ka qenë një obligim shtetëror, ka qenë një detyrim shtetëror për ta zgjidhur problemin e veriut, sepse këto 13 vjet ne kemi pasur status quo dhe ka qenë interes kombëtar i Kosovës që të zgjidhet çështja dhe ne i kemi dhënë gjithmonë mbështetje këtij procesi dhe urojmë që ky proces të finalizohet, duke i mbrojtur plotësisht interesat kushtetuese të Republikës së Kosovës dhe urojmë që ky Kuvend ta ratifikojë këtë marrëveshje me një unitet politik, në mënyrë që, në fakt, ne të konfirmojmë që në momentin kur janë në pyetje vendimet shtetërore dhe vendimet e karakterit kombëtar, nuk ka shumë rëndësi përkatësia partiake, por më tepër përgjegjësi, sepse nganjëherë duhet të marrësh përgjegjësi edhe për proceset që janë edhe pak të vështira, jo vetëm për proceset e lehta, dhe me këtë tregohet edhe përgjegjësi jonë politike si deputetë dhe si njerëz, të cilët jemi përgjegjës për t'i zgjidhur problemet, me të cilat është ballafaquar vendi ynë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka nënkryetari i Kuvendit, zoti Hamiti.

SABRI HAMITI: Zoti kryesues!

Zoti kryeministër dhe ministra,

Kolegë deputetë të çmuar dhe të dashur,

Ne sot e dëgjuam edhe një herë një informatë, ta quaj unë komentuese, vlerësuese të kryeministrit për një rund të fundit që ka pasur në dialogun politik Kosovë-Serbi.

Po të ishte njeri i zoti që të pajtohet aty për aty me fjalët e artikuluar të kryeministrit, do të thoshim se ne jemi në një fillim festiviteti. Unë besoj që nuk jemi, por sido që të jetë unë i mirëpres vlerësimet e tij për rezultatet që ai thotë se janë arritur deri më sot në këtë dialog. Unë edhe një herë tjetër, duke folur për këtë temë, sepse është temë që po flitet në Kuvend për herën e shtatë, për çdo rund ne jemi takuar dhe kemi biseduar këtu me kryeministrin, që puna e fjalëve, edhe kontrata e fjalës, ka mbaruar atëherë kur është bërë e pabesueshme dhe ka kaluar në shkrim në ligje, në dokumente.

Kjo është universale dhe unë e di që zoti Kuçi, që është ekspert i kësaj pune, e di po si unë. Aq më tepër puna e fjalës së shkruar është domosdoshmëri, edhe për punët më të vogla, edhe kur ke punë me partnerë edhe më të besueshëm, se që është bashkëbiseduesi i

Hashim Thaçit në këto bisedime. Prandaj, ajo që unë dua të theksoj veçanërisht sot, është: le të jetë krejt kështu siç thotë zoti Hashim Thaçi, kryeministri i Republikës së Kosovës. Unë mendoj, gjykoj dhe kërkoj, në bazë të të vetmit dokument që ka Kuvendi i Republikës së Kosovës për këtë dialog, e kjo është Rezoluta, pra bazuar në të, të gjitha këto qëndrime që janë fiksuar nga delegacioni i Kosovës të bëhen tekst dhe të vijnë në Parlament, dhe ky është detyrim. Është detyrim, sepse ne po themi se po shkojmë kah fundi i këtyre bisedimeve, ne po themi, bashkë me kryeministrin, që ky 2 prilli është dita kur vendoset, Dita D për Kosovën.

Unë mendoj që nuk është Dita D për Kosovën personalisht, por unë jam njeri që i respektoj detyrimet institucionale. Pse nuk është dita D? Nuk është e thënë që kjo marrëveshje do të duhej të bëhej vetëm me dy, e assesi me tre, katër ose pesë. Nuk është e thënë, aq më tepër kur kryeministri na tha që brengat le të bien mbi Serbinë, ata e kanë vështirë se ne e kemi shumë lehtë. Atëherë na nuk kemi kurrfarë urgjence historike, politike, nacionale, konstitucionale, qytetare që të marrim hov që domosdoshmërisht po u dashka që më 2 prill të ndodhë kjo. Aq më tepër që më inkurajon kryeministri dhe e shënova që zotohet që nuk ka kurrfarë presioni prej askujt, as prej miqve të deklaruar, as prej miqve të padeklaruar, dhe armiqve, ta quajmë kushtimisht të Kosovës, që të pranohet diçka që nuk është në interes të Kosovës, që i bie që e shkel Kushtetutën, ligjet në fuqi e të tjera.

Pra, presion nuk kemi prej askujt, presion kohor për Kosovën nuk kemi, atëherë unë 2 prillin në këto bisedime, në këtë dialog, nuk e shoh Dita D. Kur thashë që ne na duhen tekstet, qoftë edhe kur ne shkëlqejmë nga dëshira ose vullneti që të mbërrijmë atë që e kemi, meqë edhe motivimin unë e pranoj në komunikimin publik dhe institucional, atëherë po them ngadalë në shtyp, sepse ne nuk kemi dokument, qarkullojnë 8 pika që thuhet që u janë vënë r delegacioneve nga BE-ja, që i sjell zonja Eshton në tavolinë, njëfarë dokumenti me 8 pika. Unë bile e kam, në njërën prej gazetave jam përpjekur pak a shumë është i njëjti tekst. Nëse ky është teksti dhe zëvendëskryeministri Kuçi dje tha që ka ekzistuar një tekst dhe ne aty për aty i kemi dhënë vërejtjet me shkrim, shumë mirë. Atëherë le t'i silllet Kuvendit ky tekst, të dihet që është ofertë zyrtare në dialog, interpretimet ose vërejtjet zyrtare të delegacionit tonë dhe bashkë me të tutje.

Nëse Qeveria e ka aprovuar dje ndonjë dokument që lidhet me dy ligjet bazike rreth këtij problemi, e është Ligji për vetëqeverisjen lokale dhe Ligji për bashkëpunimin ndërkomunal, të shohim a është ai dokument përtej këtyre dy ligjeve, e kemi Kushtetutën dhe Parlamenti atëherë i thotë kryenegociatorit tonë 'ne jemi paraprakisht të informuar dhe ne të mbështetim për këtë, ose nuk të mbështetim'. Dhe, kjo është logjika e komunikimit institucional të Parlamentit të Kosovës me grupin negocues, që i bie Qeveria e Kosovës. Për të qenë të gatshëm pastaj nesër t'i rimarrim me përgjegjësi ato që mund të jenë marrëveshje me shkrim, me datë implementimi nga këta dialogë, përndryshe unë e kuptoj perceptimin e mirë të kolegut Arsim Bajrami, por qorras unë nuk mund t'i them askujt do të përkrah dhe eja se do t'i votojmë në Parlament. Besoj që nuk e bën as ai në atë formë. Por, për të arritur atje, nuk duhet të flasim si simpatizantë të Kosovës, se të gjithë e duam. Nuk e kam ndërmend të bëj garë me askënd, as si moshë, as

si dije, as si përgjegjësi, por ato që thuhet duhet të bëhen letra, të shikohen, të lexohen, të merren përgjegjësitë e sekujt në bazë të detyrave që i ka.

Qëndrimi im këtu sot çfarë fola është i Lidhjes Demokratike të Kosovës. Nuk është imi personal. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Aliu.

LIBURN ALIU: Të nderuar deputetë,
Dhe kështu pra, takim pas takimi, çdo gjë po merr formën e mbrapshtë, ashtu siç patëm paralajmëruar ne të Lëvizjes “Vetëvendosje”.

Unë këtë fjalim po ia drejtoj negociatorit në këto negociata pa kushte, dëgjoi ai, apo jo. Ne e patëm rastin që në pikën, që po quhet raportim, ta dëgjojmë një fjalim, i cili nuk ka asgjë, përpos fjalëve “duhet të besoni”. “Duhet të besoni, duhet të besoni”, kjo është e tëra nga fillimi deri në fund.

Në ndërkohë që përmendet oferta në tavolinë, në ndërkohë që përmendet dokumenti në tavolinë, në ndërkohë që nëpër media dëgjojmë se diçka e tillë po qarkullon, në ndërkohë që zëvendëskryeministri e pranon se kanë marrë një dokument të tillë, e ai dokument ne, në këtë të ashtuquajtur raportim, as që na ka ardhur, e as që po e dimë për çfarë bëhet fjalë. Pra, a mund t’i thuhet këtij raportim? Jo, ky nuk është raportim. Kjo është një farsë që po quhet raportim. Ne realisht nuk po dimë në fakt asgjë se çfarë ka ndodhur. Ne sot po mund vetëm të diskutojmë e të flasim mbi ato çfarë është publikuar në media deri tani, e që ka qenë një dokument me 10 pika, pastaj ka qenë një dokument me 8 pika.

Nëse i shohim mirë ato dokumente, del që ka një lidhje logjike të këtyre dokumenteve me gjithë rrjedhën e negociatave deri tani. Pra, nuk është që ato duhet të mos i marrim parasysh fare, sidomos për faktin që këtu nuk e patëm asnjë dokument të publikuar. Edhe dokumenti prej 8, edhe dokumenti prej 10 pikash, e definon çështjen e kompetencave.

Thuhet që kompetencat e komunave, të cilat i kanë ato do t’i barten asociacionit. Nëse këto kompetenca të komunave i barten asociacionit, kjo i bie që po krijohet niveli i tretë, sepse një nivel i mesëm do t’i ketë kompetencat, të cilat i ka komuna. Të gjitha komunat bashkë do t’i definojnë kompetencat e tyre nëpërmjet asociacionit. Kjo nuk është gjë tjetër, përpos edhe më tej se autonomia.

Nëse e shikojmë rrjedhën logjike të këtyre negociatave, unë dua t’ia drejtohem kryeministrit, apo negociatorit në këto negociata, që fillimisht i keni dhënë financat, nëpërmjet të ashtuquajturit Fond për zhvillimin e veriut, e që nënkuptonte burime të definuara të ndara të financave, si dhe nivel të ndërmjetëm të menaxhimit, e që është në kundërshtim me Kushtetutën. Pra, ky asociacion do të ketë burim të veçantë të financave, përveç pikave doganore, do të ketë menaxhim të veçantë. Ky është niveli i tretë. Nuk mund të jetë nivel qendror, sepse Ministria e Financave nuk po ia jep drejtpërdrejt secilës komunë, veç e veç. Por, në mënyrë të përbashkët po menaxhohen financat për këtë asociacion, e kjo pra është e ndarë në vija etnike.

E ke dhënë pastaj territorin, nëpërmjet asaj që t'i e quaje asociacion i komunave me shumicë serbe, e që ishte i ndarë në baza etnike, ku definohet qartë ,edhe territori, edhe etnia. Sërish pra, thellim i ndarjes në vija etnike.

Praktikisht, ti e pate dhënë autonominë që atëherë, pavarësisht asaj që përpiqeshe të na deklaroje këtu ndryshe prej deklarimit të sotëm. Këtu na bëheshe trim, e atje bëje pazare. Këtë storie jo rrallë e kemi përjetuar sidomos ne të “Vetëvendosjes” nga pushteti yt.

Do të kesh rast ende të tregohesh trim me ne. Protestat nuk do t'i ndalim, dhe aty do të jepet rasti. Ja ku e ke Bajram Rexhepin. Mund të vazhdosh ta urdhërosh, e ky mund të vazhdojë ta urdhërojë Policinë, por atë që po ta themi këtu nuk ke për ta ndalur dot. Ke me siguri edhe instrumente tjera, por as ato nuk mund të na ndalin dot.

E të gjitha këto lëshime që i ke bërë dhe do t'i bësh, ne t'i kemi thënë me kohë. T'i kemi thënë para se të fillonin të ndodhnin. Ty dhe të tjerëve. Tani nuk mund të nxirresh duke u shtirur se ‘nuk ju kam dëgjuar’.

Pra, ti e dhe autonominë që në fillim, por Serbia nuk mjaftua, ashtu si pas çdo takimi e negociate me të, që nga viti 2006, edhe përkundër gatishmërisë së treguar për kompromis nga ju.

Dhe, lëshim pas lëshimi tani kemi arritur në pikën, kur tani po diskutojmë për dokumente të ndryshme.

Ato kompetenca, pra kur bëhet fjalë për dhënie të kompetencave këtij asociacioni nëpërmjet komunave, ku pastaj ky asociacion mund të ndërtojë marrëdhënie edhe me ndërkombëtarët, e edhe me Serbinë drejtpërdrejt, në mënyrë të pavarur nga Prishtina, realisht i bie përtej autonomisë së vitit 1974, që e kishte Kosova nën Jugosllavi. Cila lidhje i mbetet këtij trupi me Qeverinë e Kosovës? I mbetet vetëm çështja e zgjedhjeve dhe çështja e dërgimit të përfaqësuesve në këtë Kuvend. Po është shumë e natyrshme sepse ata këtu e kanë të drejtën e vetos.

Kosova, pra, po ndahet në dy pjesë, në pjesën serbe dhe në atë multietnike, ku njëra pjesë ka më shumë pavarësi sesa tjetra. Pjesës serbe nuk mund t'i imponojë askush asgjë, e as autoriteti qendror në Prishtinë, ndërsa pjesa tjetër multietnike mbetet e varur nga vetoja edhe për çështjet e brendshme nga pjesa serbe.

Pra, kushtëzimet që pjesa serbe i bën pjesës multietnike nuk mund t'ia bëjë pjesa tjetër asaj serbe. Kjo është më zi se në Bosnjë. Ne nuk mund të përziemi në çështjet e tyre, ndërsa për çdo çështje ata mund të përzihen në çështjet, në problemet tona, nëpërmjet të drejtës së vetos që e kanë këtu në Kuvend. Kjo është definitivisht më zi se në Bosnjë, meqë atje të mos harrojmë se republikat ndërmjet veti kanë marrëdhënie reciprociteti. Pavarësisht që është formë e së keqes së mbrapshtë, ato kanë njëfarë marrëdhënie reciproke ndërmjet veti, e këtu, lëre që ne nuk po kemi reciprocitet me Serbinë, por nuk do të kemi reciprocitet as me këtë pjesën serbe në kuadër të Kosovës.

E, në çfarë gjendje e solle këtë vend, o Hashim Thaçi!

Po nuk e ke sjellë vetë, se jam i sigurt se nuk do të kishte mundur ta bëje pa të ndihmuar. Dhe, prapë Serbia e Daçiçi mbeten të pakënaqur. Ata duan ende, duan jo autonomi të 74-tës, por duan Republikë. Po duan pra që policia e tyre të jetë e pavarur, edhe pse e kanë të koordinuar tanimë me lëshimet e deritanishme në baza etnike brenda këtij territori, dhe duan ligjësi të pavarur, pra ligje të Serbisë, edhe pse po fitojnë në njëfarë mënyre gjyqësi të ndarë.

Nuk u mjaftojnë kompetencat që lidhen me zhvillimin ekonomik, nuk u mjafton kontrolli mbi resurset ekonomike e të tjera. Por, përse të mos duan? E kanë shansin, po e shfrytëzojnë maksimalisht. Nuk do ta kenë më mundësinë të negociojnë kësisoj, kur nuk do të jetë Hashim Thaçi, pasi qytetarët e Kosovës janë gjithnjë e më të vetëdijshëm në raport me realitetin që i rrethon.

Tani Serbia është edhe më këmbëngulëse, është pasi nuk është e kushtëzuar, pasi pala tjetër nuk ua përmend kurrë shqiptarët e Preshevës, Bujanocit e Medvegjës, të cilët po vazhdojnë të mbeten nën shtypje e terror dhe e tërë kjo po quhet normalizim.

Nga i tërë ky proces, rrjedh normalizimi ndërmjet Serbisë dhe BE-së, dhe normalizimi i Kosovës nga brenda. Rrjedh normalizim ndërmjet Thaçit e Daçiçit, por abnormalizim i marrëdhënieve ndërmjet shqiptarëve dhe serbëve. Normalizim i marrëdhënieve dhe madje lidhje direkte zyrtare ndërmjet serbëve të Kosovës dhe Serbisë dhe ndarje me taksa e kufij ndërmjet shqiptarëve të Preshevës, Bujanocit e Medvegës me Kosovën.

Ndërsa nga kryeministri ynë nuk mund të presim tjetër, pasi këtu nuk kemi të bëjmë vetëm me dobësi, por kemi të bëjmë edhe me mendësi. Nuk mund të presim ndryshe nga njeriu që thotë se liria e Kosovës ka filluar me Rambujenë, e jo me luftën e popullit tonë për liri. Dhe, me këtë kryeministër ky proces do të vazhdojë dhe do ta kemi të qartë se është garantuese çdo gjë, sepse edhe marrëveshjet e deritanishme që po fliten e përfliten që do të zbatohen, pavarësisht përfundimit të nënshkrimit, pra marrëveshjet e mëhershme që kanë ndodhur, janë kusht që do të ketë cikle të vazhdueshme e të vazhdueshme të negociatave edhe në të ardhmen. Pse? Në vitin 1999 u dorëzuan armët, sepse kështu u pajtua Thaçi në Rambuje, edhe pse nuk pati marrëveshje përfundimtare.

Pakoja e Ahtisarit u zbatua, edhe pse nuk pati marrëveshje me Serbinë, edhe pse Serbia nuk e pranonte atë si të tillë. Madje-madje, edhe pavarësia u deshtë të shpallet në mënyrë të njëanshme, edhe pse ndodhen negociatat që në fund të përfundonte me një pavarësi. Pra, përse të mos ketë interes Serbia të negociojë kësisoj, ku nuk ka as kushte? Në fund, ajo nuk pajtohet, ndërsa kompromiset zbatohen.

Kështu në mënyrë ciklike, me këtë mendësi, në negociatë pas negociate, e pa kushte, duke mos na njohur Serbia dhe duke u zbatuar kompromiset e njëanshme do të vazhdojnë derisa ne të bëhemi plotësisht si Bosnja dhe kur atëherë edhe Serbia do të mund eventualisht ta njohë, pasi Bosnjën e ka njohur tek pas...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Desha të të përmirësoj, se Thaçi nuk i ka dorëzuar armët, por ka qenë një marrëveshje, të cilën e kanë pranuar të gjithë komandantët e zonave dhe Qeveria e Përkohshme. Zoti Gjini e ka fjalën.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti nënkryetar i Kuvendit!

Zoti kryeministër,

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Po më duket që po shkon në përsëritje kjo pikë e rendit të ditës prej javës në javë. Po i dëgjojmë ato që i kemi dëgjuar në gazeta. Do të thotë asnjë send të ri, asnjë informatë të re, do të thotë asnjë gjë të ri. Krejt çka po dimë, po përsëritet edhe një herë dhe po duket që po zhvillohet debat për ët komentuar, por nuk është më informatë, se zakonisht po i dimë krejt. Nuk po del diçka e re për Kuvendin që nuk ka dalë për media. Sidoqoftë, edhe nëse përsëritemi, nganjëherë nuk është keq, edhe të gjithë po përsëritemi, me siguri se edhe unë do të përsëris atë çfarë e kemi thënë më herët, e ajo është që çfarëdo marrëveshje që arrihet është obligative të ratifikohet në Kuvendin e Kosovës dhe ky Kuvend e ka procedurën e vet të ratifikimit dhe e mban drejtën të pajtohet ose jo dhe mendoj se të gjithë duhet ta dimë se kjo është temë tepër serioze. Nuk është vetëm togfjalësh, nuk është vetëm klishe, ose nuk është vetëm një radhë e thënë, por Kuvendi me të vërtetë duhet ta ratifikojë ndonjë marrëveshje, e cila do të jetë e arritur, që ka të bëjë me jetën e qytetarëve të Kosovës dhe me Kosovën. Kjo është ajo që unë desha ta them sot.

Analizat mendoj se mund t'i bëjmë në vazhdimësi, por po më duket që po na dalin interesante. Edhe një koment dua ta bëj. Po përmendet shpesh Dita D. Nuk po më duket analogji e mirë. Dita D është dita kur ka nisur lufta në tokë, kur ka nisur invazioni, nuk është Dita D - Dita e Çlirimit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Kryetarja e Grupit Parlamentar të Koalicionit për Kosovë të re, zonja Selmani e ka fjalën.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, i nderuar nënkryetar i Kuvendit!

Përshëndetje për kryeministrin dhe Kabinetin qeveritar,

Përshëndetje për deputetët,

Duke marrë parasysh që kryeministri është i obliguar, në bazë të Rezolutës e cila është miratuar në Kuvend, që të raportojë pas çdo takimi me kryeministrin serb dhe baroneshën Eshton, atëherë e përgëzojmë që është viza-vijë me Rezolutën, e cila është miratuar në Kuvendin e Kosovës, dhe është viza-vijë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, e cila obligon që të jetë pjesë e këtyre bisedimeve dhe të raportojë në Kuvendin e Kosovës.

Kryeministri tha se çështja e dialogut është në fazën më të ndjeshme, mirëpo jo për Kosovën, por për Serbinë, duke pasur parasysh se Serbia është ajo e cila i formoi strukturat paralele të sigurisë në veri të Kosovës dhe duke pasur parasysh se Serbia është ajo e cila duhet të ketë presion nga Brukseli dhe Uashingtoni, për arsye se Kosova është njohur afërsisht nga 100 vende dhe është shtet i pavarur edhe në bazë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

U theksua edhe çështja e asociacionit të komunave. Mund të themi se në raportimi e tij, kryeministri po qëndron prapa fjalëve të veta, duke thënë se këto asociacione nuk do të kenë kompetenca ekzekutive dhe shpresojmë dhe besojmë shumë në politikat e BE-së, të Brukselit dhe të Uashingtonit, që kjo çfarë thotë kryeministri të jetë në përkrahje të këtyre miqve tanë për arsye se ju e dini mjaft mirë se çështja e bisedimeve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë është çështja e bisedimeve për stabilizimin e marrëdhënieve ndërmjet dy shteteve të pavarura.

Dhe e fundit që u dëgjua në këtë prezantim të kryeministrit ishte se çështja e bisedimeve është çështje edhe për asociacionin e komunave, edhe për çështjen e telekomunikacionit, të energjetikës, të personave të pagjetur, mirëpo esencialja e gjithë këtij raportimi të kryeministrit ishte çështja e një rezolute për shfuqizimin e Rezolutës 1244 dhe ne si Grup Parlamentar kërkojmë që ajo të shfuqizohet dhe Kosovës t'i hapet rruga në OKB, që të pranohet sa më shpejt.

Urojmë dhe përgëzojmë që kryeministri të jetë viza-vijë me Kushtetutën dhe Rezolutën, e cila është miratuar në Kuvendin e Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! SLS-ja dhe “6+” nuk kanë të paraqitur. Fjalën e ka kërkuar zonja Trajković. Nemoj da kažeš da ti ne dajemo reč.

RADMILA TRAJKOVIĆ: Poštovani predsedavajući!

Ja danas očekujem da me nećete prekidati. Želim da vam kažem da sam pažljivo slušala izlaganje gospodina Thači, i jako je dobro što dolazi u Parlament i informiše nas, makar onoliko koliko i on ima mogućnosti da to uradi, s obzirom da najverovatnije postoje ograničenja koja obavezuju i jednog i drugog pregovarača. Ja sam bila uvek veliki pristalica razgovora između Beograda i Prištine, iz vrlo relevantnih razloga, jer sam mislila da ti razgovori treba da donesu stabilnost Kosovu i Metohiji, i ostatku Srbije. Međutim, to moram da vam kažem, o onoj što je izložio premijer, ja mislim da ne ide u tom smislu. Čvrst stav, ograničen striktno na Ustavu, bez ikakvih pripreme za bilo kakav kompromis, više liči na diktat izdiktiran, nego što liči na nešto što treba da bude ustvari rezultat svih razgovora, a to je kompromis.

Beograd je napravio veliki ustupak prihvatajući teritorijalnu celovitost na način što je prihvatio integrisano upravljanje granicama, i u tom smislu pokazao međunarodnoj zajednici da više ne može da je optužuje, da Beograd radi na podeli Kosova i da je njegovo funkcionisanje u tom smislu. Ali, ako se do toga došlo, i ako se stalno govorilo da je za Srbiju važnija teritorija od ljudi, sada kada su ljudi tema prava opstanak Srba na ovom prostoru, onda se ne daje ni prava Srbima. Poštujem i znam da premijer ima podršku svojih mentora i NATO-a, i Amerike i Brisela, i Berlina i Londona, ali ja bih volela isto tako i borim se već 13. godina, da ja njih dobijem kao sponzore za multietničnost prostora Kosova i Metohije, koja će podrazumevati opstanak Srba da žive onde gde su rođeni, da funkcionišu na način što će moći dugotrajno da računaju na dobronamernost svojih komšija.

17. mart 2004., zatim 21. januar 2013., kada su rušeni naši grobovi, govori o tome da nažalost mi nemamo dobronamernost, i u tom smislu, ja mislim da Beograd je potpuno u pravu kada traži zajednicu srpskih opština, koje će nas povezati, gde ćemo svi zajedno funkcionisati na način koji podrazumeva institucionalno i funkcionalno borba za naš opstanak.

Ja moram da kažem, nije dobar sporazum i nije moguć sporazum, koji će izazvati destabilizaciju Beograda, ili destabilizaciju Prištine. Nije dobar sporazum koji će izazvati destabilizaciju Srba sa ovog prostora bez garancija. Taj proces, onako kako nam je predstavio premijer, neće ići u smislu stabilizacije Srba, i neće se moći implementirati kod Srba. Zato bih želela da zamolim sve vas, da zajedno, nije ovaj prostor jedinstven po tome da ima problema sa zajednicom koja nije dominantna na ovom prostoru. I Makedonci imaju problem sa Albancima u Makedoniji, i Crnogorci imaju svoja neke probleme koje rešavaju, i Beograd ima sa jugom centralne Srbije, i u Bosni ima sličnih problema. Dakle, nije ovaj prostor nešto posebno i jedinstven, i jedini koji ima probleme sa zajednicom koju nikada nije pitao da li hoće da prihvati nezavisnost, i pod kojim uslovima i na kakav način želi da bude deo institucija u Prištini.

Zato molim i ovaj Parlament i u perspektivi da svi zajedno pokažemo spremnost jedni prema drugima, da ne bude ovo pričaonica koja će upućivati jake poruke prema Srbima. Moja velika želja i cilj uvek je bio da moj narod u što većem broju opstane na ovom prostoru, i oni koji su proterani da se vrate. Žao mi je, ali mislim da prekjučerašnji sastanak, gospodina Jelka Kacina sa Srbima, koji su oputovali mimo ikakve podrške, od strane međunarodnog predstavnika predstavlja miniranje Srpskog tima, i miniranje uopšte tih pregovora. Zar treba neko paralelno, doduše kod Albanaca ima to jedinstvo kod tih državnih problema i državnih pitanja, kod Srba nažalost uvek ima tih paralelnih kanala, gde odlaze da izveste nešto što suštinski nije ustvari odgovor Srba. I u ovom trenutku neki Srbi se nalaze na severu Kosova ispred suda. Ja sam potpuno opredeljena da svi koji su uvek odgovorni za bilo šta, što je u suprotnosti sa zakonom, odgovaraju, ali mislim tajming je malo težak.

Znate, međunarodna zajednica imala razumevanja i dalje ima razumevanja. Za mnoge osumnjičene i za kriminal ekonomskih i za kriminal etničkih, ne podiže optužnice. Zašto u ovom momentu podizati tenziju na severu, koji je i onako uplašen od procesa integracija, jer verujte, rezultati integracije, makar što se tiče rezultata na terenu, vrlo su teški sa Srbe jer nas nažalost iz dana u dan sve manje i manje. Hvala vam što ste bili korektni svi. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! Unë jam i bindur që institucionet e Kosovës janë të interesuara që komuniteti serb t'i ketë të gjitha të drejtat e veta dhe të jetë i trajtuar brenda Kosovës dhe po besoj që në atë frymë po zhvillohen bisedimet edhe ndërmjet dy vendeve tona, respektivisht dy kryeministrave. Zoti Kuçi e ka kërkuar fjalën.

HAJREDIN KUÇI: Faleminderit, i nderuari nënkryetar i Kuvendit!

Kryeministër,

Anëtarë të Qeverisë,

Të nderuar deputetë,

Zonja dhe zotërinj,

Më lejoni që pasi u përmendën edhe disa çështje, ndoshta edhe nëpërmjet emrit tim të deklarimeve të mia, por edhe procesit në tërësi, të theksoj apo t'i jap disa sqarime, nëse mund, për tri fenomene, apo tri procese. E para ka të bëjë me dialogun në tërësi. E dyta, me siguri me dokumentin që u përmend dhe u diskutua edhe më herët dhe, e treta, që duhet po ashtu ta mendojmë, ndoshta edhe si Kuvend, si institucione, dështimin eventual të këtij dialogu.

Sa i përket dialogut si proces, mendoj se ne kemi ardhur në këtë gjendje të dialogut si rezultat i asaj që nuk i kemi rregulluar raportet në tërësi, do të thotë në raport me Serbinë dhe unë do të jem pak më i drejtpërdrejtë për ata të cilët kanë dilema për dialogun, do të them - jo vetëm në raport me luftën, por Kosova ka bërë një rezistencë paqësore për vite të tëra, Kosova ka bërë një angazhim gjithëpopullor edhe në luftën për çlirim, ka marrë pjesë në Rambuje, ka marrë pjesë në Vjenë në dialog me bashkësinë ndërkombëtare, ka marrë pjesë edhe shpalljen e pavarësisë bashkë me bashkësinë ndërkombëtare dhe se ka hequr krejt Serbinë prej Kosove. Ky është një realitet. Ende na ka mbetur Serbia në një pjesë të Kosovës dhe unë mendoj se kjo pjesa veriore, atje ku kemi të bëjmë drejtpërdrejt me strukturat e Serbisë dhe ky dialog po bëhet që ai shtet të mos ndërhyjë në punët e brendshme të Kosovës, po bëhet që ta bindim faktorin ndërkombëtar të jetë me gatishmëri më të madhe se deri më tani për të vendosur rend dhe ligj atje, për të rregulluar të thosha sistemin edhe juridik, edhe të rendit, dhe të gjitha sistemet tjera, dhe po bëhet që t'i bindim edhe ato shtete, 5 sosh, të BE-së që nuk e kanë njohur ende Kosovën dhe tjerat në OKB që Kosova po e shfrytëzon edhe një mesatare të asaj që ka vullnet për dialog.

E mira e këtij dialogu që është Kosova e ka bërë kompromisin në vitin 2007 dhe kjo është ajo që kryeministri e tha edhe më herët. Presioni i bashkësisë ndërkombëtare ka qenë në vitin 2007, dhe të gjithë ne që kemi qenë në atë proces, që kemi qenë në këtë Kuvend, por edhe të tjerët që kanë punuar në implementim dhe qytetarët në mirëkuptim të atij procesi, e kanë ndier peshën e atij presioni të asaj kohe dhe tani i njëjti faktor ndërkombëtar po ndërmjetëson me ne. Ata që më 2007 kanë kërkuar prej nesh kompromis dhe unë po them kompromisin Kosova e ka bërë për qëllim të të drejtave etnike për serbët në Kosovë, e ka bërë me qëllim të balanceve gjeografike të ushtrimit të sovranitetit edhe me veriun, dhe tani më të njëjtit faktorë nuk mund të kërkojnë shumë prapë nga ne edhe një kompromis tjetër. Kjo është ajo lehtësira, po e quaj por, nëse më lejohet ta them me fjalën popullore "Fruthin e kemi kaluar pak më herët". Kjo është ajo qëndrueshmëria që tash.

Përndryshe, po ashtu duhet të them që faktorët ndërkombëtarë relevantë edhe dokumenti që po lidhet me faktin konkret, është i propozuar nga BE-ja dhe 90% është në vijë të njëjtë me atë që është paraparë në Kushtetutën dhe ligjet tona. Por, me fjalë tjera, është në linjë të njëjtë me Pakon e presidentit Ahtisari, të cilin në atë kohë BE-ja e ka kërkuar nga ne, edhe SHBA-ja, edhe të gjithë të tjerët që kanë qenë në proces, duke pasur parasysh dy faktorë, jo vetëm gjendjen në Kosovë.

Kompromisin në vitin 2007 ne e kemi pranuar më shumë duke menduar që e pranon Serbia dhe duke menduar se ai dokument kalon në Këshillin e Sigurimit dhe po e shihni që nuk ka ndodhur në asnjërën, as në tjetrën, dhe ky dokument sot, institucionet e Kosovës, përfaqësuesit e Kosovës janë të gatshëm dhe po punojnë ta bindin, prapë po e them, Serbinë, që ta pranojë një dokument në implementim, së paku të mos përzihet dhe t'i bindin faktorët e tjerë që kanë qenë në atë kohë në proces, në veçanti në Këshillin e Sigurimit, që ai dokument duhet të legalizohet, që e ka përmendur edhe kryeministri në Këshillin e Sigurimit lidhur me një rezolutë të re që duhet ta ndryshojë bazën juridike të Kosovës, në kuptimin në raport me Këshillin e Sigurimit.

U përmend dokumenti dhe unë besoj se dokumenti është parë nga mediet. Pse nuk ka ardhur në Kuvend, e para? Ai është dokument punues, ai është dokument i BE-së, ai është dokument i BE-së, është dokument që në fazën e nënshkrimit pastaj sillet në Kuvend, por nënshkruesi në këtë rast, kryeministri i Kosovës, besoj edhe i Serbisë dhe të tjerët, e kanë parasysh që ky dokument duhet të jetë i nënshkruar, duhet të jetë pastaj i dërguar në kuvendet respektive për ratifikim.

Kërkesa e kryeministrit ka qenë shumë e qartë, duhet të kemi dokumente të nënshkruara, duhet ta kemi anekse të dokumenteve, duhet të shkojmë prapa t'i ratifikojmë në kuvendet respektive dhe të shndërrohen në ligje të brendshme për Kuvendin, dhe ky ka qenë qëllimi. Duhet ta pranojmë një fakt, zoti Shala është i pranishëm. Delegacioni i Kosovës i ka dhënë vërejtjet pikë për pikë dhe vërejtjet kanë qenë në tri drejtime: E para, kudo që është dyshuar që ka kaluar prej Kushtetutës sonë, t'i vënë brenda Kushtetutës edhe ato propozime. E dyta, të jenë jo me dykuptimësi për zgjidhje precize dhe, e treta, kemi qenë të kujdesshëm si implementohet ai dokument. Dhe, këto tri sqarime besojmë se dokumentet tona kanë qenë të mjaftueshme. Është diskutuar edhe për propozimet tona dhe duhet të them që edhe pala e kundërt dhe në këtë rast fatmirësisht BE-ja nuk është palë e kundërt, palë e kundërt po mendoj për Serbinë, nuk ka mundur t'i ballafaqojë shumë argumentet të kuptimit praktik. Po e përsëris se ka qenë një kompromis i bërë vite me radhë, apo me herët.

Dhe, më lejoni ta pranojmë po ashtu faktin, po e përmend dikush dialogun. Unë nuk jam ihtar i përcaktimit të ditëve, dita kjo ose ajo. Kosova e ka mbaruar çdo ditë të rrezikshme. Kosova i pret ditët e mira. Dialogu duhet të arrihet dhe duhet të përfundojë dhe ne duhet të kemi qëllim ta arrijmë sa më shpejt që është e mundur, por dialogu duhet të arrihet brenda atyre minimeve dhe optimeve që i kemi ne. Nuk është e marta, ose e mërkura, ose 2 prilli, nuk është datë kur ne duhet ta prishim Kushtetutën e Kosovës, por është data apo dita kur ne, nëse mund, ta arrijmë një marrëveshje për implementim të asaj që është në Kushtetutën, në ligjet tona. Ne duhet ta pranojmë në fakt se marrëveshja do të na ndihmonte në zbatimin e rendit dhe ligjit, jo vetëm ne, por edhe faktorët ndërkombëtarë. Ne e kemi pasur një takim, të udhëhequr nga kryeministri me sekretarin e NATO-s, dhe besoj jeni njoftuar edhe nga mediet, po në takimin e brendshëm, përfaqësuesit e NATO-s kanë gatishmëri ta ndihmojnë Kosovën në implementim të marrëveshjes eventuale, por duhet ta pranojmë edhe një fakt, kanë më pak gatishmëri ta thyjnë status quo-n që është sot pa marrëveshje dhe kjo është një dilemë për ne të gjithë. Nëse dështon dhe ne do të punojmë që të mos dështojë dhe nuk është mirë t'i paraprijmë

kësaj. Ne po ashtu duhet ta dimë se prapë duhet të punojmë me faktorin ndërkombëtar për çdo veprim tonin që duhet ta bëjmë, edhe në veri, edhe në raport me Serbinë, edhe në raport me BE-në, dhe diku tjetër.

Natyrisht që ne do ta ndihmonim implementimin e rendit dhe ligjit, do ta ndihmonim vetveten, institucionet tona, faktorin ndërkombëtar, por do ta ndihmonim edhe procesin tonë në integritet për në Unionin Evropian, por gjithsesi po e them e gjitha kjo duhet të jetë brenda asaj që ne e kemi bërë kompromis vite më parë, i kemi implementuar të gjitha pjesët ku kemi qenë me sovranitet të plotë dhe tani duhet të punojmë që ta shtrijmë sovranitetin tonë deri në pikën e fundit.

Dhe, po ashtu, po lidhem me zotin Aliu, po ia përmendi emrin për t'i dhënë mundësi për të dialoguar, kisha dashur që në këtë vend, në këtë Kuvend të përmendet procesi i dialogut dhe të na bëhet një presion pozitiv. Dialogimi që të thuhet t'i e ki dorëzuar, ti nuk i ke bërë, ti e ke bërë kështu', nuk i ndihmon as Kosovës, Liburn. Nuk i ndihmon as këtij Kuvendi, as delegacionit. Dhe, po e them, krejt në fund, unë mendoj që ky vend, po e parafrazoj pak Napolonin, që thotë: "Krejt punën në jetën time e kam bërë për të qenë unik brenda France dhe një atdheu". Krejt puna duhet të bëhet për të qenë unikë brenda Kosovës dhe për atdheun tonë përballë Serbisë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Petroviq e ka fjalën!

SLOBODAN PETROVIĆ: Zahvaljujem se poštovani predsedavajući,
Uvaženi premijeru,
Članovi kabineta Vlade,
Uvaženi narodni poslanici,

Imajući u vidu činjenicu da je proces dijaloga je jedan od veoma važnih procesa, imajući u vidu činjenicu da je Samostalna liberalna stranka kao najjača stranka unutar Srpske zajednice na Kosovu, pre svega koja je dobila najveću podršku na poslednjim izborima, njasnažnije je radila za otpočinjeni dijalog između Beograda i Prištine, pošto mislimo da je to jedan od najboljih puteva za rešenja nagomilanih problema koji su godinama stvarali unazad, i naravno nakon otpočinjenog dijaloga još snažnije ga podržavam.

Nismo želeli da ni na koji način osporavamo proces dijaloga, ili bilo na koji način utičemo na neodržavanje tog procesa. Naša pozicija je bila potpuno jasna, želeli smo da taj proces uspe, pre svega zbog naših građana, ne zbog procesa, i bili smo u prilici da podržimo taj proces bez uslovljavanja. Nakon određenog vremenskog perioda, Samostalna liberalna stranka, odnosno predstavnici Srpske zajednice su pozvani da aktivno uzmu učešće u ovom procesu. Naravno da smo i u ovoj prilici, kao i u mnogim drugim u prethodnim godinama, kada su bila najizazovnija za, ne samo za Srpsku zajednicu, nego za sve građane Kosova, preuzimali deo odgovornosti, nismo želeli da se skrijemo iza nekih pojedinaca ili institucija. Mi znamo da to nije ni malo popularno, ali isto tako znamo da je to jako odgovorno za sve naše građane.

Dozvolite mi da i ovu priliku iskoristim da izrazim veliki respekt prema onim koji učestvuju u ovom procesu, pre svega mislim na premijera Kosova i premijera Srbija, koji

su na sebe preuzeli ogromnu odgovornost, svesni činjenice da ovo nije proces koji donosi jeftine političke poene, nego je ovaj je proces koji rešava probleme. Dakle, imajući u obzir činjenicu da sam evo u dve poslednje runde bio aktivni učesnik, odnosno čovek koji je bio učesnik na tim sastancima. Ono što mogu da kažem potpuno jasno sam već i nekoliko puta rekao, s obzirom na proces koji se vodi i kompleksnost tog procesa, mogu biti zadovoljan napretkom u okviru tih razgovora, pogotovo atmosferi u kojoj se vodi taj dialog i nemojmo da smetnemo s uma da je ovo proces odnosno razgovori na ovom nivou po prvi put u istoriji se dešavaju i da je to jedna svojevrsna zajednička pobeda i da je ovo proces, koji će uporedo rešavati probleme naših građana i uporedo uvrzati našu evro-atlantsku integraciju ka Evropskoj Uniji.

Ono što je jako važno da u ovom procesu se pre svega govori i radi o ljudskim životima i problemima, ne o nekim demagoškim pričama, koje su svima nama dobro poznate i koje su svima puno nanele probleme. Znam da je uloga moja u ovom procesu zajedno sa mojim stranačkim kolegama je jako zahtevna i jako odgovorna. Želim da iskoristim priliku da se zahvalim svim učesnicima u prištinskom timu, koji su na jedan korektan način prihvatili našu ulogu u tome. Naravno da naša uloga i u ovom procesu biće potpuno jasna i transparentna kao i u svih ovih godina iza nas i u svim novim procesima.

Mi želimo da prevashodno da našim građanima bude bolje, da rešimo nagomilane probleme, koji su godinama a možda i decenijama unazad stvarane i naša je vizija u tom smislu potpuno jasna. Ono što je isto jako važno da u onim zahtevima koje imamo, da imamo potrebnu podršku naših partnera između narodne zajednice. To su opšti zahtevi, koji pre svega idu u pravcu budućnosti, ne u pravcu nekih prošlih vremena.

Želim da verujem da će u narednom odnosno u narednoj rundi razgovora, koja je zakazana za drugi april, doći do konkretnih dogovora i konačno koji će se pretočiti u pisanoj formi. Znači želim da i u ovoj prilici poručim i prenesem jednu jasnu poruku da ćemo i tada u toj rundi razgovora imati potpuno iste stavove, koje smo imali i do sada. Znači nama je to pre svega interes i cilj. Verujem da ćemo imati razumevanja za to i verujem da će to biti dobra prilika da se konačno stavi tačka na probleme koje smo imali godinama unazad.

Znam da ovo nije lako i znam da ima puno onih koji kritikuju i puno je lakše sedeti po strani i kritikovati nego nešto uraditi. Ja znam da ovo što i ja radim da to nije nimalo popularno, ali za popularnost neka se angažuju glumci, teniseri, fudbaleri i sportisti. Ovo je jedan ozbiljan posao i mi smo ga ozbiljno prihvatili u interesu svih građana koji žive u ovom prostoru i to je naša ne samo zakonska nego i ljudska obaveza i ja vas molim sve zajedno, kako opoziciju tako i poziciju da to shvatite na najbolji mogući način.

Ne tražimo da nam dajete niti kakve nagrade, niti priznanja, ali tražimo da uvažite ono što smo preuzeli na sebi kao odgovornost, kao odgovorni ljudi za naše građane i ne samo za ovu generaciju, nego i za puno generacija koje će doći posle nas.

Još jednom se zahvaljujem i hvala na prilici.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Halit Krasniqi e ka fjalën.

HALIT KRASNIQI: Faleminderit, kryesues!

I nderuar kryeministër!

Kabinet i nderuar qeveritar,

Të nderuara deputete,

Të nderuar deputetë,

Raportimet e kryeministrit për bisedime kanë ngjallur një interesim të madh në opinionin e gjerë dhe veçanërisht edhe një angazhim të deputetëve në diskutime, por ajo çka është impresionuese, vërej një emancipim në fjalët e deputetëve dhe pavarësisht prej ngarkesave të energjisë negative, megjithatë është bërë një shkarkim i asaj energjie negative dhe shoh një përmbajtje më cilësore dhe një angazhim më të përgjegjshëm në diskutimet e tyre.

Në trajtimin e parë kur i kemi bërë bisedimet për të nxjerrë Rezolutën për këto bisedime, pata diskutuar me një theks të veçantë deri atëherë dhe pata kërkuar që në çdo ballafaqim me Serbinë, do të duhej të ishim së bashku pozitiv dhe opozitiv, jo për dashuri ndaj temës, pata thënë atëherë, por për ndjeshmërinë ndaj saj.

Është shumë e rëndësishme për këtë vend ndërprerja e financimit të strukturave të paligjshme nga ana e Beogradit, që ende funksionojnë këto struktura në veri dhe vendosja e respektimit të ligjit dhe respektimit të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Është shumë me rëndësi për këtë vend dhe për qytetarët tanë të diskutohet me Serbinë për të rrëmbyerit nga strukturat policore dhe ushtarake, që ne i quajmë “të pagjetur”. Ankthet e familjeve dhe të gjithë atyre që janë të lidhura me këta persona që janë të shumtë, me këta njerëz që kanë qenë qytetarë të Kosovës dhe për vite të tëra nuk e dimë se ku ndodhen, ka rëndësi të veçantë dhe ka edhe rëndësi politike, sepse në këto bisedime menjëherë ndërrohen pozitat. Gjithçka pasqyrohet dhe thuhet me emër të veçantë dhe konkret se kush çka janë në bisedime.

Takimet e njëpasnjëshme që kanë ndodhur mund të kundrohen nga shumë anë dhe mund të trajtohen nga shumë sfera. Këto takime kanë pasur simbolika të shumta dhe njëra nga këto më karakteristike për mua ka qenë tabloja, imazhi që është dhënë në kamera dhe që është pasqyruar në fotografitë e shtypit vendor dhe ndërkombëtar dhe konkretisht tavolina e punës, në të cilën janë zhvilluar bisedimet. Aty unë kam gjetur mesazhe të qarta për gjithë opinionin e gjerë dhe veçanërisht mesazh inkurajues për qytetarët e vendit tonë.

Ajo tablo, ajo pasqyrë dhe ajo krejt çka është ofruar nga këto fotografi dhe nga këto pamje filmike, tregon se delegacioni ynë ka mesazh të qartë, ka qëndrime të formuluara dhe ka kërkesa krejt konkrete, të cilat dihen botërisht dhe absolutisht nuk ka nevojë të jenë të shkruara dhe nuk ka nevojë të jenë të pasqyruara.

Madje-madje, mua për vete personalisht dhe të gjithë bashkëpunëtorët e mi dhe të gjithë ata që unë kontaktoj edhe po të kishim pako të mëdha, kutia të mëdha me fakte dhe letra të mbushura me shkrime në tavolina nuk do të ngjallnin besim dhe siguri dhe nuk do të

inkurajoheshin më shumë qytetarët nga këto bisedime, se sa ajo pamje e tavolinës dhe ai qëndrim i delegacionit tonë.

Unë inkurajoj kryeministrin dhe pres nga ai që ta rrumbullakojë këtë proces me përvojën dhe eksperiencën që ka pasur vazhdimisht në përfaqësimin e interesave të këtij vendi dhe të këtij populli. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Ferati e ka fjalën.

SADRI FERATI: Faleminderit, i nderuari kryesues!

I nderuari kryeministër,

Kabinet Qeveritar,

Të nderuar kolegë,

Para, kjo është e sata herë që ne po diskutojmë dhe gjithë me shpresa se po i afrohemi një dite kur do të ketë një marrëveshje, pra ndoshta më datën 2 apo edhe të mos jetë e vonshme, ku Kosova pret se do të gjejë interesin e vet në kuadër të kësaj marrëveshjeje.

Unë do të provoj të them diçka, po do të thotë, nuk e besoj kolegu i nderuar zoti Halit, që kam mbërri të emancipohem për dy javë kaq shumë, por do të tregoj se jam i përkushtuar në këtë çështje. Pra, nuk është çështje e një emancipimi dyjavor, por një përkushtimi në këtë temë, që është interes për shtetin dhe për shoqërinë kosovare, po besoj.

Prandaj, them që në çështjet që tani janë fokus i veçantë, asociacioni i komunave dhe shpërbërja e strukturave paralele, që po diskutohet paksa më shumë, thjesht nuk është çështja e një forme, po flitet për një çështje shumë esenciale, sepse është dallim shumë i madh një asociacion komune, ku bashkëpunimi është i vullnetshëm, ku vendimet merren në instanca kompetente, siç janë asambljetë komunale, borde dhe të tjera, dhe ku saktësisht dihet se asociacioni i komunave nuk mund të zëvendësojë as kompetencat komunale as ato të nivelit qeveritar. Por, ka mundësi që ai asociacion të japë kontributin e vet sikur edhe gjithkund tjetër, në kuptimin e ndarjes së përvojave, ngritjes së kapaciteteve po edhe planifikimeve të përbashkëta.

Dhe, nëse dikush më herët ka menduar se kjo është thjeshtë një çështje e vogël dhe le të bëhet një kompromis, jo këtu s' diskutohet për një kompromis, këtu diskutohet që o do të jetë kjo o do të jetë krejt diçka tjetër dhe mos të diskutohet.

Prandaj, unë mendoj se kryeministri, delegacioni jonë kanë pasur shumë argumente dhe po besoj se kështu do të shkojë edhe më tutje, çfarë u tha. Dhe e përshëndes dhe do të japim mbështetje, ngase pikërisht në këtë pikë, po edhe në disa pika tjera që do të diskutoj, nuk është krejt poenta fillestare, se çfarë marrëveshjesh do të bëjmë, por çështja është si do të implementohet dhe cilat do të jenë efektet që ne po i kërkojmë nesër pastaj dhe i gjithë ky proces kah do ta ketë trendin, e integritet që ne po e dëshirojmë; apo të një dezintegrimi, që ne e dimë se kush do të dëshirojë më tutje. Prandaj, nuk është e thjeshtë, por duhet të mbetemi në këtë pozicion dhe shpresojmë se marrëveshja pikërisht, do të jetë e saktë, e shkruar, pa mundësi që të ketë interpretime të dyfishta dhe me garanci të të gjitha palëve, se ajo do të implementohet në afatet çfarë parashikohen.

Një çështje që nuk u diskutua dhe unë nuk kam informacione të mjaftueshme, se nëse flitet se me datën 2 do të ketë një marrëveshje, ne kemi paralajmërime edhe disa tema dhe nuk e dimë se a do të jenë objekt i kësaj marrëveshjeje. Siç u tha edhe çështja e transportit, çështja e telekomunikimit, pasurive tjera nacionale siç janë pasuritë e “Trepçës”, e Ujmanit e të tjera, ne dëgjuam se kryeministri i Serbisë edhe në Këshillin e Sigurimit, pasurinë e “Trepçës” e quajti pasuri e Serbisë, jo e shtetit të Kosovës dhe qytetarëve të saj, që nuk është e vërtetë pra, sepse është pasuri e Kosovës. Ne e dimë se në krah ose mbi kurrizin e “Trepçës” ka pasur shpëlarje të parasë dhe pasurim të madh të ish- do të thotë udhëheqësve të Serbisë dhe i kanë bërë një dëm, që nuk e di sa do të jetë i riparueshëm. Mirëpo, shumë shpejt “Trepça” duhet të jetë pjesë e diskutimeve në këtë Parlament, që të nxirren ligje dhe të definohet çështja e “Trepçës” dhe të mos mbetet akoma dilema, se e kujt është “Trepça” dhe si do të duhet të na shkojë.

E mora “Trepçën” vetëm si shembull për të treguar, se ne nuk e dimë se në kuadër të kësaj marrëveshjeje a do të ketë marrëveshje edhe për këto tema, apo këto tema konsiderohen ndoshta pak më të lehta dhe do të ketë në vazhdim. Unë mendoj, se kryeministri do të mundet shumë lehtë të tregojë, se këto do të jenë apo s’do të jenë pjesë e kësaj marrëveshjeje, që parashihet, pra këtij dokumenti që është paralajmëruar, apo do të jetë pjesë e diskutimeve të mëvonshme? Dhe, unë mendoj se edhe këtyre temave duhet t’iu qasemi po kaq seriozisht sikur edhe deri më tash.

Ndërsa sa i përket asociacionit të komunave, edhe njëherë unë pajtohem me një deklaram, tash po e shoh se kolegja Trajković nuk është këtu, por unë pajtohem me një thënie që ajo e ka dhënë në një deklaratë, që nuk duhet të lejohen pretendimet për Ahtisari plus në veri, sepse ajo në mënyrë automatike nënkupton se do të ketë Ahtisari minus për serbët në këtë pjesë. Prandaj, të mos prishim diçka që e kemi mbërri.

Ne po e shohim se rezultatet e Ahtisarit aty ku ka pasur vullnet kanë dhënë rezultate. Unë di, kam pasur rastin që të bisedoj me disa anëtarë të delegacionit, në mesin e tyre është edhe zoti Haziri, kur e thotë se domethënë sa vështirë po na bie të bashkëpunojmë dhe të dizajnojmë me zotin Ahtisari projektin, sepse veriu është problem. Dhe, unë e di se në çfarë lëkure ka qenë, e di se çfarë kritikash ka pasur në Gjilan, por unë dua t’i jap edhe një herë një mirënjohje dhe një mbështetje dhe një falënderim të qytetarëve të veriut, për përpjekjet që ka bërë zoti Haziri dhe i gjithë delegacioni i Kosovës, që ka pasur atëherë.

Ndërsa, derisa tash po bisedojmë për veriun kjo dëshmon se ne kemi krijuar kredibilitet në pjesën tjetër të Kosovës dhe sot po i zhvillojmë betejat e fundit në veri dhe duhet të jenë pra këto rezultate. Ndërsa sa i përket fjalisë “Frikësohen qytetarët nga integrimi...”, jo nuk ka frikësim nga integrimi. Ai është shumë i dukshëm për ata që kanë vullnet, për ata që dëshirojnë, por duhet edhe njëherë të theksojmë, se atje është një strukturë, që kurrë më mirë s’ka për të jetuar dhe dihet pse. Sepse, s’do të lejojë kurrë Kosova të ketë asi krimi, s’do të lejojë kurrë Kosova marrjen e pushtetit dhe të shtetit dhe fuqisë në dorën e disa personave dhe normal, ata persona do të protestojnë, ata persona do të provojnë edhe t’i problematizojnë këto çështje. Nuk është rastësisht pse shpërthejnë bomba përditë dhe janë shumë mirë të dirigjuara. Shihet se këto bomba që kanë shpërthyer kohëve të fundit në Mitrovicë, nuk është anarki, ajo është thjesht një projekt.

Prandaj, edhe një herë unë jap mbështetjen, çfarë edhe i ka dhënë Parlamenti me Rezolutën e saj bisedave. Dimë saktësisht se çka përfiton Kosova dhe çka presim prej asaj dhe duhet të qëndrojmë në këtë, ndërsa një marrëveshje e mirë e natyrës çfarë e tha edhe kryeministri, garanton se ajo pjesë do të futet në rrugën e integritit, normalizimit të jetës dhe pastaj bashkërisht thërras edhe qytetarët e komunitetit serb, të mos presin se dikush edhe në veri do t'u çojë diçka. Le të bëhen pjesë aktive e forcimit të institucioneve, ndërtimit të shtetit, krijimin e zhvillimit dhe ata do të marrin produkte.

Askush nuk do të merr përsipër të ndajë nga kafshata e vete nga këtu dhe atyre t'ua çojë si të gatshme. Ata duhet të futen në proces, të bëhen pjesë e institucioneve, të integrohen dhe t'i kontribuojnë zhvillimit dhe mirëqenies së mëtejme. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! replikë zoti Krasniqi.

HALIT KRASNIQI: Faleminderit, nënkryetar!

Nuk dua të bëj replikë, po dua të bëj një precedent, dua të lë një shembull dhe dua të krijoj një praktikë në këtë Parlament. Unë nuk replikoj asnjëherë me të nderuarin deputet Sadri Feratin, sepse vazhdimisht ka rrezatuar energji pozitive në këtë foltore dhe veçanërisht, në kapitullin e bisedimeve.

Kësaj radhe desha të jap këtë shembull, që ai ka të drejtë të përmend emrin tim edhe në konteste negative, në këtë rast nuk e kishte këtë qëllim dhe as s'e bëri, por edhe kur ta bëjë në kontest negativ, nuk i bëj replikë dhe nuk i replikoj as atij dhe as të tjerëve, që rrezatojnë energji pozitive. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Ferati, kundër- replikë.

SADRI FERATI: Faleminderit, kryesues!

Nuk do ta zgjas. Realisht, unë kur e përmenda emrin e zotit Krasniqi, e përmenda për ambient, për atmosferë, kam mirëkuptim dhe kam respekt dhe nuk më ka ofenduar ajo çështje dhe nuk e kam përmendur në kontekst negativ. Vetëm se desha të bëj një hyrje që ta ketë pak më shumë koncentrimin e deputetëve, do të thotë që të dëgjohemi pak më mirë. Me shumë respekt, zoti Krasniqi.

KRYESUESI: Zoti Hydajet Hyseni e ka fjalën.

HYDAJET HYSENI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Të nderuar përfaqësues të Qeverisë,

Zonja dhe zotërinj deputetë,

Ju përshëndes të gjithëve. Do të doja të përshëndes edhe kolegët që rriten koncentrimin. Do dëshiroja të përshëndes edhe raportimin që u bë. Më vjen mirë që po vlerësohet ashtu siç duhet "raportim", ndonëse përsëri pa letra.

Për pasojë, ne po detyrohemi vërtet që t'u referohemi shpesh burimeve, të cilat nuk i kemi dhe aq për qejfi. Dhe, ndonjëherë po na përmendet pse po flasim me referenca te

mediet, po nuk i kemi tjerat. E është rendi, që megjithatë të funksionojmë siç funksionon bota, me letra.

Megjithatë, s'mund të mos them se po e shfrytëzoj rastin sa është ende kryeministri në sallë që t'i them se më ka bërë përshtypje të mirë tabloja që ka krijuar. Dëshiroj t'i besoj dhe uroj të jetë ashtu, po s'mund ta fsheh që vend për dyshime ka. Edhe më e mirë ishte tabloja e plotësuar pastaj nga zëvendëskryeministri dhe mendoj që kjo dëshmon se duhet ta përplotësojnë njëri- tjetrin. Dukej edhe më me arsye për ta mbështetur qëndrimin në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, që ishte përveç tjerash edhe një përpjekje për ta përplotësuar po edhe për ta korrigjuar pozicionin në disa aspekte. Mendoj, që edhe kjo qasje i duhet pozicionit të Kosovës në një proces tepër të rëndësishëm.

Unë jam i prirur që edhe qëndrimin e opozitës me tonet ose konstatimet me të cilat mund të mos pajtohesh, po do të duhej kuptuar kështu, si përpjekje që në mënyrë përplotësuese të konsolidojmë pozicionin tonë në një çështje që mendoj se është çështje e përbashkët e të gjithëve, pavarësisht qasjeve që mund të jenë të ndryshme.

Uroj që një tablo pozitive të dëshmohet si e tillë. Po, thonë që luftën e fiton vetëm ai që e vazhdon deri në fund, ai që nuk i nënçmon edhe sfidat e rreziqet. Dhe kësaj radhe, meqë po flasim për një çështje më specifike, dëshiroj të tërheq vërejtjen vetëm te fakti që në këtë proces na ka ndodhur në fakt një rrëshqitje prej çështjeve teknike në çështje puro politike dhe ka qenë e pritur. Po tani, me këtë çështjen e idesë së ristrukturimit të komunave në Kosovë, kemi tërhequr edhe lojën në pjesën tonë të fushës.

Po themi që është loja mirë dhe ne po shënojmë gola. Ndodh që edhe nga porta jote të shënosh gol në portën e kundërshtarit, po kjo rrallë ndodh në sport, në futboll sidomos. Uroj megjithatë që të ndodhë, po unë i kam lexuar me vëmendje edhe tetë pikat e famshme, që janë prezantuar në opinion dhe dëshiroj të tërheq vërejtjen te rreziku që kjo çështje të mos nënçmohet, përveç tjerash edhe sepse pikërisht në këtë mënyrë ka filluar Republika Sërpska, me bashkësi të komunave. Është nënçmuar, nuk është ndërtuar pozicion reciprok dhe për pasojë kemi atë gjendje që kemi.

Ku është Sanxhaku dhe ku është funksionaliteti i Bosnjës? Përfaqësuesit e Bosnjës dhe miqtë e saj, kur janë të huaj, thonë që është modeli më i keq i mundshëm.

Ne po vazhdojmë, zonja e zotërinj, t'i quajmë struktura paralele ato që janë edhe në njëfarë mënyre ajo që po na josh në këtë proces. Dhe, të gjithë e dimë që është një emërtim i gabuar. Nuk janë struktura paralele. Janë ish strukturat e ish regjimit dhe duhen trajtuar si të tilla. Me këtë nuk po ndodh ajo siç po prezantohet, një zhbërje e tyre, por po ndodh praktikisht një legalizim, një ristrukturim i tyre. Unë nuk e përjashtoj nevojën që edhe me përfaqësues të tillë të skenës politike të gjendet ndonjë modus, por le t'u themi emrin që kanë.

Dhe, po thuhet kjo se është pjesë e një kompromisi, kurse këtu u tha me të drejtë që kompromisi ka qenë bërë vite më parë. Të kërkoj kompromis midis një zgjidhjeje

kompromisi dhe një zgjidhje ekstreme, kjo do të thotë ta komprometosh kompromisin. Aq më tepër kur janë përmendur edhe dy kushtetutat.

Zonja e zotërinj, Kushtetuta e Kosovës është më shumë se kompromis, kurse kushtetuta që është referencë e Beogradit është më shumë se absurd, sepse pretendon ende dominimin dhe restaurimin e dominimit mbi një shtet tjetër edhe në kundërshtim me vetë kushtetutën e saj para disa kohe. Të kërkojsh të gjithë kompromis midis këtyre dy pozicioneve është e sigurt që është kompromis komprometues.

Megjithatë, mendoj se çështjen do parë më ndryshe. Kompromisi është bërë, por kjo nuk do të thotë se s'ka mundësi modifikimi ose modaliteteve përzgjedhjet. Dhe, nuk them se duhet injoruar problemet e komunitetit serb, ato duhen adresuar siç duhet. Po, koncepti i tetë pikave që do të dëshiroja të fokusohem tani, është për mua në shumë pika i diskutueshëm.

Së pari, një koncept që organizon në vija etnike komunat, që do të thotë duhet të shkëputet Ranillugu prej Gjilanit dhe ta zëmë, Shtërpca prej Ferizajt dhe të gjejë një lidhje bashkëpunimi me veriun, është në kundërshtim me konceptin mbi të cilin është ndërtuar Kushtetuta jonë dhe sistemi politik e kushtetues në Kosovës. Dhe, kjo duhet thënë.

Është një kundërshtim edhe me konceptin e multietnicitetit që ne e proklamojmë me aq mburrje dhe na e kanë imponuar, po ashtu me shumë justifikime e veshje demokratike. Çka po ndodh tash, pse getoizimi, pse enklavizimi, kujt i shërben kjo?

Thuhet se kjo strukturë tani përsëri në një variant bashkësi, në një variant asociacion, do të ketë statut të vetin, që do të thotë nuk do të jetë pjesë e asociacionit të komunave të Kosovës, që do të thotë duhet të prishet asociacioni i komunave që kemi tani, të bëhet një etnik. Nëse ne e bëjmë një etnik, ose minus një etnik, ne kemi problem me Kushtetutën tonë, me frymën në cilën e kemi ndërtuar atë Kushtetutë. Po, do të ketë statut me të njëjtat modalitete, siç thuhet “si statuti tjetër”. A është e mundshme? Sepse një, ai është statut i një asociacioni multietnik, ky pretendon të jetë bashkësi një etnike, dhe tjetra, ai asociacion nuk ka kompetencat që po i atribuohen këtij asociacioni të ri, asaj bashkësisë së re. S'mund të jetë, do të thotë, ajo që sugjerohet “modalitete të njëjta”. Pse nuk po i themi ashtu, siç janë?

Pastaj, nëse ka kompetenca si ato që atribuohen: zhvillimin ekonomik, arsimin, shëndetësinë dhe thuhet: “kompetencat tjera me interes të përgjithshëm”. Cilat janë kompetencat tjera me interes të përgjithshëm? Në fushën e financave u tha, që është krijuar një shteg. Çka mbetet atëherë? Dhe, si do të duket kjo në praktikë? A mund të fajësohemi ne, se po e etnicizojmë, po e enklavizojmë Kosovën nesër në këtë mënyrë?

Pastaj, bashkësia ose asociacioni do të ketë mbikëqyrje strategjike në këto fusha. Çka do të thotë kjo?

Përveç tjerash, kjo strukturë, quaje si duash, do të ketë një linjë të posaçme përfaqësimi në strukturat e pushtetit qendror. Çka do të thotë kjo për sistemin tonë të tashëm të funksionimit institucional? Komunitet me shumicë serbe përfaqësohen në linjë institucionale, nëpërmjet ministrive. Çka do të thotë kjo tash një përfaqësim tjetër fare? Është siguruar kjo edhe në të ashtuquajturin e të famshmin “legjislacion për liritë e bashkësitë fetare”, tani sigurohet edhe në pushtetin lokal. Çka po ndodh me sistemin tonë politik dhe kujt po i duhet kjo, si funksionon në praktikë?

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Edhe një minutë.

HYDAJET HYSENI: Nuk duhen injoruar grackat e tilla, sepse praktika do të na dëshmojë se ato nuk bëhen rastësisht dhe për ta përfunduar, nëse janë aq të mira dhe nëse me to ka fituar Kosova, hajt t’ia ofrojmë pra Serbisë që le ta bëjë të njëjtin model për komunitet shqiptare në Preshevë, Bujanoc e Medvegjë e për Sanxhak e të tjera dhe, le të fitojë edhe Serbia poenë politike dhe vlera demokratike, e të tjera. Le t’i lusim edhe miqtë tanë që ta ndihmojnë edhe Serbinë që të demokratizohet si ne në këtë mënyrë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Arben Gashi e ka fjalën.

ARBEN GASHI: Faleminderit, kryesues!

Këtu u përmendën shumë fjalë dhe koncepte, të cilat unë u mundova t’i përmbledh dhe t’i shkoqis pak se çka kuptojmë me këto.

U tha se duhet të ketë ratifikim të marrëveshjes në Kuvend. U tha nga kryeministri se do të ketë eliminim të strukturave paralele dhe eliminim të rrezikut të nivelit të tretë të pushtetit, u tha se do të ketë partneritet ndërkombëtar. U tha nga kryeministri, se do të ketë anëtarësim në Bashkimin Evropian, u tha nga zëvendëskryeministri Kuçi se ne kemi dështuar në vitet e fundit që të eliminojmë prezencën e Serbisë në pjesën veriore të Kosovës, që është hera e parë që një bartës qeveritar pranon prezencën e institucioneve të Serbisë në pjesën veriore të Kosovës. U tha nga zoti Kuçi që 90% e draft-marrëveshjes është në linjë me Kushtetutën e Kosovës, nuk u tha, që 10% është në kundërshtim me Kushtetutën. U tha nga zëvendëskryeministri Kuçi po ashtu, që ne kemi menduar kur kemi bërë marrëveshjen e Vjenës që ne do të kemi ulëse në OKB, nuk u tha se pse nuk e kemi. U tha se janë vendosur disa standarde dhe kërkesa për Bashkimin Evropian, kushtetutshmëria, heqja e dykuptimisë dhe zbatimi i marrëveshjeve.

Unë po mundohem që t’i jap një shkoqitje këtyre koncepteve dhe të shohim se çka po na del në fund.

Te ratifikimi, u tha këtu se do të ketë ratifikim të marrëveshjes dhe u kërkua realisht nga të gjitha partitë që të ketë ratifikim të marrëveshjes në Kuvend. Por, para se të ndodhë ratifikimi, ne dje kemi parë, të paktën është raportuar, nuk e di se çka mund të thotë kryeministri, aprovimin e një rregulloreje për bashkëpunimin mbi komunal, rregullore që

ne nuk e dimë se a është në harmoni me Ligjin për vetëqeverisjen lokale dhe Ligjin për bashkëpunimin ndërkomunal dhe pse duhet të ketë një rregullore, që e aprovon Qeveria në këtë rast dhe në këtë moment, sidomos.

U tha nga kryeministri, “eliminimi i rrezikut për pushtetin e tretë” dhe “eliminimi i strukturave paralele”. Unë pyes kryeministrin, a është eliminuar rreziku i organizimit mbi komunal në aspektin e gjyqësorit, të policisë, të prokurorisë, sistemit tatimor, kapaciteteve legjislative dhe kapaciteteve ekzekutive?

Ne nuk kemi një draft-marrëveshje dhe nuk mund të komentojmë, po zoti Bajrami pretendoi që këto janë eliminuar dhe unë shpresoj që këto janë eliminuar. Dhe, do të jem shumë i kënaqur, nëse këto janë eliminuar.

U tha nga kryeministri që do të ketë partneritet ndërkombëtar në zbatimin e marrëveshjes dhe u përmend tërthorazi KFOR-i nga kryeministri dhe nga zëvendëskryeministri dhe KFOR-i u përmend si mundësi dhe si rezultat edhe i bashkëbisedimit që kryeministri paska pasur në Bruksel me udhëheqësin e NATO-s. Nuk u tha këtu se kush do të jenë partnerët tjerë, cili është roli i Serbisë në zbatimin e marrëveshjes, cili është roli i EULEX-it në zbatimin e marrëveshjes së mundshme, cili është roli i Kosovës në zbatimin e marrëveshjes së mundshme?

U tha nga kryeministri me zë të ultë që Kosova do të ketë ulëse në Kombet e Bashkuara si e barabartë. Unë po e përsëris me zë pak më të lartë, a është pjesë e marrëveshjes së shkruar ulësja e Kosovës në Kombet e Bashkuara?

Që të mos lejojmë rrezikun e asaj çka tha zëvendëskryeministri, që ne menduam se do të ulëshim në Kombet e Bashkuara. A ka një marrëveshje të shkruar, a ka kufizim, në rast se nuk ka marrëveshje të shkruar, a ka kufizim të zbatimit të marrëveshjes, nëse nuk garantohej ulësja në Kombet e Bashkuara apo nëse nuk ndodh, çka do të ndodhë me marrëveshjen dhe çka do të ndodhë me Pakon e Ahtisarit, që tashmë është zbatuar? A ka garanci për ulësen e Kosovës në Kombet e Bashkuara?

Zëvendëskryeministri tha se nuk duhet të jemi të surprizuar edhe nëse ndodh diçka tjetër, nëse ndodh dështimi i marrëveshjes. Mendoj se nuk duhet të jemi të surprizuar, sepse mbetet status quo-ja që nuk është ndonjë rrezik i jashtëzakonshëm, duke marrë parasysh rrezikun që mund të ndodhë me instalimin e pushtetit të tretë.

Dhe, pyetjet tjera që i kam unë, janë këto:

- Cili është diagrami i zbatimit të marrëveshjes?
- A do të bëhet së pari shpërndarja e strukturave paralele?
- Instalimi i organeve të reja?
- Marrja e përgjegjësi nga KFOR-i?
- Marrja e përgjegjësi nga EULEX-i?
- Marrja e përgjegjësi nga institucionet e Kosovës?
- Do të mbahen zgjedhjet?
- Do të transferohen kompetencat?

- Do të formohet fondi?
- Do të vendosen trupat e organizimit mbi komunal?
- Do të ndodhë anëtarësimi në Kombet e Bashkuara?

Apo do të jetë e kundërta, do të ndodhë anëtarësimi në Kombet e Bashkuara, do të mbahen zgjedhjet, do të transferohen kompetencat dhe pastaj do të bëhet shpërndarja e strukturave paralele dhe instalimi i organeve dhe institucioneve të Kosovës? Cila do të jetë procedura, sepse nga kjo që u tha këtu, nuk kishte asgjë të qartë se çka do të ndodhë. Mendoj se ka një kuptim pse nuk ka diçka shumë të qartë, sepse akoma nuk është finalizuar. Mirëpo, të paktën këtu nga zëvendëskryeministri, të cilin prapë po e citoj, tha se në media, ajo çka është transmetuar në media është pothuajse e saktë. Marrëveshja e cila është transmetuar në media është pothuajse e saktë. Dhe, unë e përsërita dy herë, për të dhënë kuptimin e asaj, se po kemi diskrepancë në sistemin ligjor, sistemit kushtetues, ligjit për vetëqeverisjen lokale, ligjit për bashkëpunimin ndërkomunal, rregullorja e cila u aprovua dje dhe dokumentit i cili ka dalë në publik dhe zëvendëskryeministri tha që është i saktë.

Prandaj, mendoj se duhet të jemi më të informuar, në mënyrë që të kemi mundësi më mirë të gjykojmë dhe të vlerësojmë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Kuçi e ka fjalën, për replikë. Zëvendëskryeministri Kuçi.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Ndoshta, për sqarim më shumë, se atë që e përmendi njëri ose tjetri i përfoi, zoti Gashi, ishin ato që u diskutuan këtu, të jap disa sqarime.

E para, rregullorja e djeshme nuk ka të bëjë asgjë lidhur me dialogun. Ka ardhur si renditje ashtu. Kemi mundur ta shtyjmë një javë më herët, më vonë, po s'ka të bëjë kurrëgjë me atë çështje. Dhe, vetëm ka ndodhur rastësisht, pastaj është komentuar nga mediat.

Çështja e dytë që u përmend, në Vjenë që kemi qenë të gjithë së bashku, përjashtimisht ata që s'kanë qenë në proces në atë kohë, e unë po e them prapë, nuk ka kaluar dokumenti në Këshillin e Sigurimit dhe aty ka qenë defekti. Dhe anëtarësimi në OKB nuk është diçka që vendosim vetëm ne, nuk është diçka që vendos as vetë Serbia, as për vete as për ne, por besoj që janë disa faktorë tjerë, në veçanti e drejta e vetos, që vihet nga disa shtete, në këtë rast Rusia.

Për të mos e cituar Rusinë shumë, por atje është një ambient i relaksuar kur thuhet që nëse ka marrëveshje Kosovë - Serbi, ata do të jenë pozitivë në këtë drejtim. Por, nuk është diçka që mund ta thotë dikush në këtë sallë, këtë ditë do të hyjmë në OKB. Unë besoj që është çështje pak më e gjerë se sa që mund ta debatojmë ne.

Është e vërtetë që në veri e kanë thënë edhe të tjerët e kanë përsëritur, ne konfrontohemi me strukturat e Serbisë, me shtetin e Serbisë dhe jo me qytetarët tanë. Dhe, kjo është e vërtetë, që e dimë edhe ne, e din edhe faktori ndërkombëtar dhe e dinë të gjithë të tjerët.

Po ashtu, duhet ta pranojmë, që në dokumentin i kemi dhënë vërejtjet tona. Unë po e them, këtë për hir të opinionit publik, për hir të dinamikës së procesit s'e kemi qitë në media, por ajo çka mund të them, do t'i qesim edhe ato dhe do t'i shihni vërejtjet tona, cilat do të jenë.

Tjetra çka mund te them, që status-quoja nuk është e pranueshme për ne. Edhe nëse nuk ka marrëveshje status-quoja nuk është e pranueshme për Kosovën në pjesën veriore. Ne prapë do të kërkojmë nga bashkësia ndërkombëtare me institucionet tona, ta lëvizim status quo-n. Dhe, logjika e status quo-s i konvenon vetëm Serbisë atje dhe njerëzve, që merren me krim të organizuar, por jo qytetarëve serb atje, jo institucioneve legjitime të Kosovës.

Dhe, ne kemi një plan implementues. Plani është i detajuar. Po e them shumë shkurtimisht, parasheh aktivitete konkrete për KFOR-in...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Edhe një gjysmë minute.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit! Nuk ishte si replikë, faleminderit për mirëkuptim, zoti nënkryetar!

Në planin tonë parashihet punë apo angazhim konkret për KFOR-in, EULEX-in dhe institucionet e Kosovës. E vetmja gjë që parashihet për Serbinë është ndërprerja e financimit të strukturave paralele, ndërprerja e ndihmës për strukturat paralele dhe mosndërhyrja në punët e brendshme, jo aktivitetet tjera.

Plani ynë implementues parasheh edhe dinamikë kohore dhe trupin implementues, që parashihet të lëvizin gjërat brenda 90 ditëve. Por, ky plan duhet të pranohet edhe nga bashkësia ndërkombëtare dhe të fillojë të implementohet në Kosovë.

Dhe krejt në fund, e kemi parë edhe në marrëveshje, parashihen edhe zgjedhjet lokale të mbahen atje në vitin 2013, që qëndrim yni është të mbahen njëkohësisht me zgjedhjet lokale në tërë territorin e Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Gashi kundër-replikë.

ARBEN GASHI: Faleminderit, zoti zëvendëskryeministër!

E çuditshme, por meqë u tha për juve, unë po e marr si të tillë, që është koincidençë fakti se Rregullorja ka hyrë në rend dite dhe po jam i prirë që ta besoj. Dhe, besoj që këto informacione shtesë që i dhatë, ishin të mirëseardhura, por dëshiroj të insistoj që të krijohet një minimum kritik dhe të krijohet një gjendje në kuadër të bisedimeve dhe

dialogimit me bashkësinë ndërkombëtare, që të krijohet minimumi kritik i krijimit të mundësisë për Kosovën, që të jetë në Kombet e Bashkuara.

Dhe, besoj që nëse bëhet puna e duhur në mënyrën e duhur, besoj që do të mbërrihet edhe në atë pikë dhe të kemi shans që Kosova të jetë anëtare e Kombeve të Bashkuara dhe të mos lejojmë mundësinë e interpretimit, se “ne kemi menduar që do të jemi, po ja që nuk jemi”.

Mendoj, se ne duhet të jemi më eksplicit tash dhe të marrim mësim edhe nga gabimet e së kaluarës me Marrëveshjen e Vjenës dhe ta shndërrojmë si në aset tonin, për të arritur një marrëveshje dhe për ta...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Zoti Bajrami, replikë.

ARSIM BAJRAMI: Më tepër e mora fjalën për të sqaruar edhe pse nuk e kuptova kontekstin, të cilit iu referua zoti Gashi, fjalimit tim në emër të grupit parlamentar, po dëshiroj të përsëris atë që e thashë- çfarëdo ideje e dhënies së kompetencave ekzekutive apo kompetencave tjera apo asimetrie e përmbys rendin kushtetues, e kam thënë disa herë në këtë Parlament, po e kam thënë disa herë edhe në media.

Dhe, mendoj se rezultati apo marrëveshja nuk duhet të ketë efekte kushtetuese dhe ligjore dhe nuk duhet të kërkojë ndryshime kushtetuese dhe ligjore në Kosovë, po ajo duhet të kërkojë një proces të tillë në Republikën e Serbisë, sepse Republika e Serbisë duhet të hyjë në proces të ndryshimit të Kushtetutës së saj dhe duhet të ndryshojë Kushtetutën e cila është prurë në vitin 2006 vetëm për nevojat për Kosovën.

Dhe, bashkësia ndërkombëtare duhet të ushtrojë presion, që pas arritjes së kësaj marrëveshje dhe normalizimit të fillojë procesi i heqjes së Kosovës nga Kushtetuta e Serbisë, sepse derisa në preambulë, nenin 182 përmendet Kosova, kjo është një lloj agresioni kushtetues që e bën në aspektin kushtetues Serbia, por assesi, po e përsëris, ky proces nuk duhet të kërkojë rishikime apo ndryshime, jo vetëm kushtetuese, por as legjislative në Kosovë, sepse nëse do të ndodhë kjo, atëherë do të krijohet një precedent dhe një asimetri që është krejtësisht e papranueshme për Kosovën. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Hamiti, replikë!

SABRI HAMITI: Faleminderit, zoteni kryesues i seancës!

Unë e çmoj, jo veç sot, po edhe herëve tjera zotin Kuçi si mbrojtësin më elokuent të politikave të Qeverisë edhe në Kuvend edhe jashtë dhe ia njoh këtë aftësi.

Sot e kam dëgjuar me kujdes të veçantë dhe mund t'i them që i ka thënë disa të vërteta, që s'i kam dëgjuar nga ekipi deri sot dhe e falënderoj për këtë mënyrë shpjegimi.

Lidhur me këtë ka të bëjë edhe puna e asaj rregulloreje, po edhe puna e dokumentit që po thuhet, u vërtetua që ky që ka dalë nëpër gazeta është dokument i ofruar në tavolinë.

Unë tash po them, po lexoj pikën gjashtë: “Asociacioni/bashkësia do t’i kryejë kompetencat shtesë, të cilat në të ardhmen mund t’i ndahen komunave dhe pushtetit qendror”.

A nuk është përshkrim i një pushteti të veçantë të asociacionit të komunave ose të bashkësisë, të cilat do t’i marrin, i cili organizim qysh tash nëse është organizim etnik i barazon ose i sublimon të drejtat e komunave në një organ më lart, aq më tepër, që Plani i Ahtisarit ju jep komunave serbe të drejta që nuk janë të njënjëshme? Tjetër të drejta i është përshkruar Mitrovicë-veriut, tjetër të drejta Graçanicës, të tjera Shtërpçës, të tjera komunave tjera. Loja është në detaje. Ky nen parasheh një pushtet sublimues mbi këto dhjetë komuna dhe vetë ndërtimi i asociacionit me dhjetë komuna etnike, në këtë rast serbe, i bie që normalizon një organizëm etnik. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Kuçi, kundër-replikë.

ZËVENDESKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit!

Ndoshta edhe për sqarim dhe po u premtoj tash publikisht, që do t’i qesim edhe në media propozimet tona, që i kemi dhënë. Dhe, unë po e them kështu: kemi dhënë vërejtje në pikën 2, në pikën 1, në pikën 4, në pikën 5, ndërsa pika 6 që e përmendni ju, kemi thënë që të fshihet në tërësi. Ky është propozimi i delegacionit të Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka kryeministri i Kosovës, zoti Hashim Thaçi.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Mendoj se nuk duhet për ta ngatërruar konceptin e dialogut me të debatet në Parlament. Aty është diskutuar rreth 12 orë dhe për çdo ide që është diskutuar, nuk mund të nxirret tash për debat këtu, por marrëveshja përfundimtare bihet për ratifikim ose jo. Dhe, këto gjëra janë të ndara, i nderuari Hamiti.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Hamiti, replikë.

SABRI HAMITI: Unë falënderoj për këtë! Unë e di që çfarë janë bisedat dhe pse bëhen. Unë e di që ka pjesë konfidencialiteti se s’janë duke u bërë në bulevard, por janë një zyrë evropiane me ndërmjetësim me dy përfaqësues shtetesh, të gjitha i di. Por, nuk mund të bëhet kurrfarë bisede substanciale këtu, nëse na thuhet që dita “D”, Kuçi tha s’është “D” po kryeministri e tha që është ditë vendimtare për Kosovën, që i bie njësoj. Atëherë, ne s’kemi objekt diskutimi, nëse s’diskutojmë të cilat janë të pritshmet e vendimeve ose marrëveshjeve në atë ditë? Kaq. Prandaj, bisedojmë ne sot, përndryshe çfarë do të bisedonim.

KRYESUESI: Zoti kryeministër, e keni fjalën.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Unë, i nderuari zoti Hamiti nuk të replikova, vetëm ta qartësova mbi parimet, rregullave dhe standardet e dialogut dhe negociatave. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Konjufca.

GLAUK KONJUFCA: Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Unë pajtohem, që 2 prilli mund të jetë datë historike për Kosovën. Kjo Qeveri e ka banalizuar cilësimin e historikes, siç dihet për ngjarje të ndryshme duke e përdorë për çdo javë, vend e pa vend, por dy prilli vërtet kësaj radhe mund të jetë datë historike për vendin tonë.

Me 2 prill Kosova është në udhëkryq. Prandaj, 2 prilli shënjon një situatë të hapur, për të cilën do të vendosë Qeveria e Republikës së Kosovës. Duke vendosur më 2 prill për Kosovën, ata do ta përcaktojnë drejtimin e vendit tonë dhe mundësinë e sovranitetit të ardhshëm. Do ta përcaktojnë kualitetin afatgjatë të shtetit të Kosovës dhe fizionominë politike të vendit, ku do të jetojnë fëmijët tanë.

Por, duke vendosur për Kosovën pa popullin e saj, ata do ta kategorizojnë historikisht edhe veten e tyre, do t'ia caktojnë vetvetes vendin e tyre në histori.

Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, 2 prilli është datë e rëndësishme për shtetësinë e Kosovës. Më 2 prill do të vendoset se si do ta kujtojë e ardhmja e viteve që shtrihen përpara, këtë datë kyçe.

A do ta kujtojë 2 prillin si një ditë të zezë, kur një grusht njerëzish të korruptuar dhe të burgosur me prangat e shantazhit, shkuan dhe e nënshkruan kornizën e autonomisë, për një pjesë të territorit të Kosovës, apo do ta kujtojë si një ditë kur politikanët qeveritarë të Kosovës, më në fund u mbushën mend dhe i braktisën negociatat, nuk ia pranuan Serbisë entitetin e saj etnik dhe filluan shtrirjen e sovranitetit dhe shpërbërjen e strukturave të Beogradit?

A thua, si do ta kujtojë historia e ardhshme 2 prillin e vitit 2013?

Cili do të jetë vendi i këtyre qeveritarëve, që ata do t'ia bëjnë vetes në histori? Do të jetë vend i lavdisë dhe i shpëtimit apo ai i tradhtisë dhe i turpit? 2 prilli, zonja dhe zotërinj, është përnjëmend datë vendimtare për shumëçka. Po, në fund të fundit, të gjithë do të jemi përgjegjës për diçka. Dikush pse hodhi në letër një nënshkrim, që mund të ketë pasoja fatale për integritetin e shtetit të Kosovës, pas disa vitesh, dikush tjetër pse kur ndodhi kjo gjë e bëri servilin vetëm për një kolltuk politik, e dikush se nuk bëri më shumë për ta ndalë këtë proces. Apo edhe dikush, se që i thotë vetes opozitë, e futi kokën në zall pikërisht atëherë kur Kosova kishte më së shumti nevojë për një zë të qartë dhe veprim të vendosur, duke iu bërë krah një pushteti kaq të korruptuar.

Të gjithë ne do të jemi përgjegjës për atë që do të ndodhë. Të gjithë, ama secili në mënyrën e vet, sipas peshës së veprimeve dhe pozicionit që merr në raport me Serbinë dhe aspiratat e saj hegjemoniste brenda Kosovës. Në këtë pikë, pra secili do të jemi përgjegjës për atë që do të bëjmë.

Por, më sa kemi parë deri më tash dhe më sa i kemi përjetuar deklaratat dhe veprimet konkrete të kësaj Qeverie deri sot, ne e dimë se për cilën rrugë janë përcaktuar qeveritarët tanë në negociata me Serbinë.

Ata janë përcaktuar për rrugën e palavdishme të nënshtimit ndaj kërkesave territoriale të Serbisë në veri, vetëm e vetëm për të arritur një kompromis me Beogradin në kurriz të Kosovës dhe vetëm e vetëm për hir të jetëgjatësisë së pushtetit të tyre personal.

Në vendet e zhvilluara demokratike, atëherë ku vjen puna deri te problemet e ndërlikuara dhe me peshë, të cilat mund të kenë pasoja afatgjate politike për rrjedhat shoqërore dhe shtetërore, politikanët qeveritarë nuk ndjehen të sigurt të vendosin vetë. Prandaj, për shkak të seriozitetit dhe të rëndësisë së çështjes e thërrasin popullin në vendimmarrje, përmes formave të ndryshme plebishitare.

Në këtë mënyrë Qeveria bëhet një dhe e vetme me vendimin e të gjithëve, prandaj çfarëdo që të ndodhë pasojat përjetohen së bashku dhe përgjegjësia mbetet e të gjithëve dhe e secilit. Kurse, Qeveria po kërkon vetëm që të gjithë ta përkrahin dhe t'i besojnë asaj, por nuk po kërkon që të gjithë së bashku të vendosim për këtë çështje. Duke vendosur bashkë, sfidat përballohen më lehtë, por vetë fakti që për këto çështje kaq të rëndësishme si marrëveshje me Serbinë për territorin e Kosovës, populli është i përjashtuar plotësisht, më bind mua plotësisht se atje po shkojnë të na përfaqësojnë njerëzit e burgosur të korrupsionit, njerëz të cilët nuk mund të na mbrojnë fort, sepse nuk janë të pavarur deri në fund.

Prandaj, mos përkrahni vendime të politikanëve qeveritar, që ata i bëjnë për të shlyer borxhe nëse mendoni që në dekadat e ardhshme do të jetoni në Kosovë ju dhe fëmijët e juaj.

Në fund, dua t'i kthehem po ashtu çështjes së transparencës. Kryeministri tha që negociatat kanë dështuar, sepse Serbia e ka refuzuar ofertën konkrete në tavolinë, që paska ndodh në raundin e fundit të negociatave. Çfarë oferte ka qenë kjo? A e di dikush tjetër këtë ofertë, përveç Qeverisë? Si është e mundur që për një çështje kaq të rëndësishme të sovranitetit të Kosovës ta dijë vetëm dikush dhe askush tjetër? Si mund të quhet demokratik një proces i tillë kur e dinë dhe vendosim për një vend dhe për një çështje kaq të rëndësishme vetëm kaq pak njerëz?

Në anën tjetër, nëse është një ofertë kaq pozitive kjo që po thonë qeveritarët, kaq pozitive sa do t'i shpërbëjë edhe strukturat kriminale të Serbisë, atëherë kryeministër, pse nuk po e gëzoni popullin e Kosovës duke ia treguar një marrëveshje që qenka kaq e leverdishme për Kosovën?

Pra, pse të mos bëhet kjo marrëveshje pjesë e diskutimit të përgjithshëm shoqëror, ku janë të kyçur të gjithë, ta shohin deputetët, zyrtarët, qeveritarët, intelektualët, analistët, gazetarët e kështu me radhë? Pse të mos krijohet një ambient politik, ku secili e jep mendimin e vet, krijohet konsensusi shoqëror edhe hajde të marrim vendim bashkë. Po ky është problemi, kjo ofertë po fshihet. Dhe, për sa kohë të jetë kështu, ne kemi bazë të

dysshojmë se ajo është negative për Kosovën, kurse qytetarët kanë të drejtë të mendojnë dhe të ndjehen të pasigurt për të ardhmen e tyre politike. Dhe, është pikërisht kjo jotransparencë ajo që e krijon panikun dhe jo kërkesa jonë që gjërat të bëhen transparente.

Në fund, sa i përket pikave konkrete të marrëveshjes tash edhe nuk po dimë sa është legjitime për t'iu referuar informatave prej mediave, mirëpo këtu u përmendën të gjitha pikat veç e veç, disa edhe prej zotit Hydajet Hyseni, mirëpo unë mendoj që bazamenti i autonomisë, nëse ekziston një autonomi në atë dokument 8 pikësh, që është paraqitur, unë mendoj që është pika 7 dhe pika 2. Pse pika 7 dhe pika 2?

Shikoni se ç'thotë pika 7. Thotë, asociacioni do ta përfaqësojë bashkësinë serbe para autoriteteve qendrore. Të gjithë serbët tash do ta kenë një institucion më të rëndësishëm reprezentativ edhe se Qeveria edhe se Kuvendi. Ata të gjithë do t'i përfaqësojë një institucion etnik që po na krijohet, që quhet asociacioni i komunave serbe.

Në fillim kur u patën krijuar ato komunat e Ahtisaarit, thoshin që po i krijojmë këto, sepse t'i shkëpusim serbët nga ndikimi destruktiv që po e ka Beogradi. Tash po i centralizojnë në një institucion, i cili qendrën gravituese do ta ketë në veri, kurse kryeqytetin e vërtetë do ta ketë në Beograd. Kjo është bazamenti i autonomisë, kjo pika shtatë.

Kurse pika 2 është mbrojtja e autonomisë, mekanizmi mbrojtës i autonomisë. Pse? Se pika 2 thotë: kurrkush nuk mund ta shpërbëjë këtë institucion, veç ai vetveten mund ta shpërbëjë. Domethënë, Qeveria as Parlamenti nuk mund ta shpërbëjë një institucion, me të cilin do të merren vesh me Serbinë.

Po ta marrim një shembull, të çohen atë ditë ata përfaqësuesit e komunave serbe, sidomos...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Edhe një minutë, përmbyle!

GLAUK KONJUFGA: ...çohen ata në mëngjes dhe iu shkon mendja për ta shpallur pavarësinë e tyre prej Kosovës. A ka të drejtë ta shpërbëjë këtë institucion Parlamenti i Kosovës? Qysh mund t'ia jepni një kompetencë kaq të fuqishme një institucioni edhe për ta konservuar deri në atë masë, sa që ai do të jetë i plotfuqishëm përpara çfarëdo institucioni të Kushtetutës së Republikës së Kosovës?

Kjo është konservim i autonomisë, kurse pika 7 është bazament, themeli i autonomisë së ardhshme.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Enver Hoxhaj, ministër i Punëve të Jashtme.

MINISTRI ENVER HOXHAI: Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuari zoti kryesues,
I nderuari zoti kryeministër,
Zëvendëskryeministra,
Kolegë ministra,
Shumë të respektuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,
I dëgjova me vëmendje të gjitha diskutimet e deritanishme, e kam përcjell kështu edhe në detaje debatin publik rreth dialogut në mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë.

Më lejoni që të bëj përpjekje që të jem sa më i strukturuar dhe sa më i qartë në këtë fjalim timin të shkurtë.

Së pari një pretendim që e kemi dëgjuar edhe në media, që e dëgjuam edhe sot në Kuvendin e Kosovës, si pretendim i parë, ka qenë që me këtë dialog Serbia, dialogu dhe vetë ne po e cenojmë rendin kushtetues të Kosovës. Deri më tash kjo nuk ka ndodh dhe unë ju ftoj që ne të mos përshkojmë situata të cilat realisht nuk kanë ndodhur deri më tani.

Përkundrazi, dialogu e ka forcuar fuqishëm rendin kushtetues të Kosovës në veri, e ka fuqizuar fuqishëm sovranitetin tonë të brendshëm në veri përmes arritjes dhe implementimit të marrëveshjes për menaxhim të integruar të kufirit, e cila nuk është asgjë tjetër, veçse njohje de fakto dhe de jure e kufirit, përveç përmes Marrëveshjes së Doganave, përmes shumë marrëveshjeve të cilat janë arritur në këto dy vjetët e fundit dhe veçanërisht ato të cilat janë arritur në këto muajt e fundit.

Unë besoj që këtu duhet të jemi çdokush nga ne realist dhe t'i përshkruajmë situatat vërtetë të cilat vërtetë ekzistojnë edhe në politikë edhe në terren dhe jo ta mbi interpretojmë.

Ka një pretendim të dytë, i cili thotë që dialogu po e cenon sovranitetin tonë. Deri më tash, jo vetëm që na ka mundësuar që të vendosim gurthemelet e sovranitetit tonë në veri të Kosovës, por përkundrazi dialogu është një argument i fuqishëm dhe instrument i fuqishëm në forcimin e pozitës ndërkombëtare të Republikës së Kosovës.

Më lejoni të them, që ka pasur çdoherë pretendime në jetën publike, në këto muajt e fundit, që do ta dobësojë pozitën e Kosovës në Bashkim Evropian ose karshi integriteteve evropiane. Kjo nuk ka ndodh, përkundrazi ne e dimë që kemi marrë studimin e fizibilitetit dhe jemi në fazën finale, që të hapim negociatat për nënshkrimin e Marrëveshjes për Stabilizim-Asociim.

Ka pasur po ashtu pretendime që do t'i bllokojë njohjet. Ne jemi dëshmitarë që procesi i njohjeve ka qenë i pandalshëm dhe gjeografia e tij ka qenë globale.

Ka pasur po ashtu pretendime që do ta bllokojë Kosovën në integrimin e saj në sistemin ndërkombëtar. Po, ju e dini që ne kemi arritur që në muajt e fundit të anëtarësohemi në shumë organizata ndërkombëtare, qoftë evropiane, qoftë rajonale, Banka Evropiane për

Zhvillim dhe Rindërtim është një dëshmi konkrete. Këshilli rajonal që është kontinuitet i Paktit të Stabilitetit është po ashtu një dëshmi konkrete.

Ka po ashtu një grup të tretë të pretendimeve, që përmes dialogut dhe sidomos debate rreth asociacionit të komunave, si ide që asociacioni është i barabartë me territorin dhe autonominë, fondit për zhvillim në veri, që është i barabartë me financa të pavarura dhe çdo që është pretenduar në shtypin serb që përmes kësaj do të krijohet një etnitet i veçantë në veri.

Fakti që në dy takimet e fundit nuk ka pasur marrëveshje, s'ka pasur marrëveshje, për pretendime të tilla, të cilat janë pretendime jashtë Kosovës, juve duhet t'ju bëj të sigurt që kjo nuk do të ndodhë. Nuk do të ketë status të veçantë, nuk do të ketë autonomi territoriale dhe askush këtë nuk e kërkon, jo vetëm brendapërbrenda jetës politike të Kosovës, po as faktorët ndërkombëtarë. Askush në Bruksel nuk është i interesuar që të ketë një Bosnjë të dytë në Ballkan. Askush në Bruksel nuk është i interesuar që të ketë një Qipro të dytë në Ballkan, prandaj nuk e di pse deputetët e Kuvendit të Kosovës shpeshherë përdorin argumente, të cilat nuk janë në favor të Kosovës.

Unë mendoj që sa i përket dialogut, përveç debateve që i kemi rreth asociacionit të komunave, kompetencave të tij, duhet vërtet ta kemi një debat në mes vete më të sinqertë, më direkt.

Është fakt evident që në 13 vjetët e fundit, ne s'kemi mbërri që ta riintegrojmë veriun e Kosovës dhe dialogu synon që ta normalizojë situatën në veri përmes zhbërjes së strukturave paralele dhe përmes rientegrimit të këtyre tri komunave. Po ashtu, ne synojmë që t'i zgjidhim të gjitha çështjet bilaterale të hapura me Serbinë, të cilat nuk kemi arritur t'i zgjidhim në këto pesë vjetët e fundit.

Po, ne nuk e kemi vetëm një situatë komplekse në veri, nuk e kemi vetëm një relacion kompleks me Beogradin. Ne kemi relacion kompleks edhe me Brukselin dhe besoj që të gjithë ata që merren me politikë të jashtme edhe në Kuvendin e Kosovës, duhet të jenë të vetëdijshëm për këtë punë. Parlamenti Evropian e ka njohur Republikën e Kosovës, por jo edhe Komisioni Evropian dhe Këshilli Evropian.

Përmes këtij dialogu ne synojmë që ta fuqizojmë edhe pozicionin tonë në Bruksel. Prandaj, mua më ka ndodhur shumë shpesh, që në vendet aziatike një ministër i Punëve të Jashtme më thotë, ne nuk do ta njohim Kosovën, se vetë Brukseli nuk është unik karshi Kosovës. Dhe, ne synojmë që përmes një dialogu të tillë edhe t'i bindim pesë vendet e Bashkimit Evropian, që s'e kanë njohur Kosovën, ta bëjnë një gjë të tillë edhe të kemi marrëdhënie kontraktuale si shtet sovran i pavarur me BE-në, por edhe ta hapim perspektivën e anëtarësimit tonë në NATO, që është shumë kyç për Republikën e Kosovës, por mbi të gjitha ta kemi edhe një bazë legale bilaterale me Serbinë, që të aplikojmë për anëtarësimin e Kosovës në Organizatën e Kombeve të Bashkuara.

Unë e dëgjova me vëmendje profesor Sabri Hamitin, për të cilin kam vërtet respekt të madh, e përmendi këtë ditën "D", "D-day" nuk di në çfarë konteksti e përmendi. Ka

relacione, ka nivele të ndryshme, se si të kuptohet kjo ditë, po një gjë mund të them që më hyri në profesion timin dhe unë po bëj përpjekje që t'i hyj profesor Sabri Hamitit, në profesionin e tij, meqë ai është letrar. S'po e interpretoj këtë ditën "D" edhe nuk di kush e ka dhënë idenë e ditës "D", s'di a e ka menduar çlirimin a invazionin a, faktin që dikush dikë e ka zënë në gjumë a, po, pa e mbiinterpretuar, meqë profesor Sabri Hamiti është letrar, unë e dëgjova debatin e sotshëm, i kam dëgjuar edhe dy debatet e fundit në dy seancat e fundit, e pata përshtypjen që kur po flet për dialogun, goxha po operon me skenar të dramave të Shekspirit, ku në fund të skenës krejt aktorët vdesin. Unë po e shoh profesorin e nderuar Eqrem Kryeziun, i cili është lexues dhe studiues i njohur i Çehovit, unë po i them profesor Sabri Hamitit, që ne jetojmë në kohën e skenarëve të Çehovit, që aktorët lodhen, janë të frustruar, po mbesin në skenë dhe kur kryhet drama, të gjithë dalin dhe e përshëndesin publikun, se mbesin në skenë.

Prandaj, Republika e Kosovës do të mbetet në skenë, si shtet sovran dhe i pavarur dhe unë i kisha ftuar, mbi të gjitha ata që janë akademikë, të mos e kultivojnë një narracion të frikës, se ne e kemi kultivuar një kulturë të shpresës, në një kohë më të vështirë për Kosovën dhe jo në 2013-ën. Faleminderit!

(Drejtimitin e seancës e merr nënkryetari i Kuvendit, zoti Petar Miletiq.)

KRYESUESI: Hvala, ministre! Replika, potpredsednik skupštine gospodin Hamiti.

SABRI HAMITI: S'po qohem në këmbë, sepse edhe ashtu pak më i ri je. Shiko, unë ciklikisht në këto vite që jam në Kuvend, e jam pak më gjatë se zoti Enver Hoxhaj, e kam përjetuar detyrën e tij që në mënyrë pak a shumë tash ta themi të lëshuar të flas dhe të interpretojë letërsi. Po de letërsinë e lexojnë të gjithë edhe ata që me zanatin në mundësitë që kanë.

Këtu nuk jam letrar. Letrar janë 40 librat që qarkullojnë. Këtu jam përfaqësues i qytetarëve të Kosovës, i cili flet për një çështje fundamentale për këtë vend. Quani ju si të doni, kryeministri juaj vetë këtu e nënvizoi dhe lexone tekstin e tij se unë dëgjoj mirë, lexoj por edhe janë të regjistruara, është ditë vendimtare për Kosovën. As s'thashë më shumë as më pak.

Unë thashë, nëse është vendimtare dhe ne i kemi punët kaq mirë, aq më mirë, po thashë nëse është vendimtare nuk i kemi punët aq mirë, nuk është mirë që të ngutemi ta bëjmë vendimtare. Kaq!

Sa për problemet e jetës dhe të artit, ato janë paralele, unë nuk jam, nuk e mendoj artin si imitim të jetës, harroje, ato janë dy botë paralele. As Shekspiri nuk e thotë jetën, por e thotë një projektim të jetës, as ky tjetri, rusi që po thua, që i len gjallë aktorët.

Kështu që janë dy sende, unë ta pranoj sharmin që po donë ta bësh me mua, po, jo, jo, këtu Sabri Hamiti është përfaqësues i interesave qytetare...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Ministre, izvolite!

MINISTRI ENVER HOXHAI: I nderuar, zoti kryesues!

Të nderuar zonja e zotërinj,

Po largohemi jashtë letërsisë dhe po hyjmë në politikë dhe në jetën reale. Është një fakt i pamohueshëm për Republikën e Kosovës në 5 vjetorin e saj, që ne edhe më tutje e kemi një relacion shumë kompleks me Bashkimin Evropian.

Më lejoni t'ju kujtoj juve si deputetë të Kuvendit të Kosovës që kur ne e festuam 5 vjetorin e pavarësisë së Kosovës në këtë sallë, përfaqësuesi i Bashkimit Evropian nuk mori pjesë. Dhe nëse juve s'ju ka bërë përshtypje, mua më ka bërë shumë përshtypje pse ky vend, ky vend me histori, me gjeografi dhe me kulturë është evropian dhe fakti që përfaqësuesi i Bashkimit Evropian nuk merr pjesë në gjysmën e dekadës të parë të shtetit të Kosovës, mendoj që duhet t'i shqetësojë të gjithë ata që janë në këtë sallë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Još vremena za ministra!

MINISTRI ENVER HOXHAI: Së dyti, edhe unë e vërej çdo ditë në lëkurën time. Unë bëj kërkesë që të takohem me sekretaren e përgjithshme të UNESCO-s, e cila qe 5 vjet s'më pret as mua, po s'e pret asnjë përfaqësues të Republikës së Kosovës.

Ne duhet të jemi të vetëdijshëm që dialogun ta përdorim si instrument për fuqizimin e pozitës tonë ndërkombëtare. Unë pajtohem që asociacioni mund të hapë dilema dhe unë pajtohem që ne nuk duhet të jemi naiv në një proces të tillë.

Po duhet ta shohim pakëz situatën edhe përtej një asociacioni dhe përtej disa kompetencave të cilat janë të përmendura në një dokument i cili padyshim që nuk është dokument zyrtar të cilin unë nuk jam i interesuar që ta interpretoj ose të më mbinterpretojë.

Prandaj, për çdokënd që është intelektual dhe politikan është me rëndësi që ta kuptojë peshën e vitit 2013 dhe çfarë do të thotë kjo për Republikën e Kosovës në planin afatgjatë.

KRYESUESI: Hvala! Reč ima poslanik Bekim Haxhiu.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryesues!

I nderuar kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Nuk mund të themi se po afrohet dita d, por mund të themi tani se po i afrohem takimit vendimtar të 2 prillit, ku pritët të bëhen hapa konkret në procesin e normalizimit të marrëdhënieve në mes Kosovës dhe Serbisë dhe me arritjen e nënshkrimit të marrëveshjes dypalëshe Kosovë-Serbi, atëherë edhe argumentet refuzuese kategorike të Rusisë dhe të

vendeve tjera aleate të Serbisë për të refuzuar shtetësinë e Kosovës, nuk do të ekzistojnë më.

Procesi i normalizimit të marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë duhet të ndodhë dhe duhet kuptuar se nuk është vetëm për rregullimin e raporteve apo relacioneve direkte Kosovë-Serbi, por procesi i normalizimit është me peshë edhe në rrafshin diplomatik ndërkombëtar, ku Kosova po tregohet e përgjegjshme duke mbrojtur Kushtetutën e saj dhe duke marrë përsipër edhe detyrimet ndërkombëtare. Dhe me këtë qasje serioze të diplomacisë kosovare të udhëhequra nga kryeministri ynë, besojmë shumë se do të arrihet që të ndikohet edhe te 5 vendet e BE-së që nuk e kanë njohur shtetësinë e Kosovës, që të zbusin qëndrimet e tyre dhe ato të lëvizin drejt njohjes së Kosovës, duke përgatitur kështu rrethanat për anëtarësimin e Kosovës në Organizatën e Kombeve të Bashkuara.

Nuk dua të diskutoj sot në frymë triumfaliste, sepse ka ende shumë punë për të bërë dhe se triumfin Kosova e ka gëzuar dhe qytetarët e saj kanë përjetuar në qershorin e vitit 1999 dhe më 17 Shkurt 2008, por edhe fryma e diskutimeve defitiste të një pjese të opozitës apo individëve të caktuar se Kosova do të humbë në bisedime, ndërsa Serbia do të fitojë, po e demantojnë rrethanat reale të ecurisë së bisedimeve, rruga që po ecën Kosova dhe ngërçin që ka mbetur Serbia.

Të nderuar kolegë deputetë, është më se e qartë se Serbia ka ngecur në ngërç nën kurth që i ka ngritur Kosovës, në kurthin e veriut. Është më se e qartë se Kosova në këtë situatë është më komode, sepse Serbia për të vazhduar rrugën e saj drejt integritit në Bashkimin Evropian, duhet ta zhbëjë kurthin që vetë e ka ngritur në veri të Kosovës, me kriminelë lokalë të cilët i ka financuar vetë dhe me struktura kriminale të cilat i ka financuar vetë ajo. Serbia e ka të qartë këtë dhe tani kanë filluar që kurthin ta zgjidhë vetë duke zhbërë struktura të saj në veri dhe duke filluar diskutimet për të ndryshuar edhe Kushtetutën e saj, sepse fillimi i vetë kurthimit të Serbisë fillon në Kuvendin e Serbisë, në Kushtetutën e saj.

Të nderuar kolegë deputetë,

Derisa kryeministri këtu raporton në baza të rregullta, takim pas takimi, duke respektuar Rezolutën e Kuvendit, atëherë cila është arsyeja për skepticizëm e defetizëm, kur kufijtë e Kosovës janë ndërkombëtarisht të njohur dhe askush nuk po kërkon nga ne që t'i ndryshojmë ata dhe askush nuk po kërkon nga ne që të ndryshojmë Kushtetutën, por ta respektojmë atë.

Një gjë e tillë për ndryshime të Kushtetutës po kërkohet nga Serbia dhe të jemi realistë ne në asnjë kushtëzim nuk do të mund të bënim që Serbia të ndryshojë Kushtetutën e saj. Një gjë e tillë po e bën faktori ndërkombëtar për ne.

Dhe krejt në fund në fjalimin tim do ta përfundoj duke i uruar kryeministrit dhe Kabinetit qeveritar në këtë dialog punë të mbarë dhe shëndet të mirë. Faleminderit!

Mbledhjen e kryeson nënkryetari i Kuvendit, zoti Xhavit Haliti.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Haziri e ka fjalën.

LUTFI HAZIRI: Të nderuar deputetë,
Zoti kryeministër,
Ministra,

Zoti kryesues, Faleminderit për mundësinë që të marr pjesë në këtë debat, i shtati me radhë në kuadër të procesit të dialogut mes Kosovës dhe Serbisë. Po them me qëllim sepse dua të nënvizoj prapë atë që kam thënë edhe herën e kaluar, ky proces shpeshherë nga ne kur diskutohet lidhet me projektin apo me propozimin gjithëpërfshirës për statusin e Kosovës, që lidhet me një plan krejt tjetër, një proces krejt tjetër i cili e ka përfunduar misionin e vet me shpalljen e Deklaratës, më 17 shkurt.

Koha dëshmoi që ai plan nuk u imponua, ai propozim nuk u imponua, sepse një pjesë e bashkëqytetarëve tonë të etnisë serbe nuk e pranuan, për deri sa si i tillë koha e dëshmoi që ka qenë i vendosur në barometra jashtëzakonisht të kompromiseve të mëdha duke dashur që procesi të mbyllet me atë që ne e kemi quajtur procesi i Vjenës.

Sidoqoftë atje modeli i bisedimeve, formati i bisedimeve, edhe i negociatave, e drejta e delegacionit serb të marrë pjesë në organizimin e brendshëm të Kosovës dhe fjala e tyre ka qenë e pranuar, kanë pasur ... jashtëzakonisht të fuqishëm, por nuk e kanë shfrytëzuar, sepse në fund e kanë refuzuar planin në tërësi duke pretenduar që me nxjerrë atë që ata mendojnë në raport me Kosovën, iu takon.

Parimi i diskriminimit pozitiv është kaluar, tash po flasim për ambiguitet konstruktiv dhe parimi tjetër po ashtu në këtë format të bisedimeve është që korniza evropiane e normalizimit t'i arrijë minimumin e standardeve që duhet Kosova e Serbia, në mënyrë që mos ta bllokojnë njëra- tjetrën.

Natyrisht që 2 prilli është një fund i pritur i këtij procesi që do të njihet si proces i Brukselit. Ajo që unë po e shoh në këto dokumente që qarkullojnë në media e që me që ra fjala, unë jam njëri prej atyre që mendoj se ka ardhur koha dhe jemi në fazën kur Qeveria dhe kryeministri duhet t' i ndajnë letrat, duhet t' i ndajnë dokumentet, sepse zëvendëskryeministri pas kryeministrit dha shumë impute që quhen apo shumë vlerësime dhe ndërhyrje të Qeverisë në dokument, sepse është përparësi e madhe kur e ke dokumentin kur e punon atë, kur e din çka ka, çka shkruan, çka ke ndërhy, çka s'ke ndërhy, për deri sa ne si deputetë jemi larg atij dokumenti dhe debatet tona janë kryesisht në formatin e shkrimeve në media, bile kohëve të fundit më së shumti duke e parë atë të mediave që publikohen në Beograd dhe gazetatat tona po iu referohen atyre.

Dy çështje, tash po flasim për një të drejtë të organizimit alternativ të komunave me shumicë, të cilave iu njihet në fushën e të drejtave të garantuara me ligj, iu njihet e drejta e propozimit dhe e drejta e përfaqësimit, edhe më tutje në dokument që e ka pasur të drejtën e vendimit dhe të drejtën e ushtrimit të asaj detyre.

E drejta e propozimit i fuqizon autoritetet se me vetë faktin që ka të drejtë të flasë, të thotë, të propozojë në fushën e kompetencave dhe mandej atë të drejtë e përfaqëson në

nivel, është e drejtë që po garantohet në këtë pako të dokumenteve, që duhet pasur parasysh këtu nuk duhet lejuar ambiguitet konstruktiv, sepse duhet me qenë sa më eksplicitë të mundshëm në mënyrë që mos lejojmë dykuptimësi nesër në ushtrimin e detyrave.

Kjo është ajo që unë mendoj edhe pse besoj shumë që për delegacionin kjo ka qenë e qartë prej fillimit, përvoja e këtij procesi na ka mësuar që duhet me qenë të kujdesshëm dhe këto parimet e vijave të kuqe të mbrohen me seriozitetin më të madh.

Ajo që unë po e shoh, tash nuk po flasim më për korridore në Kosovë, nuk po flasim për kërkesa të korridoreve territoriale në Kosovë, nuk po flasim më për lëkurën e leopardit në Kosovë, nuk po flasim më për skemat që Serbia i ka pasur skenar, Serbia është tërhequr në një pozitë “defantiste” duke dashur organizimin e vet ta fokusojë në një territor të caktuar të Kosovës që me numra me e përkthye 17%.

Nëse procesi i Vjenës e ka eliminuar korridorin territorial dhe vendosjen e lëkurës së leopardit në shumicën e territoreve këtu është ajo që tha zoti Ferati që qytetarët e Anamoravës e kanë paguar çmimin e veriut për të mos lejuar atje dhe në Kosovën qendrore një çmim për shkak të prezencës serbe është paguar atje dhe duhet me qenë mirënjohës, sepse çmimi politik nuk është i madh as kërcënues sot çfarë është menduar në fillim, sepse është treguar shumë funksional dhe i pranueshëm.

Tash këtë pjesë të territorit vërtet, në kuptimin e attributeve shtetërore Qeveria duhet ta ruajë, ndërsa të drejtën e propozimit, të drejtën e përfaqësimit ta sqarojë dhe këtu e përfundoj fjalën time. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! I jep përparësi zonjës Lama.

ALMA LAMA: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Balanca e pushtetit mes qeverisë lokale dhe asaj qendrore ka shumë rëndësi, ka rëndësi sepse ka të bëjë me përmirësimin e jetës së njerëzve, të komuniteteve lokale dhe sepse pikërisht në këtë raport, në këtë balanc shtrihet përgjegjësia dhe llogaridhënia në lidhje me përmirësim. Edhe më thelbësore, për një shtet siç është Kosova, është sepse është një shtet me demokraci të brishtë dhe me pamundësi për të shtrirë autoritetin në të gjithë territorin.

Dhe, këtu qëndron frika jonë, kur diskutojmë për çështjen e kompetencave të asociacionit të komunave, jo sepse jemi për të kufizuar apo ngulfatur lirinë e komuniteteve lokale, në bazë të asaj që quhet vetëqeverisje, e pranuar tashmë gjerësisht në Bashkimin Evropian dhe më gjerë. Pra, ne nuk jemi për ta bërë këtë.

Çështja është se këto kompetenca kanë kufizime për të ruajtur balancin, në të gjitha vendet e BE-së nuk gjendet asnjë shembull ku pushteti lokal të ketë të drejtën të vendosë

për çështje, për shembull, të sigurisë, gjyqësorit, të mbledhin taksa në dogana dhe t'i menaxhojnë ato në mënyrë të pavarur.

Varësisht nga kompetencat që ka pushteti lokal, mund të prodhohet ndryshimi, ta zëmë kompetenca të cilat nuk interferojnë në kompetencat e pushtetit qendror mund të ndikojnë shumë pozitivisht në përmirësimin e jetës së komunitetit, për kompetencat që mund të interferojnë apo përplasen me kompetencat e pushtetit qendror, mund të prodhojnë bllokada dhe konsekuenca të jashtëzakonshme për funksionimin e një vendi.

Kjo nuk është një gjë të cilën ne thjesht po e imagjinojmë, kjo në fakt është një eksperiencë nëpër të cilën kanë kaluar shumë vende, si Anglia, Franca Gjermania e tjerë.

Problemi që ngremë ne është se nga dera e pasme dhe me një gjuhë kamufluese po tentohet të futet një model i cili askund nuk është pranuar, në asnjë vend të BE-së, por nuk është puna se ne po e kundërshtojmë vetëm për këtë arsye, sepse Kushtetuta e Kosovës tashmë është më e avancuar se çdo kushtetutë tjetër evropiane, aq sa i ka futur frikën shumë vendeve, për shkak të bujarisë me minoritetet.

Ne kundërshtojmë sepse nuk duam që sot të mundësojmë krijimin e një blloku territorial politik të pavarur i cili thjesht synon të shpëputet. Serbia nuk po ngurron të pranojë këtë marrëveshje, por thjesht po bën lojë në negociata, kundërshton fuqishëm në mënyrë që të marrë maksimumin, dhe me vjen keq që kryeministri i Kosovës nuk është në gjendje të kuptojë këtë lojë.

Çështja tjetër është se edhe sikur të ishte një marrëveshje pozitive, kjo që pritet të miratohet, cila është garancia që marrëveshja do të respektohet.

E marrim vetëm një shembull, a po respektohet marrëveshja e Kumanovës, ku thuhet e zeza mbi të bardhë se ushtria serbe nuk duhet t'i afrohet kufirit me Kosovën në largësinë prej 5 kilometrash, dhe këtu është garantues KFOR-i.

E në fakt kjo jo vetëm që nuk po respektohet, por në zonën e Kamenicës, për shembull, kemi parë shpesh forca të xhandarmërisë serbe, madje të hyjnë edhe në brendësi të territorit, të mos flasim për në veri kur policia serbe ka ardhur dhe ka bërë disa arrestime në mes të ditës.

E them këtë sepse po dëgjoj kryeministrin që po flet se KFOR-i do të jetë garantues, kam shumë respekt për KFOR-in, por ne e dimë se Serbia është një vend tipik që nuk respekton parimin pacta sunt servanda, sa herë na e ka dëshmuar këtë. Po të ishin respektuar plotësisht marrëveshjet e pasluftës, sot nuk do ta kishim fare këtë gjendje që është aktualisht në veri.

Por, ajo që unë dua të ngre si shqetësim, por edhe si kërkesë është që të mos bazohemi shumë tek garancitë e të tjerëve, por te puna jonë, sepse shtetin nuk mund as të na e ndërtojnë e as të na e mbajnë të tjerët, por duhet ta ndërtojmë e mirëmbajmë vetë, për çdo ditë.

E dëgjova ministrin e Jashtëm, i cili foli disa gjëra shumë të papërshtatshme. Unë e ftoj atë që me të vërtetë të mos hyjë në territore të panjohura, se po ta kishte lexuar Shekspirin, nuk do të ishte shprehur ashtu. Edhe pse është e pritshme që nga kryediplomati të ketë kulturë, të jetë i pajisur me një kulturë shumë të gjerë. Imagjini një takim, zoti ministër, me homologun tuaj britanik dhe ju nuk e dini se çfarë thotë Shekspiri. Ju garantoj që vepra e tij nuk vjetrohet, sepse ka vlera universale dhe këtë duhet ta dini edhe ju.

KRYESUESI: Zoti Demolli e ka fjalën.

HAKI DEMOLLI: Faleminderit, i nderuari kryesues!

I nderuari Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Kjo pikë e rendit të ditës të seancës së Kuvendit të Kosovës, është caktuar dhe po mbahet në bazë të një shkrese të kryeministrit, e cila përmban një gjysmë faqe të vetme, në të cilën ndër të tjera thuhet se kryeministri shpreh gatishmërinë që t'i informojë deputetët e Kuvendit për takimin e shtatë me kryeministrin e Serbisë, Ivica Dačić.

Ndonëse deri më tani janë mbajtur 7 takime të dy kryeministrave, ne si deputetë të Kuvendit të Kosovës nuk kemi marrë asnjë shkresë të vetme, në të cilën kryeministri do të na informonte në formë të shkruar për rrjedhat konkrete të bisedimeve.

Duke pasur parasysh rëndësinë jetike që e kanë pikat e bisedimeve për një pjesë të madhe të territorit të Kosovës, mendoj se ne si deputetë të Kuvendit e njëherësh përfaqësues të zgjedhur të popullit të Kosovës, duhet të informohemi në formë të shkruar jo vetëm për pikat kryesore të bisedimeve, por edhe për çështje të tjera të rëndësishme që kanë të bëjnë me procesin e bisedimeve si dhe me epilogun e këtyre bisedimeve, sepse në Bruksel është duke u biseduar për strukturat paralele, për asociacionin e komunave serbe dhe kompetencat e tyre, për menaxhimin e kufirit me Serbinë si dhe për çështje të tjera të rëndësishme për vendin tonë, kurse ne si deputetë të Kosovës deri më tani jemi aq të informuar sa edhe çdo qytetar i rëndomtë i Kosovës. Pra, sikurse qytetarët ashtu edhe ne deputetët burim të informatave për këto bisedime i kemi mjetet e informimeve, por për dallim prej qytetarëve deputetët janë duke diskutuar në Kuvend dhe në njëfarë mënyre duke analizuar dhe komentuar e madje edhe duke prodhuar lajmin lidhur me bisedimet ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.

Dëshiroj t'ia bëj me dije qytetarit se deputetët e këtij Kuvendi janë të informuar lidhur me bisedimet aq sa edhe vetë qytetarët, respektivisht aq sa informojnë mediet, kurse në media jo që hasen tituj kontravers dhe kundërthënës, por hasën edhe deklarata diametralisht të kundërta lidhur me çështje të njëjta, nga kryeministrat e dy vendeve që njëherësh janë edhe aktorët kryesor të bisedimeve.

Kësisoj në media lidhur me këto bisedime janë paraqitur ndër të tjera edhe tituj të këtillë: Zbulohet përmbajtja e dokumentit për normalizimin e raporteve Kosovë-Serbi. Titulli tjetër, Ahtisari plus, nis me 5 vende shtesë për serbët. Titulli tjetër: Dykuptimësia e asociacionit të komunave serbe. Pastaj titulli: Kosova po rrezikon të krijojë nivelin e tretë

të krijojë nivelin e tretë të pushtetit. Pastaj titulli tjetër: Nikoliqi thotë: Prishtina ka lëshuar pe, e të tjerë.

Pra, vetvetiu shtrohet pyetja a duhet deputeti i Kuvendit të Kosovës të shndërrohet në hetues dhe të ndërmarrë veprime me të cilat do të zbulojë dokumentet që kanë përmbajtjen e bisedimeve, pastaj të hetojë se dokumenti është origjinal apo fals, apo thjeshtë t'iu besojë raportimeve të publikuara në media dhe diskutimin e tij në Kuvend ta bazojë në mediet, të cilat ai i ka më të preferuara dhe iu beson më shumë.

Unë mendoj se një mënyrë e këtillë e veprimit dhe punës në përgjithësi jo vetëm që nuk është korrekte, por nuk është serioze, sepse ne si deputetë duhet të kemi para vetes raportet apo informatat nga kryeministri në formë të shkruara, në të cilat do të trajtoheshin çështjet kryesore të bisedimeve dhe variantet e propozuara si nga njëra, ashtu edhe nga pala tjetër. Madje, këto shkresa do të duhej të na dorëzoheshin disa ditë më parë në mënyrë që mirë e mirë t'i analizonim e pastaj të japim vlerësimet dhe propozimet tona konkrete, sepse edhe ashtu ky Kuvend do të jetë përgjegjës për të gjitha rrjedhat, e sidomos për epilogun e këtyre bisedimeve.

Andaj mirë është që ne si deputetë dhe ky Kuvend si institucion të jemi aktorë aktivë në të gjitha fazat e zhvillimit të këtyre bisedimeve e jo të jemi statistë pasivë që shërbejmë vetëm për të përmbushur anën formale se kinse kryeministri po na raporton, respektivisht po na informon për rrjedhat e bisedimeve. Kështu thjeshtë, në mungesë të një raportimi korrekt nga ana e kryeministrit para neve deputetëve kanë mbetur shumë dilema të hapura, të cilat vetvetiu përcillen me pyetjen se kujt t'i besohet: fjalëve të kryeministrit tonë, fjalëve të kryeministrit serb, deklaratave të zyrtarëve evropianë apo medieve vendore, apo medieve serbe, apo të atyre ndërkombëtare?

Ky informim i mangët nga kryeministrit ynë vërtet ka shkaktuar një gjendje konfuze jo vetëm tek deputetët, por edhe te qytetarët e Kosovës, e unë do t'i theksoja disa qëndrime kontradiktore, apo deklarata kontradiktore të dy palëve pjesëmarrëse në bisedime, e të cilat jo që kontribuojnë në krijimin e këtij konfuzioni, por edhe e thellojnë atë.

Kështu për shembull, sipas palës kosovare, asociacioni i komunave serbe përkufizohet si një organizatë joqeveritare, kurse sipas Daçiçit, krijimi i bashkësisë së komunave nënkupton një nivel të tretë të pushtetit.

Më tutje, kryeministri jonë ka deklaruar se strukturat paralele serbe të sigurisë do të rasformohen, kurse Daçiçi deklaroi se Serbia nuk ka fare struktura të sigurisë në Kosovë, andaj nuk ka edhe çka të rasformohet.

Më tutje, kryeministri Thaçi deklaroi se asociacioni i komunave serbe do të themelohet konform dispozitave kushtetuese dhe ligjore të Kosovës, që janë në fuqi, gjë që e bën që të dyshojmë dhe të pyesim pse paska nevojë të bisedohet dhe të negociohet për diçka që tanimë qenka rregulluar me dispozita ligjore?

Andaj me qëllim të eliminimit të këtyre dilemave dhe dilemave të tjera të kësaj natyre, kërkoj që për çështjet të cilat kanë qenë objekt i deritanishëm i bisedimeve, por edhe për

çështjet që do të bisedohet në të ardhmen, kryeministri me ekipin e tij bisedues, të përpilojë raport apo informatë në formë të shkruar të cilat ne si deputetë do të kemi mundësi t'i lexojmë, analizojmë, por edhe t'i shfrytëzojmë për propozime konkrete lidhur me çështje të ndryshme. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Kasolli e ka fjalën.

AFRIM KASOLLI: Faleminderit, i nderuar kryesues,

Dhe, të nderuar deputetë,

Dialogu ndërmjet Qeverisë së Serbisë dhe të Kosovës të ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian, tashmë po e merr epilogun e tij përfundimtar për këtë fazë.

Edhe përkundër jo transparencës së tmerrshme që e ka karakterizuar këtë proces, tashmë gjërat kanë filluar të marrin qartësinë e tyre fatkeqësisht me pasoja negative për shtetin e Kosovës.

Me krijimin e fondit zhvillimor për veriun, fond ky që paraqet një precedent të rrezikshëm për rendin konstitucional, politik dhe ekonomik, sepse promovon diferencimin ekonomik si dhe mos barazinë e kushteve në linja etnike për qytetarët e një shteti dhe rrënon postulatet themelore për ndërtimin e një rendi demokratik. Ndërkaq, me krijimin e asociacionit të komunave serbe brenda territorit të Kosovës, një entitet politik sipas linjave etnike përfundimisht vuloset ndarja e brendshme territoriale dhe legalizohen strukturat shtetërore Serbisë brenda territorit të Kosovës.

Kështu, me krijimin e këtyre mekanizmave të reja politike paradoksalisht për herë të parë në histori po krijohet një model i paparë në rregullimin e brendshëm të një shteti. Ato struktura që deri më tani e kanë kontestuar dhe sulmuar shtetin e Kosovës, në këtë mënyrë po shpërblehen me privilegje për veprimet e tyre me instrumente të reja financiare, juridike dhe politike.

Por, përtej kësaj situate është interesant të vihet re se gjatë gjithë kësaj kohe sa ka zgjatur ky proces i dialogut, fraza më e shpesh që jemi mësuar të dëgjojmë nga aktorët kryesor që kanë qenë të involvuar në këtë proces, ka qenë fraza se këto negociata janë të vështira dhe se kompromiset e mundshme që do të bëhen po ashtu do të jenë të vështirësia për të dyja palët.

Mirëpo, me këtë slogan, në të vërtetë është tentuar të mbulohet e tërë esenca e këtij procesi, në mënyrë që të relativizohen kompromiset ndërmjet palëve, sepse përtej kësaj retorike ideologjike strategjikisht kjo qasje manipulative tenton pikërisht t'i mbulojë pasojat dëmshme që epilogu i tyre në të vërtetë do të ketë për shtetin Kosovën.

Sepse, kur flitet për negociata të vështira dhe për kompromise të vështira dhe veçanërisht kur merren parasysh deklaratat e Daçiqit, harrohet fakti se ai flet për kompromise të vështira që duhet t'i bëjë duke u nisur nga një pozicion tjetër politik maksimal që ka për

Kosovën, pra nga pozicioni që e ka të përkufizuar edhe në Kushtetutën e Serbisë për Kosovën si pjesë integrale të shtetit serb.

Dhe njëmend, sipërfaqësisht të krijohet përshtypja se kur ai flet për asociacionin e komunave apo edhe për fondin zhvillimor sikur është fjala për një kompromis, por derivimi i këtyre deklaratave bëhet gabimisht nga konteksti i politikës së brendshme dhe jo nga gjendja reale, sepse në këtë mënyrë qëllimisht maskohet e vërteta sikur këto janë lëshime të Serbisë për Kosovën, por në të vërtetë, këtu është saktësisht e kundërta e këtij procesi, sepse këto janë kompromise dhe lëshime të reja që Qeveria e Kosovës i bën për Serbinë në dëm dhe në kurriz të shtetit të Kosovës.

E, në anën tjetër, Qeveria e Kosovës pastaj këtë qëndrim të saj disfatist në këtë odiseadë të re mundohet ta mbulojë me pretendime absurde, duke ekspozuar veten gjoja si “shpëtimtare” të Kosovës, sepse me anë të këtyre kompromiseve e pengojnë realizimin e qëllimeve maksimale të politikës serbe që është rianeksimi i Kosovës. Mirëpo, përtej këtyre qasjeve dhe dallimeve gjoja formale nën efektet e kësaj strategjie me anë të këtyre negociatave dhe lëshimeve të vazhdueshme që Qeveria e Kosovës është duke i bërë ndaj shtetit të Serbisë, në të vërtetë ky shtet është duke e realizuar agjendën e tij të dyfishtë politike.

Duke u shtirur si një palë e cila është e interesuar që me anë të dialogut të zgjidhë problemet me Kosovën, në të vërtetë ai vazhdimisht po i krijon favore vetit dhe po i përtërin premisat në sajë të kompetencave të reja që po fiton për defunksionalizimin dhe dështimin e shtetit të Kosovës nga brenda e zaten ky është edhe qëllimi themelor i Serbisë, jo rianeksimi total në këtë moment, por krijimi i atyre rrethanave dhe përfitimi i atyre kompetencave që do ta bënin të dështonte nga brenda shtetin e Kosovës.

E në anën tjetër pa e plotësuar asnjë kusht paraprak, qoftë legal apo moral ndaj krimeve që i ka kryer në Kosovë, shteti serb, në të njëjtën kohë avancojnë në agjendën e tij integruese drejt Bashkimit Evropian.

Kështu, këtë avancim Qeveria e Serbisë e përfiton çuditërisht pikërisht në sajë të këtyre negociatave dhe lëshimeve që është duke i bërë Qeveria e Kosovës për shtetin e Serbisë në dëm të shtetit të Kosovës.

Mbase, ky është shërbimi më i mirë që në këtë moment i është nevojitur Daçiqit dhe që fatkeqësisht Qeveria e Kosovës është duke ia bërë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Demaku e ka fjalën.

FADIL DEMA KU: Faleminderit, nënkryetar!
I nderuar zëvendëskryeministër,
Ministra,
Kolegë deputetë,

Disa herë në Kuvend e kam dëgjuar fjalën se kryeministri ynë qenka i shantazhuar. Kjo është thënë nga deputetë të caktuar me një fjalor patetik, naiv, fyes, manipulativ, denigrues, quani si të doni.

Ne ndalemi te kjo çështje. Nga kush qenka i shantazhuar kryeministri ynë? Këto mbeten, o qenka shantazhuar nga Bashkimi Evropian, o nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, sepse po t'i kthehemi retrospektivës, periudhës së luftës kur ky kryeministër e ka udhëhequr atë dhe në të gjitha ato procese, ishin Bashkimi Evropian dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës që na ndihmuan ta fitojmë luftën, ta fitojmë lirinë.

Edhe në proceset e mëtutjeshme ky kryeministër ishte përfaqësues i vendit tonë në të gjitha ato procese sikur në Vjenë e deri në përmbylljen e pavarësisë së Kosovës. Dhe natyrisht kjo ishte në një agjendë të përbashkët me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe me Bashkimin Evropian.

A janë Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimi Evropian ata që na ndihmojnë çdo ditë ne, në forcimin e shtetit tonë? Pikërisht, Bashkimi Evropian dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë ndërmjetësues dhe lehtësues edhe të bisedave që janë duke u bërë tani. Dhe kryeministri ynë nuk ka nevojë të shantazhohet tash, ai nuk është shantazhuar asnjëherë gjatë një gjithë procesit tonë për një dekadë të tërë në të cilën kemi kaluar periudha jashtëzakonisht delikate dhe të vështira.

Nuk ka nevojë të shantazhohet, sepse agjenda e Qeverisë së Kosovës e udhëhequr nga kryeministri ynë është një agjendë pothuajse e përbashkët me Bashkimin Evropian dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe synimi ynë është i qartë dhe i Qeverisë së Kosovës, dhe i popullit të Kosovës, integrimi i vendit tonë sa më shpejt në Bashkimin Evropian dhe në NATO.

Gjatë gjithë këtij procesi mund të them që ne e kemi ruajtur anën tonë ashtu siç duhet dhe rezultatet nuk kanë munguar gjatë gjithë këtij procesi.

Unë kisha kërkuar nga deputetët që të jenë më të kujdesshëm nga dezinformatat, mos të mundohen të manipulojnë opinionin se më po shihet që edhe të gjitha kartat po harxhohen rreth kësaj çështje.

Në gjithë këtë proces kundër nesh dihet qartë dhe arsyet dihen qartë, ka qenë Serbia, në të gjitha veprimet e mëdha që janë marrë për Kosovën, gjatë gjithë këtyre viteve, gjatë gjithë kësaj dekade Serbia ka mbajtur qëndrimin e saj kundër. Qëndrimi i institucioneve të Kosovës ka qenë i njëjtë me Bashkimin Evropian dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, por duhet ta themi qartë dhe haptas se gjatë gjithë këtyre zhvillimeve ne edhe në vendin tonë kemi pasur një subjekt i cili pothuaj se ndoshta në mënyrë krejt të rastësishme po gjithherë iu ka përputhur agjenda e tyre me atë të Serbisë, që kanë qenë kundër çdo veprimi që kanë marrë institucionet e Kosovës në të gjitha proceset që i kemi kaluar deri tani. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Albin Kurti.

ALBIN KURTI: Faleminderit, kryesues!
Deputetë të Kuvendit të Kosovës,
Thelbi kohor i ecursisë së këtij dialogu është e djeshmja, apo një ditë përpara.

Më 18 tetor të vitit 2012 u miratua Rezoluta e Kuvendit për kufizimin dhe disiplinimin e dialogut Kosovë-Serbi. Një ditë pas, u zhvillua pa paralajmërim takimi Thaçi-Daçiq. Ajo Rezolutë kaq e kishte afatin e përdorimit, një ditë të vetme për vetëm një përdorim.

Më 13 janar 2013, Kuvendi i Serbisë e miraton Platformën për bisedime me Thaçin. Një ditë më vonë, pra më 14 janar, Thaçi mbledh politikanë nga pozita dhe opozita dhe ua prezanton Platformën ku për herë të parë e shkruan “veriu” me “v” të madhe, shpreh mirëkuptim për mosnjohjen e pavarësisë së Kosovës nga Serbia, dhe strukturat ilegale e kriminale të Serbisë i quan veçse struktura të sigurisë për të cilat kërkon, sërish, veçse largimin e tyre.

Aty, pra në atë platformë, s’përmendet askund Kosova Lindore dhe, gjashtë ditë më vonë, heqja e lapidarit të UÇPMB-së në Preshevë, bëhet çështje teknike. Prania e opozitarëve u shfrytëzua nga Thaçi për ta legjitimuar atë platformë e cila gjithsesi po e konfirmonte shkeljen e Rezolutës së 18 tetorit.

Të mërkurën, më 27 mars 2013, pra dje, Thaçi raportoi para ambasadorëve të Quintit dhe vetëm sot, pra një ditë më vonë, erdhi në Kuvendin e Kosovës duke shpërfillur kështu karakterin parlamentar të Republikës sonë. Të tri këto raste e dëshmojnë se e djeshmja është thelbi kohor përgjatë këtij dialogu.

Dikur, konstruktiviteti dhe kreativiteti i zëvendëskryeminstres Edita Tahiri, Serbisë ia dha statusin e vendit kandidat për BE, kurse Kosovës, fusnotën.

Ndërkaq sot sjellja bashkëpunuese e Thaçit dhe normalizimi i marrëdhënieve të tij me Daçiqin, po ia jep Serbisë, datën e fillimit të negociatave për anëtarësim në BE, kurse Kosovës fondin zhvillimor për ndarjen e veriut dhe asociacionin e komunave me shumicë serbe.

Ashtu sikurse që IBM bënte që të harrohej barrikada e Serbisë në urën mbi Ibër në Mitrovicë, njësoj asociacioni i komunave me shumicë serbe e ka hedhur në plan të dytë fondin zhvillimor për veriun. Askush s’flet më për të, jo fond zhvillimor për veriun, por fond zhvillimor për Mitrovicën në kuadër të fondit zhvillimor për Kosovën. Kjo pra është ajo që i nevojitet Kosovës.

Mirëkuptimi ndërkombëtar dhe kosovar për mosnjohjen e pavarësisë së Kosovës nga Serbia, u materializua te pikat kaluese në vend se pikat kufitare te IBM-i, që më tej e shënjon kufirin tonë me Serbinë si administrativ e jo ndërkombëtar, me kopje të dokumentacionit kadastral e kopje të librave të amzës, me fond zhvillimor për veriun dhe asociacion të komunave me shumicë serbe, me tabela të UNMIK-ut për automjete edhe për pesë vjet rresht, me fusnotë që e risjell Rezolutën 1244 dhe na e konteston shtetësinë e të tjera, e të tjera.

Dhe, tash, këto janë bërë shkaqe shtesë për mosnjohjen e pavarësisë së Kosovës nga Serbia. Koncesionet ndaj Serbisë nuk janë arsye që ajo të na njoh, por që edhe më tutje të mos na njoh.

Dihet që Serbia i bën aq shumë obstrukcione Bosnjës që e njeh e lëre më Kosovës të cilën nuk do ta njohë as në të ardhmen e afërt, prandaj është absurde të mendohet se përmbyllet diçka më 2 prill.

Në anën tjetër po, sigurisht se kemi një proces përkeqësimi të vazhdueshëm të funksionimit dhe pozitës së Kosovës dhe ky përkeqësim assesi nuk po përfundon, pra as më 2 prill.

Procesi i dialogut politik në Bruksel është një proces në të cilin nuk përmenden koncesionet që tashmë janë bërë, por ato që duhet të bëhen së shpejti. Kjo tregon që ecuria e procesit dominohet nga kërkesat hegjemoniste të Serbisë.

Fondi zhvillimor për veriun ishte ofertë e Qeverisë së Kosovës nga Platforma e 14 janarit 2013, ndërkaq bashkësia e komunave me shumicë serbe, kërkesë e Serbisë nga Platforma e saj e 13 janarit të vitit 2013. Pas formimit të asociacionit të komunave me shumicë serbe, është lehtë e imagjinueshme se bashkëpunimi i EULEX-it do të jetë ndaras me serbët.

Porsa u pat vendosur korniza e dialogut Kosovë-Serbi, vetëm për çështjet e brendshme të Kosovës dhe pa kushte për Serbinë, Daçiqi kërkoi kompromis. Ndërkohë që dihet se nuk e ka ndërmend të na njohë pavarësinë e Kosovës. Kompromis ndërmjet Kosovës dhe Serbisë po kërkon edhe Bashkimi Evropian. Kjo kërkesë do të thotë që në këtë kontest e në këtë kontekst s'ka të pafajshëm, andaj është absurde që Serbia të kërkojë falje njëanshëm, e rrjedhimisht, s'do të na i paguajë as dëmet e luftës.

Thaçi dhe Daçiqi, të dy këta, po flasin për armiqësi njëshekullore që tash po merr fund. Me këtë logjikë, Kosova e paska okupuar Serbinë duke bërë agresion ndaj saj që tash duhet të kompensohet me fond zhvillimor për veriun dhe me asociacionin e komunave me shumicë serbe në Kosovë.

Gjithashtu, sot dëgjuam se Serbia nuk e ka lehtë me këtë dialog. Këto janë fjalët e kryeministrit të Kosovës, i cili del se nuk qenka atje për Kosovën, por për Serbinë, sepse asaj po ia qan hallin, qysh Serbia nuk e paska lehtë në këtë dialog. Më tej, ky kryeministër tha që Serbia, synon, Serbia kërkon, e kështu me radhë. Pra, ai ndodhet përbrenda vizionit të Serbisë, ku neve na flet për rezistencën e tij ndaj këtij vizioni, e cila ka realitet foljor kundrejt nesh dhe jo veprues kundrejt Serbisë.

Së fundi, kryeministri tha që s'ka presion mbi të në këtë dialog. Ky dialog është pa kushte për Serbinë dhe për çështje të brendshme të Kosovës. Qëllimi kryesor i dialogut është afrimi i Serbisë me Bashkimin Evropian. Pra, është dialog në interes të Serbisë.

Prandaj, deklarata e kryeministrit se ai nuk ka presion për këtë dialog i lë dy mundësi, ose ai është pro-serb dhe s'ka nevojë për presion, ose aq i madh është presioni mbi të sa që ai as nuk guxon të thotë se ka presion. Faleminderit.

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Sahatqija e ka fjalën.

TEUTA SAHATQIJA: Faleminderit, kryesues!

Mendoj që ky takim i fundit ka qenë i rëndësishëm duke pasur parasysh që bisedat apo do të jetë biseda përfundimtare me datën 2 prill, desha të them që takimi në Romë ka qenë i rëndësishëm, sidomos me zotin Biden dhe desha vetëm t'ia përkujtoj kryeministrin që këto takime nuk po ndodhin për herë të parë në Vatikan te Papa, por kemi qenë edhe përpara të ftuar, bile presidenti Ibrahim Rugova në 2005-ën na ka ftuar, kam qenë edhe unë e ftuar, edhe ju keni qenë të ftuar atëherë, por është mirë që tash në cilësinë tjetër po vazhdon.

Tjetër çka është e mirë, është e mirë që Serbia sot nuk është në pozitë që të vë kushte, duke pasur parasysh se ka një zgrip të kohës, para aprovimit të buxhetit 2014-2020 dhe që pret një shpërblim prej Bashkësisë Evropiane. Dhe lëshimi pe dhe kompromiset e dhembshme që i ka bërë Kosova, të gjithë këtu po pajtohemi që kanë mbaruar me përfundimin e dokumentit të Ahtisarit dhe duhet të jenë me Kushtetutën e Kosovës. Dhe asociacioni, edhe pse po flitet për kërkesat të cilat Serbia i ka paraqitur, mendoj që është mirë të vazhdojmë dhe t'i kemi vetëm ato kompetenca të cilat Kushtetuta i parasheh.

Për shëndetësinë, edukimin dhe tjerat, janë të pritshme që të transformohen, por për strukturat ilegale të sigurisë të cilat shteti i Serbisë po tenton që përmes asociacionit të futë më forcë, mendoj se duhet të mos merren parasysh.

Unë dëshiroj vetëm disa pyetje t'ua bëj, dëshiroj t'ju pyes që a do të jetë Forca e Sigurisë së Kosovës jashtë territorit të veriut, a ka kushtëzime për transformimin e FSK-së në ushtri të Kosovës edhe desha të pyes edhe për çështjen e pensioneve të papaguara nga Serbia, a do të ketë trajtim pasi prej zyrtarëve të Qeverisë tuaj po thuhet se edhe ajo do të jetë pjesë e debateve, e diskutimeve dhe duke pasur parasysh çka thatë deri sot po shihet që ajo nuk do të jetë në listë të çfarëdo bisedave, dhe qysh do të jetë përfundimi yt marrëveshjes, besoj që të gjithë kanë kërkuar që marrëveshja të jetë e shkruar dhe të jetë marrëveshje e ratifikuar ashtu qysh e kërkon edhe rezoluta. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti kryeministër e ka kërkuar fjalën. Zoti Thaçi, e keni fjalën.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Faleminderit shumë, i nderuari kryesues Haliti.

Unë edhe në fjalën time hyrëse prezantova pozicionin e Kosovës që e ka pasur në gjitha takimet, por që ka ardhur deri te takimi i shtatë, në mes të dy kryeministrave të shtetit të Kosovës dhe atij të Serbisë, pozicion ky plotësisht në përputhshmëri me Kushtetutën dhe ligjet e Republikës së Kosovës, në përputhshmëri me Ligjin për vetëqeverisjen lokale, me dokumentin e presidentit Ahtisari dhe standardet më të avancuara evropiane.

Pozicioni i Prishtinës në të njëjtën kohë është plotësisht, 100% në përputhshmëri edhe me qëndrimin e Bashkimit Evropian dhe të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe NATO-s. Prandaj, qëndrimi ynë kushtetues dhe ligjor mund të konkludoj se është edhe qëndrim i vullnetit të qytetarëve të Kosovës për ta respektuar Kushtetutën dhe ligjet, një Kushtetutë që është aprovuar prej përfaqësuesve të zgjedhur të qytetarëve të Kosovës. Ndërsa, ne këta miq, këta partnerë i kemi edhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Bashkimin Evropian dhe NATO-n. Pra, ky është pozicioni ynë shumë i qartë.

Sa i përket pyetjeve që u ngritën këtu më herët, disa nga këto përgjigje i dha zëvendëskryeministri Kuçi, edhe ministri i Jashtëm, Hoxhaj dhe diskutues të tjerë.

Unë e prezantova një kronologji të dhjetëditëshit të fundit për Kosovën që nga takimi zyrtar në ambientet e Ambasadës Amerikane në Romë, me zëvendëspresidentin Bajden dhe mbështetjen e tij të fuqishme dhe të Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Kosovën dhe për procesin e normalizimit të marrëdhënieve në mes shtetit të Kosovës dhe Serbisë, por edhe mesazhin e fuqishëm të zëvendëspresidentit amerikan Bajden se SHBA nuk akceptojnë as ndonjë pretendim për ndonjë zgjidhje që nuk është në vullnetin e qytetarëve të vendit dhe që mund ta dëmtojë shtetësinë e Kosovës.

Sa i përket Selisë së Shenjtë, Vatikanit, unë e çmoj shumë këtë vazhdimësi të bashkëpunimit të Kosovës me Selinë e Shenjtë, me Vatikanin, por dallimi është se kësaj radhe jemi ftuar si përfaqësues të shtetit të pavarur dhe sovran të Kosovës, e nderuara dhe e respektuara Sahatqija.

Unë e çmoj kontributin e secilit, edhe unë kam qenë përfaqësues dhe pjesëmarrës në delegacionet e ndryshme në Vatikan edhe para lufte, edhe gjatë luftës, edhe në periudhën e tranzicionit demokratik, por është ky një avancim në trajtimin e Kosovës nga Selia e Shenjtë, nga Vatikani e me shpresë në të ardhmen edhe njohja zyrtare. Dhe unë ju falënderoj edhe juve për punën tuaj personalisht dhe për kontributin tuaj edhe personalisht edhe pjesëmarrjen tuaj natyrisht në ato ceremoni që kanë qenë të organizuara në Vatikan dhe është mirë që shkojmë edhe në Vatikan, edhe në Jerusalem edhe në Stamboll, edhe në Mekë. Ne do të jemi aty ku do të flitet për Kosovën, duhet të jemi dhe duhet ta përfaqësojmë Kosovën. Ne nuk humbim nga prezantimi ynë. Ne kemi humbur gjithmonë kur s'kemi qenë aty, por ku është folur diçka për Kosovën, mirë është që kemi qenë. Kemi qenë edhe nëpër organizata të ndryshme politike të ideologjive të ndryshme, por çdo herë që është folur për Kosovën, kemi qenë edhe kah kanë qenë të djathtë, të majtë, të qendrës, liberale, edhe ju, edhe ne, edhe partitë tjera dhe kjo është mirë që po ndodh.

Edhe një herë e ritheksoj, dokumenti përfundimtar do të aprovohet në Kuvendin e Kosovës. Tash kur diskutohet 12 orë si delegacion edhe i Kosovës, edhe i Serbisë, me prezencën dhe udhëheqjen e baroneshës Eshton aty ke ide prej të ndryshmeve që i prezantova edhe më herët, por ato ide që mund të dalin aty nuk mund t'i sjellësh këtu për t'i diskutuar, elaboruar e pastaj të hyhet në një debat që është i pafund, prandaj më lehtë është si përfaqësues i votuar nga ky Kuvend, i ngarkuar nga ju për ta përfaqësuar Kosovën, ato kërkesa të refuzohen aty për atë dhe t'ua lehtësojë edhe juve punën.

Por në rast të një dokumenti zyrtar, atëherë natyrisht se ai dokument do të vijë këtu, por unë ju siguroj juve të nderuar deputetë dhe qytetarëve të Kosovës se asnjë dokument që është në kundërshtim me Kushtetutën dhe ligjet e Kosovës, nuk do t'ju vijë në këtë Kuvend. Do ta ndal unë para se të vijë këtu. Për këtë ju siguroj.

Unë ju falënderoj për debatin sot, të gjithë deputetët. Unë kam pasur kënaqësi këto ditë po të takohem me përfaqësuesit e Quintit, ambasadorët e Quintit, t'i informoj për gjithë procesin. Në të njëjtën kohë t'i informoj edhe ambasadorët e Bashkimit Evropian, ndërsa kërkesa ime për informatë ka qenë në të premtën e kaluar që iu ka drejtuar Kuvendit, nëse nuk gabohem, të premtën e kaluar dhe vetë Kryesia ka vendosur, Kryesia e Kuvendit që ky takim, kjo informatë, ky raport të ndodhë sot e enjte, ndërsa dje kam takuar edhe liderin e AAK-së zotin Haradinaj, të cilin e kam informuar dhe sot e kam informuar në mëngjes edhe kryetarin e LDK-së, zotin Mustafa dhe shefin e Grupit Parlamentar të LDK-së, zotin Beqiri.

I falënderoj për bashkëpunimin, për mirëkuptimin, edhe ata si liderë e po në të njëjtën kohë kam informuar edhe Partinë Demokratike të Kosovës, Kryesinë e Partisë Demokratike të Kosovës dhe i falënderoj të gjithë për mirëkuptimin për t'u informuar me kohë në mënyrë të rregullt dhe në të njëjtën kohë edhe për zotimin për të ecur bashkërisht në implementimin e kësaj agjende të përbashkët.

Prandaj, krejt në fund edhe një herë më lejoni t'ju falënderoj të gjithëve për mbështetje, për mirëkuptimin tuaj, ndërsa çdo shqetësim që është ngritur këtu të jeni të sigurt se do ta trajtoj në mënyrë më serioze dhe të përgjegjshme. Faleminderit shumë!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Ymeri e ka fjalën.

VISAR YMERY: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

I pamë këtu shumë prej deklaratave edhe të kryeministrit edhe të ministrave të ndryshëm të cilët folën për dialogun, për atë se çfarë po ndodh, çfarë kanë thënë, çka kanë kërkuar apo çka nuk e kanë ndërmend të pranojnë dhe po dua ta nis këtë fjalë timen me një gjë që e tha zoti Hoxhaj, pra në njërin prej replikave të tij ku për mendimin tim humbi shumë kohë në një tentim trajtimi letrar të fjalimeve të deputetëve. Tha që ne duam ta ndërtojmë një kulturë shprese, pra në Kosovë, apo jo. Pra, në njëfarë mënyre tha që nuk duhet të shpërndajmë kesi lloj pesimizmi, që sipas tij, po u shpërndaka përmes Kuvendit, në vërejtjen e deputetëve, por që duhet ta krijojmë një lloj shprese, pavarësisht pra fakteve dhe interpretimeve, herë më të sakta, herë më të pasakta që po i dëgjojmë në Kuvend të atyre dokumenteve të cilat po pranohen se janë dokumente valide, prapë na u fol për shpresën.

Dhe këtë dua ta vazhdoj pra unë me një filozof që ka folur për këtë çështje, është filozofi gjerman, Benjamini, pra Valter Benjamini, i cili thotë në një fjali, në njërin prej librave të tij që: "shpresa na është dhënë për shkak të të pashpresëve."

Pra në këtë kuptim të Benjamins për shpresën, shpresa është asgjë tjetër përveç mashtrim, ky lloj shprese, po flas. Kjo lloj shprese që donë ta ndërtojë zoti Hoxhaj, në këtë kontekst në të cilin po flasim, është një lloj mashtrimi që do ta krijojë pra për qytetarët e Kosovës, që të mos i dëgjojmë këto fjalime të cilat sipas tij po shpërndakan një lloj pesimizmi të panevojshëm te qytetarët e Kosovës, frikë e panik siç e quajti kryeministri, por të jetojmë në atë idilikën e shpresës të ndërtuar tashmë nga Qeveria, që çdo gjë është duke shkuar mirë.

Pra, në këto parakalime të kryeministrit dhe kryeministrave, zëvendëskryeministrave e kështu me radhë, të cilat i ngjanin për mendimin tim ose nga këndvështrimi im i ngjanin parakalimeve të manekineve në sfilata mode, pra i ngjanin e jo që ishin 100% të tilla, për shkak se këta edhe flisnin, ndërkohë që manekinet ne e dimë që bukurinë e shprehin vetëm përmes rrobave që i bartin, e panë që në fakt këta janë duke jetuar në një shpresë të tillë. Pra, një lloj mashtrimi të tillë të cilin po donë për ta shpërndarë pastaj te tjerët, apo jo.

Dhe, në këto parakalime të tyre, ata flisnin dhe shumë mirë që flisnin, mendoj unë se u paraqitja që më shumë përfaqësues të Qeverisë së Kosovës të shprehën për të njëjtën çështje, për shkak se pikërisht në këto shprehje të kryeministrit, zëvendëskryeministrave dhe të tjerëve, ne e vërejmë kontradiktën në ato që ata i thoshin.

Dhe mendoj që këtu është shumë e vërtetë shprehja që në fakt e vërteta është në kontradiktat, apo në tendencën e përmbylljes mbi përcaktimin e këtyre kontradiktave që i dëgjuam nga zëvendëskryeministri, kryeministri e tjerë, për shkak se e patëm kryeministrin në fjalën e tij hyrëse që tha që çdo gjë do të jetë në përputhje të plotë me dokumentet e Kosovës, apo jo, pra Kushtetutën dhe ligjet e Kosovës, ndërkohë që pastaj zëvendëskryeministri pas tij në fjalën hapëse tha që 90% është në përputhje me dokumentet e Kosovës, pra me Kushtetutën dhe ligjet tjera. Pra, një 10% po na mungon apo jo. E tash ky 10% pak a shumë, ne e dimë, cilat pika janë në këtë 10%, për shembull shkelje e Kushtetutës, ka qenë fusnota, apo jo, është shkelje e Kushtetutës për shkak se emërtimi kushtetues i Kosovës është Republika e Kosovës, ndërkohë që kjo Qeveri, ky kryeministër dhe të tjerët e kanë pranuar që Kosova të përfaqësohet me një emërtim tjetër, pra Kosovë me atë asteriksin, fusnotën në të cilën thuhet që edhe Rezoluta 1244 do të merret parasysh, edhe vendimi i GJND-së e kështu me radhë. Pra, kjo është shkelje e Kushtetutës, kjo qenka njëra prej tyre.

E dyta është fondi për veriun, apo jo. Pra, ideja dhe zotimi i kryeministrit që ta krijojë fondin e veriut është në kundërshtim me ligjet që i kemi ne sot në Kosovë të aplikueshme, pra Ligji për menaxhimin e financave publike i cili po ashtu çuditërisht për ta vazhduar atë që e përmendi zoti Gashi, është miratuar dhe ndryshimi dhe plotësimi i tij në Qeveri, siç e keni parë të gjithë, tash cilat janë ndryshimet nuk e di se s'e kam parë, po ligji tashmë është i ndryshuar në ditën e djeshme.

Tjetër, ligji për verifikimin ose për Agjencinë për Verifikimin e Pronës të cilën e kaloi ky Kuvend javën e kaluar apo seancën e kaluar, a nuk u vlerësua po ky ligj nga Komisioni për Legjislacion i Kuvendit të Republikës së Kosovës, që është në kundërshtim me

Kushtetutën dhe a nuk është ky ligj një rrjedhojë e drejtpërdrejtë e dialogut që quhej teknik dhe një marrëveshje për regjistrat civilë dhe për librat kadastralë të Kosovës që ka arritur Edita Tahiri, që është në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Pra këto janë shkelje të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, apo jo. Zotimi dhe pranimi që zgjedhjet në veri do t'i organizojë OSBE-a ku shumë qartë thuhet në Kushtetutë që KQZ-a e ka këtë të drejtë ekskluzive dhe përgjegjësi ekskluzive në Kosovë, është po ashtu shkelje apo dalje jashtë Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Pra këto shkelje i mbetet tash shfave dhe këtyre shelit të shfave të na tregojnë se a janë ky 10% apo kjo është gjysma e këtij 10% që nënkupton që do të ketë edhe 50% shkelje të reja të Kushtetutës, që mund të vijnë më 2 prill apo më 9 prill apo në prilla tjerë që po na afrohen.

U përmendën disa pika të kësaj marrëveshjes ose propozim- marrëveshjes e cila është publikuar në media dhe për të cilën përfundimisht pra e pamë edhe nga zëvendëskryeministri që qenka dokumenti që është ofruar palëve dhe në të cilin paska bërë Qeveria e Kosovës disa vërejtje, nuk dua tash të ndalem e t'i përsëris ato pika të cilat u përmendën nga shumë deputetë, nga zoti Hamiti, nga zoti Konjufca, nga zoti Hyseni e kështu me radhë, por dua të ndalem në një pikë që unë mendoj që është po ashtu shumë e rëndësishme, pra këtu thuhet në tërë tekstin e dokumentit njëfarë mënyre të krijohet përshtypja që asociacioni ose më saktë komunat do ta kenë të drejtën që t'i bartin kompetencat e veta që janë kompetenca ekzekutive apo jo në fusha të caktuara, do t'i barten në asociacion dhe njëkohësisht po na thuhet nga kryeministri që asociacioni nuk do të ketë kompetenca ekzekutive, po kjo bartje e kompetencave ekzekutive nga komunat në asociacion a nuk është kompetencë ekzekutive, pra a nuk do të jetë bashkim i kompetencave ekzekutive që i kanë komunat me shumicë serbe të decentralizuar me planin Ahtisarit tash që do të bashkohen dhe natyrisht do të fuqizohen në asociacionin e komunave me shumicë serbe? Pra, ky është ai centralizimi etnik i cili vjen si rrjedhojë e decentralizimit etnik për të cilin kemi folur edhe në seancën e kaluar.

Po ashtu thuhet këtu në një pikë, në pikën 5 pra që asociacioni - bashkësia do ta ketë kontrollin e përgjithshëm strategjik në fushat sikurse janë: zhvillimi ekonomik, arsimi, shëndetësia dhe çështjet tjera lokale. Pra, kontrolli strategjik, kjo natyrisht është pikë shumë e gjerë e edhe kontrolli strategjik si emërtim, por pastaj edhe zhvillimi ekonomik për shkak se zhvillim ekonomik mund të nënkuptojmë gati, gati thua se gjithçka. Çdo gjë është në funksion të zhvillimit ekonomik apo jo, pra hapja e ndërmarrjeve, menaxhimi i ndërmarrjeve, privatizimi i ndërmarrjeve, të gjitha këto fushën nën vistrën e asaj që quhet zhvillim ekonomik. Zhvillimi ekonomik është pastaj edhe kontrolli, edhe menaxhimi i resurseve të ujit apo jo, i pasurive nëntokësore, i zhvillimit të bujqësisë, i ndërtimit e çështje tjera, të gjitha këto e kanë konotacionin apo e kanë ndikimin në zhvillimin ekonomik dhe në këtë asociacioni do ta ketë kontrollin strategjik, pra në të gjitha këto fusha dhe ky kontroll strategjik do të jetë për të gjitha komunat apo jo.

Dhe çka është një çështje tjetër, një rrezik tjetër kur t'i bartin këto kompetenca të cilat u përmendën këtu edhe nga zoti Hamiti edhe nga tjerët që janë kompetenca asimetrike që i kanë komunat me shumicë karshi atyre të tjerave. Pra, kur këto barten në asociacionin dhe asociacioni merr vendime për një çështje të caktuar për sa i përket kompetencave

ekzekutive që i kanë komunat, që në raste të komunave me shumicë serbe, pra është edhe një lloj ndikimi i madh në vendimmarrjen, në emërimin e komandantëve të stacioneve policore, apo jo, të kuvendeve komunale të këtyre komunave.

Atëherë kjo do të nënkuptojë që në rast se asociacioni e merr një vendim duke u nisur nga kërkesa e njëres prej komunave, ta zëmë në këtë rast të Graçanicës, dhe pastaj ky bëhet vendim i asociacionit njëkohësisht kërkesë për institucionet qendrore të Kosovës, atëherë nëse institucionet qendrore të Kosovës ia refuzojnë këtë kërkesë të caktuar asociacionit, ky më nuk është problem që institucionet e Kosovës do ta kenë vetëm me Graçanicën si komunë, por me asociacionin të përbërë nga 10 komuna, pra këtu ky është ai bashkimi që e bën fuqinë, sepse pastaj rezistenca do të jetë e asociacionit, apo jo, që do të jetë rezistencë e secilës komunë veç e veç.

Ky është ai entiteti territorial që po krijohet, e tash ne mund ta gënjejmë veten dhe të themi që nuk e ka emrin e tillë, mbase edhe nuk e ka, po funksionimin do ta ketë të tillë, domosdoshmërisht do ta ketë të tillë për shkak se andej po shkon procesi.

Çështja tjetër, na u tha këtu nga kryeministri, nga zëvendëskryeministri që nuk ka pasur presion dhe nuk ka presion për dialogun, ndërkohë që ne të gjithë e dimë që kur është nisur ky dialog në secilën kritikë që e kemi pasur karshi tij, na është thënë që përveç tjerash kjo është edhe kërkesë nga ndërkombëtarët, apo jo. Tash kërkesë nga ndërkombëtar, trysni nga ndërkombëtarët kjo mund të jetë pak a shumë një çështje e cila ekuivalente me njëra-tjetrën, pra sinonime në këtë ligjërimin poetik të kryeministrit.

Dhe pyetja ime kishte me qenë, edhe pse nuk qenka këtu kryeministri, po ai edhe ashtu nuk po dëgjojke kur po flasim, kështu që s'ka rëndësi pse s'është, nëse nuk paska pasur trysni për dialogun, atëherë pse nisi ai, pse më herët na thoshte që as unë nuk dua të shkoj në dialog, por ja që po shkoj. Pra, le të nënkuptojë që dikush po i thotë shko në dialog, e tash po na thotë që nuk ka trysni nga ndërkombëtarët. Atëherë a paska qenë trysnia nga Serbia për të nisur dialogun, për shkak se e paska pranuar ky, apo nga dikush tjetër dhe nëse nuk është Serbia e as ndërkombëtarët, atëherë kush është...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Edhe një minutë ta përmbyll diskutimin!

VISAR YMERI: Pra, për t'u kthyer në fjalinë që e thashë në fillim, që shpresa që do ta ndërtojë Qeveria e Kosovës është mashtrim dhe shpresa e vetme e këtij populli për të shpëtuar nga kjo marrëveshje të cilën po ia zien ky kryeministër e cila prapë po them mund të vijë më 2 prill, po mund të vijë edhe më vonë, është populli. Pra shpresa e vetme e popullit është populli në këtë drejtim.

Dhe në këtë drejtim Lëvizja "Vetëvendosje," siç e dini besoj të gjithë, e ka thirrur një tubim protestues në Mitrovicë të shtunën në orën 13:00 në sheshin Mehë Uka dhe do t'ju kisha bërë ftesë të gjithë qytetarëve, por edhe juve deputetë të interesuar që të merni pjesë në këtë tubim për të treguar që në fakt populli i Kosovës nuk është dakord me këtë

dialog dhe me këto marrëveshje që po i arrin, që do t'i arrijë kryeministri i Kosovës. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Unë ju kisha ftuar të gjithëve që përfaqësoni institucione dhe çka do që kur ta bëjmë opozitën ta bëjmë karshi Qeverisë dhe jo karshi Kosovës. Nuk ka tjerë për të diskutuar dhe konsideroj që edhe kjo pikë e rendit të ditës me kaq përfundoi. Qeveria nuk do ta marrë fjalën më.

Atëherë të shkojmë në pauzë deri në orën 15:30 dhe ju kisha lutur që të ktheheni ta përfundojmë seancën, në të kundërtën, siç e dini, do të jemi të detyruar të vijmë të martën sërish në seancë. Faleminderit!

* * *

Vazhdimi i mbledhjes pasdite

Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Jakup Krasniqi.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
Vazhdojmë me pikën e pestë të rendit të ditës:

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për transplantimin e indeve dhe qelizave

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij në parim.

E ftoj ministrin e Shëndetësisë, zotin Ferid Agani, që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe arsyetojë projektligjin. Ministër, e ke fjalën!

MINISTRI FERID AGANI: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar zoti kryetar i Kuvendit,

Të nderuar deputetë,

Në kuadër të pakos së saj reformuese legjislativë, Ministria e Shëndetësisë e ka finalizuar hartimin e ligjit për transplantimin e indeve dhe qelizave, i cili është sot para jush për miratim.

Projektligji për transplantimin e indeve dhe qelizave e adreson nevojën për rregullimin e kësaj fushe në sistemin shëndetësor të Kosovës, që paraqet domosdoshmëri për ruajtjen dhe përmirësimin e shëndetit të pacientëve, ngritjen e cilësisë së jetës, uljen e kostos së shërbimeve shëndetësore, zvogëlimin e shkallës së invaliditetit, si dhe përmirësimin e aftësisë individuale për punë.

Edhe ky, sikur edhe ligji për transplantimi e organeve, është ligj i cili për herë të parë është përpiluar dhe miratohet në Kuvendin e Kosovës.

Fusha e transplantimit të indeve dhe qelizave ndërlidhet me strategjinë sektoriale 2010-2014 dhe planin e saj të veprimit dhe ka të bëjë me përmirësimin e gjendjes shëndetësore të popullatës dhe ngritjen e cilësisë së shërbimeve shëndetësore.

Po ashtu, kjo fushë është e ndërlidhur me dialogun në procesin e stabilizimit dhe asociimit, që ka rekomanduar adresimin e këtij problemi nëpërmjet direktivës së Bashkësisë Evropiane 2010/45 përkitazi me standardet e kualitetit dhe të sigurisë në transplantimin e indeve dhe qelizave njerëzore, si dhe është e ndërlidhur edhe me Raportin e Progresit 2011 për Kosovën, që si sfida për sektorin e shëndetësisë e ka identifikuar mosadoptimin e kornizës ligjore në fushën e transplantimeve.

Në ligjin bazik, Ligjin për shëndetësi, numër 04/2004, si dhe në ligjin e ri të miratuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës, numër 04/L-125, parashihet që transplantimi i qelizave dhe indeve të rregullohet me ligj të veçantë.

Aktualisht, nevoja për transplantime adresohet nëpërmjet udhëzimit administrativ numër 03/2010 për trajtim jashtë institucioneve publike shëndetësore dhe atë në institucione shëndetësore jashtë vendit, sepse sektori privat në vend nuk ka mundësi ta zhvillojë këtë lloj të shërbimeve për shkak të mungesës së bazës ligjore.

Të nderuar deputetë,

Projektligji për transplantimi e indeve dhe qelizave në 10 kapituj dhe me 53 nene rregullon në mënyrë të detajuar dhe përcakton qartë:

- shërbimet themelore të përfshira në veprimtarinë e transplantimit të indeve dhe qelizave;
- llojet e transplantimeve,
- kriteret dhe standardet e transplantimit,
- të drejtën e të qenët donator dhe mënyrën e procedimit të donacionit të indeve dhe të qelizave,
- aktivitetet lidhur me organizimin, menaxhimin dhe monitorimin e procesit të transplantimit,
- themelimin e regjistrave zyrtarë për transplantim,
- procedurat për marrjen, ruajtjen, deponimin, konservimin dhe distribuimin e transplanteve, si dhe
- organizimin e këmbimit ndërkombëtar të indeve dhe të qelizave në funksion të transplantimit.

Ndërkaq, rëndësi e veçantë në këtë projektligj i është dhënë monitorimit dhe inspektimit, llojeve dhe kualifikimeve të inspektorëve shëndetësorë, të cilët e mbikëqyrin zbatimin e këtij ligji, si dhe sanksioneve administrative dhe sanksioneve penale në rast të shkeljes së dispozitave të tij.

Me këtë projektligj themelohet sistemi nacional i transplantimit, i cili përfshin të gjitha organet shtetërore dhe institucionet shëndetësore që kryejnë aktivitete lidhur me

organizimin, menaxhimin dhe kontrollin e procesit të transplantimit, si dhe organet përkatëse në kompetenca qartë të definuara, që janë bartëse të këtij projektligji.

Po ashtu, themelohet qendra për koordinimin e transplantimeve, e cila menaxhohet nga udhëheqësi nacional i transplantimeve, pastaj banka e indeve dhe qelizave, e cila është strukturë shëndetësore, e licencuar nga Ministria e Shëndetësisë, si dhe themelohet komisioni etik mjekësor për transplantime të qelizave dhe të indeve, i cili i trajton çështjet e transplantimit të indeve dhe qelizave si strukturë që krijohet në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë.

Gjatë elaborimit të këtij projektligji janë konsultuar ekspertët ndërkombëtarë dhe vendorë, zyrat profesionale vendore dhe ndërkombëtare, si dhe të gjitha grupet e tjera që kanë shprehur interesim për ta dhënë kontributin e tyre.

Projektligji është në pajtim me standardet më të larta të Bashkësisë Evropiane, gjë që konfirmohet edhe me deklaratën e pajtueshmërisë së Projektligjit me standardet e BE-së.

Të nderuar deputetë,

Duke pasur parasysh atë që e thashë, si dhe faktin se ekziston nevoja urgjente për themelimin e kornizës së unifikuar ligjore, të mbështetur në direktivat e Bashkësisë Evropiane, që do të sigurojë standarde të larta të cilësisë dhe të sigurisë në fushën e transplantimit të indeve dhe qelizave, ju ftoj që ta mbështetni këtë projektligj. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, ministër! Kryetari i Komisionit Funkcional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, deputeti Fikrim Damka e ka fjalën.

FIKRIM DAMKA: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, në bazë të nenit 56, paragrafi 2, të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 13 mars 2013, e shqyrtoi në parim Projektligjin për transplantimin e indeve dhe qelizave.

Komisioni, pas shqyrtimit në parim, vlerësoi se projektligji i plotëson kushtet e parapara në nenin 54 të Rregullores së Kuvendit dhe ia rekomandon Kuvendit për miratim në parim.

KRYETARI: Faleminderit! Vazhdojmë me shefat e grupeve parlamentare. Në emër të Partisë Demokratike, deputetja Salihe Mustafa e ka fjalën.

SALIHE MUSTAFA: Faleminderit kryetar!

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e ka shqyrtuar Projektligjin për transplantimin e indeve dhe qelizave.

Mendojmë se më mirë do të ishte që ky projektligj dhe Projektligji për transplantimin e organeve të ishte një ligj i vetëm. Por, duke pasur parasysh faktin se sipas direktivës evropiane 2004/23 kërkohet që këto dy ligje të jenë të veçanta, ne i kemi analizuar që të dyja këto projektligje dhe mendojmë që këto dy projektligje duhet të harmonizohen në disa nene ndërmjet veti, si për shembull, te neni 11 i Projektligjit për transplantimin e indeve dhe qelizave, ku flitet për qendrën për koordinimin e transplantimeve, ndërsa në nenin 27 të Projektligjit për transplantimin e organeve flitet për qendrën shtetërore të transplantimeve të organeve të Kosovës.

Mendojmë se në Kosovë do të duhej të ishte një qendër dhe ajo do të ishte qendra shtetërore e transplantimit të organeve, ose kjo qendër t'i kishte dy njësi - qendrën për transplantim të indeve dhe qelizave dhe qendrën për transplantim të organeve.

Mandej, te përkufizimet, te neni 3, paragrafi 1.14, 1.15 dhe 1.16 të saktësohet se procedura e dhurimit të indeve dhe qelizave është vullnetare. Pra, te këta paragrafë fjalët “dhurim”, “dhurues”, “dhurues i gjallë” të thuhet “dhurues vullnetar”, sepse nëse nuk saktësohet lë mundësi të kuptohet ndryshe.

Gjithashtu te neni 44, të ceket se mbrojtja e të dhënave personale bëhet në pajtim me Ligjin për mbrojtjen e dhënave personale dhe Agjencisë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, kur dihet se në Kosovë kjo çështje është e rregulluar me ligj.

Mendojmë se këto vërejtje që i thamë janë vërejtje të cilat gjatë fazës së amendamentimit në Komisionin Funkcional mund të përmirësohen dhe ne si Grup Parlamentar do të angazhohemi maksimalisht që ky projektligj të harmonizohet edhe me Ligjin për transplantimin e organeve dhe në fund të jetë një ligj i zbatueshëm në praktikë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, deputetja Nazane Breca e ka fjalën.

NAZANE BRECA: Faleminderit!

I nderuari kryetar,

I nderuari ministër,

Të nderuar deputetë,

Grupi Parlamentar i LDK-së e ka shqyrtuar me kujdes Projektligjin për transplantimin e indeve dhe organeve. Mendojmë se ky projektligj është i rëndësishëm, sepse i rregullon procedurat në bazë të të cilave kryhet transplantimi i indeve dhe qelizave në fushën e mjekësisë për njerëz. Gjithashtu, edhe Raporti i Progresit 2011 për Kosovën e ka paraqitur si sfidë për sektorin e shëndetësisë mosadoptimin e kornizës ligjore në fushën e transplantimit të indeve dhe qelizave.

Ne mendojmë se ky projektligj është i rëndësishëm, në parim do ta miratojmë, por i kemi disa vërejtje, të cilat do t'i paraqes.

Së pari, në nenin 1, nuk është mirë i definuar qëllimi i projektligjit dhe bëhet një përzierje e qëllimit dhe fushës, të cilën e rregullon ky projektligj. Këto dy nocione nuk duhet të përzihen me njëra-tjetrën.

Gjithashtu, këtu përmenden edhe çështjet që nuk i rregullon ky projektligj, që është e panevojshme, sepse kjo nënkuptohet me automatizëm.

Në nenin 3, nuk është i përkufizuar qartë termi transplantim. Në pikat 1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.4 të këtij neni, termi transplantimi përkufizohet në mënyra të ndryshme dhe i jep kuptime të ndryshme.

Po në të njëjtin nen, në paragrafin 1.14, 1.15 dhe 1.16, duhet të ceket se dhurimi është vullnetar, sepse përndryshe mund të kuptohet se kjo mund të bëhet edhe pa vullnetin e palës.

Në paragrafin 1.17, duhet të bëhet përkufizimi shkencor për indin.

Paragrafi 1.38 duhet të koordinohet me paragrafin 1.13, sepse distribuimi e ka kuptimin e njëjtë me shpërndarjen, andaj duhet të përdoret njëra prej tyre, nuk ka nevojë të dyja.

Në nenin 3, gjithashtu nuk është dhënë përkufizimi për bankën e organeve, shprehje kjo që përmendet disa herë në projektligj.

Në nenin 11 të këtij projektligji përmendet qendra për koordinimin e transplantimeve, ndërsa në projektligjin për transplantimin e organeve në nenin 9 përmendet qendra shtetërore e transplantimeve. A do të thotë kjo se do të ekzistojnë dy qendra, një për organe, ndërsa tjetra vetëm për qeliza dhe inde, kur dihet se në vendet që kanë një eksperiencë të madhe në këtë drejtim ekziston një qendër e vetme, do të thotë për organe dhe për qeliza dhe në shumicën e vendeve është ashtu.

Gjithashtu, në këtë nen nuk është mirë e sqaruar struktura organizative dhe udhëheqëse e kësaj qendre, kështu që duhet pak më tepër të punohet në këtë drejtim.

Në nenin 24, paragrafi 1.2, përmendet afati i arsyeshëm për heqjen e indeve dhe qelizave nga personi i vdekur, por sa është ai afat i arsyeshëm nuk saktësohet.

Në nenin 44, mbrojtja e të dhënave personale duhet t'i referohet rregullativës ligjore përkatëse dhe akteve të tjera ligjore që dalin nga Agjencia për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Sikur në Projektligjin për transplantimin e organeve, neni 63, 64, 65 dhe 66 që duhet të fshihen, edhe këtu nenet 49, 50, 51 dhe 52 duhet të fshihen dhe veprimet që përmenden aty t'u lihen organeve kompetente të gjyqësisë që të merren me to.

Këto vërejtje dhe të tjerat që do t'i bëjmë me siguri që do të kontribuojmë që ky projektligj të amendamentohet dhe të përmirësohet në Komisionin Funkcional. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të “Vetëvendosjes”, shefi i Grupit, Visar Ymeri e ka fjalën.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” do ta përkrahë në parim këtë ligj. Shumë prej vërejtjeve u thanë, kështu që nuk dua t'u marr kohë deputetëve, dhe natyrisht vërejtjet do t'i shtrojmë edhe nëpërmjet Komisionit Funkcional. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Aleancës, deputetja Time Kadrijaj.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, kryetar!

Ky ligj i përcakton kushtet dhe rregullat për kryerjen e transplantimit të indeve dhe qelizave në fushën e mjekësisë për njerëz.

Me këtë ligj rregullohen procedurat në bazë të të cilave komisioni etik, bankat për inde dhe qeliza, institucionet shëndetësore, organet tjera dhe personat e autorizuar duhet të veprojnë në çështjet e transplantimit të indeve dhe qelizave.

Pasi problemi lidhur me mungesën e trajtimit mjekësor në fushën e transplantimit është evident, Raporti i Progresit 2011 për Kosovën e ka paraqitur si sfidë për sektorin e shëndetësisë mosadaptimin e kornizës ligjore në fushën e transplantimit të indeve dhe qelizave dhe Këshillit Ministror për Integrim Evropian e ka paraparë si objektiv për vitin 2012.

Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, duke e ditur rëndësinë e tij, e ka shqyrtuar këtë projektligj dhe do ta përkrahë në parim. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Koalicionit për Kosovë të Re, deputeti Gëzim Kelmendi e ka fjalën.

GËZIM KELMENDI: Faleminderit i nderuari kryetar!

Të nderuar ministra,

Kolegë të nderuar deputetë,

Ne si Koalicion për Kosovë të Re e përshëndetim punën e ministrit të Shëndetësisë sa i përket këtij projektligji. Si ky që ka të bëjë me transplantimin e indeve dhe qelizave, ashtu edhe projektligji i mëparshëm që kaloi në seancën paraprake për transplantim të organeve pa dyshim që paraqet një bazë ligjore për një punë, e cila do të bëhet në të ardhmen sa i përket aspektit të shëndetësisë kosovare, për faktin se si ky ligj, po ashtu edhe i kaluari, kanë qenë një bazë e polemikave dhe fatkeqësisht akuzave në vendin tonë, prandaj me fuqizimin e këtij ligji do të zgjidhen shumë dilema dhe njëherësh do të hapen shumë rrugë në shëndetësinë kosovare. Ky është një argument i gjallë, për faktin se Ministria e Shëndetësisë, konkretisht shëndetësia kosovare është duke ecur me hapa të sigurt në mënyrë graduale, përveç shërbimeve shëndetësore edhe në zbatimin dhe

zhvillimin e politikave të mirëfillta, që kanë të bëjë me standardizimin e shërbimeve shëndetësore në nivel të Bashkimit Evropian. Faleminderit!

KRYETARI: SLS-ja? S'ka. Nga "6+", nuk ka të lajmëruar. Atëherë pasi nuk ka deputetë të paraqitur, shkojmë në procedurën e votimit.

Konstatoj se të pranishëm janë 72 deputetë. Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Prania fizike 72 deputetë, prania me elektronikë 96.

Për kanë votuar 59 deputetë. Kartelat merrini me vete!

Konstatoj se Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për transplantimin e indeve dhe qelizave.

Ngarkohen komisionet funksionale dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportin me rekomandime.

Vazhdojmë me pikën e gjashtë të rendit të ditës:

6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ansamblin kombëtar të këngëve dhe valleve "Shota" dhe për ansamblët tjera

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për ansamblin kombëtar të këngëve dhe valleve "Shota" dhe për ansamblët tjera dhe Kuvendit ia kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

E ftoj kryetarin e Komisionit Funksional për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, deputetin Idriz Vehapi që ta marrë fjalën.

IDRIZ VEHAPI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

I nderuar zoti ministër,

Komisioni Funksional e ka shqyrtuar Projektligjin për ansamblin kombëtar të këngëve dhe valleve "Shota" dhe për ansamblët tjera. Po ashtu, këtë projektligj e kanë shqyrtuar edhe komisionet e përhershme.

Projektligji nuk ka marrë vërejtje, amendamentet e propozuara nga Komisioni Funksional nuk kanë marrë vërejtje nga komisionet e përhershme, prandaj lus deputetët që ta miratojnë projektligjin dhe amendamentet e propozuara. Faleminderit!

KRYETARI: Të paraqitur për diskutim nuk ka. Të pranishëm janë 71 deputetë. Vazhdojmë me votimin e amendamenteve.

Amendamenti 1.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 2.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 3.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 4.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 5.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 6.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 7.

Kundër nuk ka, abstenim nuk ka, miratohet.

Amendamenti 8.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 9.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 10.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 11.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Tani e votojmë tekstin në tërësi. Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim.
Votojmë tash!

Të pranishëm janë 73 deputetë, prania elektronike 96.

Për kanë votuar 56 deputetë, kundër nuk ka, abstenim nuk ka.

Konstatohet se Kuvendi e miratoi Ligjin për ansamblin kombëtar të këngëve dhe valleve
“Shota” dhe për ansamblet tjera.

Pika e shtatë e rendit të ditës:

7. Shqyrtimi Projektligjit për veprimtari kërkimore-shkencore, inovacione dhe teknologji

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për veprimtari kërkimore-shkencore, inovacione dhe teknologji dhe Kuvendit ia kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

E ftoj kryetarin e Komisionit Funksional për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, deputetin Idriz Vehapi që ta arsyetojë raportin me amendamentet.

IDRIZ VEHAPI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

I nderuar zoti ministër,

Po ashtu, edhe ky projektligj është shqyrtuar në Komisionin Funksional dhe në komisionet e përhershme.

Këtu dua të bëj me dije se Komisioni për Buxhet dhe Financa të amendamenti 5 ka propozim të veçantë dhe ne në komisionin tonë nuk kemi pasur mirëkuptim, shumica e deputetëve, për amendamentin e propozuar, ndërkaq unë si kryetar i komisionit dhe si deputet kam dhënë pëlqimin që të kalojë ai, sepse mendoj që është më mirë i parashtruar, por sido që të jetë, deputetët në këtë seancë le të vendosin se cili amendament do të kalojë dhe po ashtu i ka gjithsej 46 amendamente, prandaj lus deputetët që ta miratojnë Projektligjin me amendamentet e propozuara.

KRYETARI: Deputet, për cilin amendament e keni fjalën?

IDRIZ VEHAPI: Për amendamentin numër 5.

KRYETARI: Numër 5! Sabri Hamiti e ka fjalën.

SABRI HAMITI: Faleminderit, zoti kryetar i Kuvendit!

Ky ligj, me një rëndësi të jashtëzakonshme për zhvillimet e shkencës dhe kërkimet shkencore, mendoj se do të duhej të ishte i tillë, qoftë edhe me deklaratimet programore të Qeverisë, jo më pak se një herë, që thonë se kemi prioritete që ta bëjmë Kosovën vend të dijes.

E pra, ja e kemi shansin që ta kodifikojmë këtu në Kuvend dhe të krijojmë kushte që Kosova të pretendojë të bëhet vend ku sundon dija.

Unë e kam lexuar, dhe e mbaj mend edhe variantin e vjetër të këtij ligji, dhe këtë të riun, dhe me një kujdes e me një përgjegjësi të jashtëzakonshme për fushën që e mbulon dhe e rregullon, dhe unë kam parë se edhe Komisioni Funksional ka bërë përpjekje në fuqinë dhe rezonin e vet që ka pasur të bëjë ndryshime, të bëjë saktësime dhe bile mund të ju them një pjesë operative, a dy-tri pjesë të tëra të këtij ligji i ka anuluar nëpërmjet 3

amendamenteve në fund, që mendoj se është e arsyeshme, sepse ato janë punë që mund të rregullohen me akte më të vogla nënligjore për këtë.

Mirëpo, unë prita nga kryetari dhe anëtarët e komisionit se do të përgjigjen për një nen, që është neni 40, i cili është faktikisht amendamentim shtesë, që e propozon një institucion të ri në kuadrin e kërkimeve shkencore. Bile, me disa prej tyre kam bërë biseda dyshe për ta shpjeguar, e këta thanë që do ta shpjegojmë, por unë sa pashë nuk e bënë.

Dhe, pse e them këtë? E them, sepse as neni 5, që i ka dy variacione, prandaj edhe dola që tash, zoti kryetar, nuk mund të votohet në asnjërin variant përpara se të shpjegohet amendamenti 40.

E tash, kur jemi te amendamenti 40, është komisioni që e propozon një institucion të veçantë rreth kërkimeve shkencore, që do të quhej “Agjencia për Kërkime Shkencore”. Ky është një institucion krejt i ri, pra as që e ka propozuar Ministria. E kemi edhe ministrin këtu.

Ky institucion vetvetiu e ka një kosto buxhetore krejt tjetër. Në formulim është përpjekur dhe thuhet që do të ketë një buxhet të veçantë, do të jetë nën-buxhet, e tjera, e tjera. Megjithatë, kodifikimi nuk e sqaron problemin.

Çka dua të precizoj unë këtu edhe një herë. Dua të precizoj që tash, nëse kalon ky amendament dhe ky institucion, ne kemi brenda këtij ligji tri nivele institucionale që merren me kërkimet shkencore. Njëri është Këshilli Kombëtar i Shkencës, që propozohet nga Qeveria, zgjidhet nga Kuvendi, e keni nenin 49, dhe tutje, në faqen 45 të dokumentacionit.

Tutje? Ekziston edhe një Këshill Shkencor i Ministrisë, i cili gjendet në nenin 52, te dokumentet që i keni në dorë, faqe 47. Dhe, e keni propozimin e Këshillit ose Agjencisë për Kërkime Shkencore, i 3-ti, që është në nenin 40.

Tash, shikoni mirë, edhe ju të komisionit, edhe propozuesi i ligjit, edhe deputetët! Kur i lexoni detyrat e këtyre tri niveleve, janë të ngjashme. Veçse njërin e propozon Qeveria, e zgjedh Kuvendi - Këshillin Shtetëror, e tash është Këshilli Shkencor i Ministrisë, e zgjedh Qeveria, po detyrat në 3 nene janë të ngjashme, sikur edhe agjencia.

Unë po e përfundoj. Për pa u parë këto 3 nivele, pa u studiuar detyrat, nuk është mirë të propozohet edhe një agjenci, nëse Kuvendi mendon që Kosova ta ketë plus një agjenci për kërkime shkencore. Unë them që vetëm mund të indikohet në këtë se Kosova ka nevojë për një institucion të pavarur, që quhet agjenci për kërkime shkencore, porse të thuhet - i cili do të formohet me strukturë, me punë, me obligime, me bord - me një ligj të veçantë. Në këtë ligj bëhet konfuzion total, se për përshkrimet e detyrave që i jepen agjencisë dhe edhe një herë thotë edhe këtë agjenci e dublifikon, e triblifikon, e propozon Qeveria me një akt nënligjor. Kjo i bie që ne po kërkojmë institucione të ngjashme.

Nëse agjencia e propozuar duhet të jetë e pavarur, duhet të bëhet me një ligj të veçantë dhe më nuk është një organizëm udhëheqës në kuptimin e administratës - të administrimit, por duhet të bëhet atëherë agjenci kërkimore që e udhëheqin, e drejtojnë dhe e vlerësojnë vetëm profesionistët.

Jam përpjekur të jem shumë i qartë, e nëse kam qenë diku i paqartë, unë jam në gjendje përsëri të bisedoj, sepse letrat i kam në dorë, por e shoh të domosdoshme që sot t'i sqarojmë këto punë dhe të mos votojmë shpejt e shpejt, sepse ju garantoj që do të detyrohemi ta kthejmë shpejt pastaj këtë ligj, dhe të bëjmë plotësime tjera. Këtu është edhe ministri dhe besoj se do t'i sqarojmë këto tri nivele. Faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Ramë Vataj e ka fjalën.

RAMË VATAJ: Faleminderit, zoti kryetar!

Është e vërtetë që për këtë ligj kemi diskutuar shumë. Është me rëndësi të jashtëzakonshme për zhvillimin e shkencës, dhe unë ju garantoj që në vendet më të zhvilluara zhvillimi ekonomik i shtetit lidhet drejtpërdrejt me zhvillimin e shkencës.

Ne kemi menduar ta bëjmë një hap sado të vogël me këtë ligj. Është e vërtetë, ne i kemi edhe arsyet që diku 1/3 e ligjit e kemi kthyer, në të vërtetë e kemi anuluar, sepse ne kemi menduar që hulumtimi shkencor, ai që duhet të ofrohen kushte, ndërsa për inovacion e transfere të teknologjisë, i hap rrugë një ligji të ri, që do të jetë për patentime dhe për inovacione, sepse lidhen ngushtë.

Pra, ky është arsyetimi pse është hequr mbi gjysma, apo gati gjysma e ligjit, ku flitet për inovacione dhe transferin e teknologjisë.

Unë dua t'i arsyetoj amendamentet 5 dhe 40. Është e vërtetë se prej ministrisë ka ardhur, që një shumë e caktuar, domethënë për shkencë duhet të ndahen 07, ne e kemi lënë që duhet të jetë deri 07, pra që do të thotë se jo patjetër të ndahen 07, por që synohet të jetë 07, sepse në të gjitha vendet e zhvilluara në botë, edhe me direktiva të Komisionit Evropian, është që për shkencë ndahen 3% të GDP-së, pra të ardhura bruto vendore.

Pra, që të mos jemi qesharakë në këtë drejtim, ne megjithatë e kemi dhënë deri në 07, që do të thotë synojmë ta arrijmë këtë.

Pse themelimi i agjencisë është shumë me rëndësi, por kemi diskutuar me profesorin parafolës që themelimi i saj lidhet drejtpërdrejt me amendamentin 5 dhe me buxhetin, është i domosdoshëm. Në lexim të parë unë e kam bërë këtë vërejtje, që do ta bëjmë edhe këtë propozim, që është mirëpritur. Agjencia është institucion që komunikon me buxhetin evropian për hulumtime shkencore, që është në kuadër të rrjetit EPI seven, që i thonë, rrjetit të shtatë - Theimer program 7, pra kornizës së rrjetit 7, që i ka diku 60 miliardë buxhet vetëm për shkencë. Prandaj, i vetmi institucion që mund të kërkojë dhe të mbajë lidhje me buxhetin evropian për hulumtime është Agjencia Shtetërore për Hulumtime Shkencore, e jo as ministria, apo asnjë organ qeveritar.

Prandaj, themelimi i saj mund të jetë dhe ne kemi thënë që do të jetë e pavarur. A është prej Kuvendit, a është prej Qeverisë, a është prej Ministrisë, është në fakt e rëndësishme në krahasim me rolin që do ta ketë, e që do të jetë e pavarur.

Ndërsa, se a do të funksionojë me një ligj të ri, kjo nuk prish punë. Ne mund ta shtrojmë një amendament, ku thuhet roli i agjencisë, dhe mund të themi që funksionimi dhe puna e agjencisë do të rregullohet me ligj të ri, sepse nuk kemi këtu rast të veçantë, nuk kemi precedent, sepse në këtë ligj thuhet personat fizikë, neni 7, juridikë dhe fizikë, kërkimor-shkencor është Akademia e Shkencave, që përmendet në këtë ligj dhe funksionon me ligj të veçantë, përmendet Universiteti, që përmendet në këtë ligj dhe funksionon me ligj të veçantë, kështu që nuk prish fare punë t'i miratojë këto dy amendamente, 5 dhe 40, dhe të presim ta nxjerrim një ligj të ri për funksionimin e Agjencisë Shtetërore për Hulumtime Shkencore.

Pra, mund ta votojmë edhe amendamentin 5, edhe amendamentin 40, duke i bërë këto përmirësime, nuk ka asgjë që e detyron Qeverinë, sepse në momentin e fundit kur është punuar ligji unë nuk kam qenë këtu. Ndër tjera, ka qenë e propozuar që këto hyjnë në fuqi në vitin 2015, pra ka kohë për ta përgatitur edhe infrastrukturën, edhe për të ndarë buxhet, për të ndarë mjete për këtë institucion, që është themeluar për funksionimin edhe të institucioneve të arsimit të lartë, edhe të institucioneve shkencore.

Pra, nuk është asgjë detyruese që patjetër duhet të jenë 07, sepse, zoti ministër, ju e keni sjellë me 07. Ne kemi thënë deri në 07, e jo të ndahen mjete sipas nevojës, sepse ai do të thotë po të mos ketë vullnet ministri, nuk ndan fare, se sipas nevojës ka thënë.

Kështu që unë mendoj dhe i lus kolegët deputetë që të votohen dy amendamentet ashtu siç i ka dhënë grupi i Komisionit Funkcional, pra Komisioni për Arsim. Faleminderit!

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën.

MINISTRI RAMË BUJA: I nderuar, zoti kryetar!

I nderuar zoti kryeministër,

Zëvendëskryeministër,

Të nderuar deputetë,

Çështja e nenit të amendamentit 5 dhe amendamentit 40, ju e dini, komisioni faktikisht e di më mirë që Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në draftin që e ka ofruar për komisionin, nuk e ka propozuar agjencinë. Është propozim i komisionit dhe nuk e ka propozuar, jo pse nuk ka ditur ta propozojë, por për faktin që i kemi njohur mirë ose relativisht mirë kapacitetet tona se a mund ta bëjmë a s'mund ta bëjmë, sepse në fakt e dimë po kështu që të gjitha vendet që dinë çfarë është shkenca dhe dinë çka është hulumtimi, e kanë këtë mekanizëm dhe nuk e themi që është propozim i keq. Është propozim shumë i mirë.

Dilema jonë ka qenë që të mos e propozojmë sa për ta propozuar. Nga komisioni ka dalë, ne nuk mund të themi se s'e mbështetim, por nëse kjo gjë mbështetet, atëherë duhet të mbështetet me një perspektivë të ardhshme dhe me një ligj të veçantë, që precizon dhe

saktëson në të gjitha vendet e punës dhe të jetë gjithsesi institucion, jo për të bërë administratë, por për ta bërë vërtet atë që duhet bërë në aspektin profesional, shkencor dhe hulumtues.

Çështja e nenit 5.07 deri në 1.07 - Ne si Ministri kemi propozuar që të jetë 07, që ne na favorizon shumë në këtë fushë për faktin që ne nga buxheti marrim një 7 - 8 , apo 10 milionë.

(Ndërhyrje)

Faleminderit! 10 milionë. Por, me konsultat që i kemi bërë me Komisionin për Buxhet dhe Financa na ka dalë që është pak më ndryshe kjo punë dhe 10 milionë e kemi vështirë t'i harxhojmë me këto kapacitete që i kemi, për faktin që është zgjedhja si është, por arsyetimi i Komisionit për Buxhet dhe Financa ka qenë - ju lutem është mirë ta modifikojmë dhe ta arsyetojmë më mirë në amendamentin që e kanë propozuar ata që shkenca, hulumtimi, të bëhen kërkesat mbi projektet e caktuara për ta bërë këtë gjë, dhe kështu ka mbetur si amendament alternativ ai i Komisionit për Buxhet dhe Financa.

Andaj, po ju them se ne si Ministri do të favorizohemi shumë nëse bëhet një agjenci, nëse i kemi kapacitetet. Ju e thoni dhe unë e bëj punën time, atë që mund ta bëj për ta realizuar. Por, kjo do të jetë agjenci e pavarur, që vërtet do të ketë punë me agjencitë tjera simotra dhe natyrisht me Komisionin Evropian dhe me buxhetin e Bashkimit Evropian, që vërtet është mbi 60 milionë euro për këtë gjë.

Por, unë ju them që aktualisht kapacitetet tona janë të kufizuara për ta realizuar një mekanizëm të tillë. Faleminderit!

KRYETARI: Jo, dy herë s'ta jap fjalën. Ju lutem! Sqarim, urdhëro! Teuta Haxhiu e ka fjalën.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

Po ndalem pak te fjala e ministrit. Tha të gjitha vendet që e dinë çka është shkenca e kanë këtë agjenci. Pra, ministri po e pranon që nuk e di çka është shkenca. Pse nuk e di çka është shkenca? Me të vërtetë, në këtë projektligj kemi punuar me një angazhim maksimal dhe mund të them me një ekspert të fushës përkatëse dhe për mua është çudi shumë e madhe, e kemi edhe konstatimin e theksuar në Raportin e Progresit të vitit të kaluar, i cili thotë - Kosova nuk ka përparuar sa u përket investimeve në hulumtim. Pra, konstatim në Raportin e Progresit për Kosovën, Fondi për Shkencë mbetet i varfër edhe për vitin 2012. Dhe, në vitin 2013 ne kemi planifikuar, ne jo, por disa anëtarë dhe Komisioni për Buxhet dhe Financa zero cent.

Për çudi më të madhe, në takimin që e kemi pasur si Komision FunkSIONAL, bashkë me Komisionin për Buxhet dhe Financa, pas një diskutimi shumë të gjatë, kanë qenë shumë, të mos them anomali, po shumë çudi për mua. Propozimet që kanë dalë aty, një çudi shumë e madhe ka qenë, që as vetë ministri nuk e ka mbrojtur propozimin që e ka sjellë vetë. Pra, me një fjalë, ka heshtur gjatë gjithë kohës. Por, ka qenë edhe një propozim që

për të gjithë ata që dinë çka është shkenca, është anomali e llojit të vet. “Mjetet, sipas nevojës”, le të më thotë dikush cilat janë ato mjete sipas nevojës. Kjo do të thotë, të jesh as në qiell, as në tokë.

Të paktën, ne po kërkojmë, ne kemi kërkuar, zoti ministër, që ky buxhet do të jetë deri në 0.7. Kjo nuk do të thotë që është 0.7, mund të jetë edhe 0.1, edhe 0.2 por, le të dihet që edhe një cent të ndahet, të dihet sa është ajo vlerë.

Pra, konkretisht, edhe një herë po e them, që jemi kthyer prapë në komisionin tonë dhe aty me shumicën e votave është propozuar që të shkojë me 0.7. Prandaj, unë i lus të gjithë deputetët që të bëjmë një hap, të bëjmë diçka për shkencën. Ndoshta është kjo më e vogla që mund ta bëjmë, por derisa janë themeluar shumë e shumë agjenci, sa për ta punësuar dikë, ndonjë militant të partisë, më mirë është të themelohet një agjenci që do të punojë për shkencën.

Pra, edhe një herë i lus të gjithë deputetët që ta përkrahin amendamentin e Komisionit Funksional.

KRYETARI: Faleminderit! Vazhdojmë! Janë të paraqitur edhe 7 deputetë për diskutim. Shkojmë sipas radhës. Është mirë, realisht, disi t’ia lidhim kryet, e jo vetëm të flasim. Muhamet Mustafa e ka fjalën.

MUHAMET MUSTAFA: I nderuar kryetar i Kuvendit,
Edhe unë dëshiroj të them diçka lidhur me këto dy amendamente.

Sa i përket përqindjes së ndarjes, mendoj se edhe ajo që ka propozuar Komisioni Funksional, në fakt, është më pak e volitshme se sa kjo që e propozon Komisioni për Buxhet dhe Financa, sepse thotë ndahen deri në 0.7 të buxhetit, domethënë mund të ndahen edhe 0.1, kurse amendamenti i Komisionit për Buxhet dhe Financa e hap mundësinë që të ndahen sipas projekteve, sipas parashikimeve, të ndahen edhe më shumë.

Kështu që për mua është më adekuat amendamenti i Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe të ju them sinjerisht, po të na shohë dikush që ndahen deri në 0.7 gjithkund në Evropë të buxhetit, jo të GDP-së, por të buxhetit, deri në 0.7 ndahen... unë pak do të isha ndier i turpëruar.

Edhe pse, siç tha deputeti Vataj, domethënë vendet tjera evropiane investojnë në kërkime shkencore 3-4% të GDP-së. Prandaj, ne ndoshta për një kohë, për arsye se pajtohemi edhe me ministrin, ende nuk i kemi kapacitetet për të shfrytëzuar shumë mjete në kërkime, gjë që është katastrofale. Domethënë, kjo tregon për nivelin e institucioneve tona kërkimore dhe nivelin e “universiteteve” tona, që nuk janë në gjendje 500 mijë t’i shfrytëzojnë propozimet kualitative, ndoshta për 1 milion euro, sa për 2 milionë euro.

Kjo është ajo që tregon ku jemi. Mirëpo, unë, megjithatë, e kisha lënë që me strategjinë, me programin, me buxhetin, çdo vit të rritet dhe sa më shpejt të afrohemi bile me vendet

fqinje, sepse 0.7% e buxhetit në kërkime, kjo është turp të na shohë dikush, të jua them të drejtën.

Ne duhet të shkojmë shumë më shpejt, prandaj unë e kisha lënë këtë të Komisionit për Buxhet dhe Financa, por duke e përkrahur që patjetër të rritet, të rritet domethënë, e jo të na mbeten 1 milion a 2 milionë për kërkime. Është diçka që është e deklasuar krejtësisht.

Çështja e organeve - tash po shihet që propozimi i formimit të një agjencie me amendament, sado që mund të jetë i qëlluar, për mua është problematike, sepse krijimi i agjencive të pavarura duhet të bëhet me një elaborat, me një sistematizim të vendeve të punës, me një mënyrë të punës. Nuk duhet të krijojmë kaq lehtë, edhe pse unë pajtohem që të jetë një agjenci, por e kemi këshillin, siç e tha edhe profesor Hamiti, tri organe. Prandaj, të kemi kujdes pak çka jemi duke bërë me këto agjenci të pavarura. A do të mund t'i durojë Buxheti i Kosovës gjithë këto, edhe pse ndoshta restriktionet më të vogla ishte dashur në këtë rast t'i bëjë, por a na duhet edhe ministria me departamente dhe me këshillin e vet për shkencë, edhe këshilli kombëtar për shkencë, edhe agjencia?

Duhet t'i hulumtojmë, nuk them që ndoshta agjencia është më e mira prej krejt këtyre, por një spektër i tillë i organeve, që e ngarkon Buxhetin e Kosovës dhe i ngarkon shpenzimet. Duhet të jemi të kujdesshëm.

Prandaj, unë nuk do të isha ngutur me amendamente të tilla. Në qoftë se duhet, le të bëhet elaborati, le të bëhet analiza, le të reduktohet, le të shihet mandej në ministri, a ka nevojë ta kemi departamentin ashtu të organizuar, apo ndryshe kur të bëhet agjencia. Janë shumë gjëra të lidhura këtu. Prandaj, vetëm desha të tërheq vërejtjen për këto dy gjëra.

KRYETARI: Veç, nëse mund ta tërhiqni vërejtjen pak si më shkurt! Arsim Bajrami e ka fjalën.

ARSIM BAJRAMI: Faleminderit, kryetar!

Mendoj se esenciale në këtë ligj është që të definohen rolet e institucioneve, që janë përgjegjëse për fushën e shkencës, të evitohet ndonjë hipertrofi e organeve dhe institucioneve dhe të mos i kontribuojmë, nëpërmjet këtij ligji, rritjes së Administratës Publike.

U tha edhe në diskutimin e profesor Mustafës, po më duket edhe profesor Hamiti e ceku, duhet qartë të definohen rolet e këtyre tri institucioneve të nivelit shkencor, në fushën e shkencës. E kemi Këshillin Kombëtar të Shkencës, e kemi Këshillin për Shkencë në kuadër të Ministrisë dhe tani formimin e kësaj agjencie.

Agjencia kurrësi nuk duhet të kuptohet si strukturë administrative dhe me sa unë e kam përcjellë, me punë shkencore nuk merren agjencitë, por merren institutet shkencore. Në qoftë se shteti ka nevojë për themelimin e një institucioni të specializuar për hulumtime shkencore, atëherë ky do të jetë një institut i përbërë nga shkencëtarë, jo nga disa zyrtarë që ta rritin Administratën Publike. Dhe, formimi i një instituti të tillë është një çështje shumë e rëndësishme për Qeverinë.

Zakonisht, propozohet një elaborat dhe respektohen të gjitha procedurat e nevojshme për t'u arsyetuar edhe në pikëpamje buxhetore.

Nuk e di, ministri i Arsimit do të mund të na tregonte më mirë, por duke pasur parasysh angazhimin e Ministrisë në themelimin e disa universiteteve të reja, të cilat e kanë një kosto buxhetore, u tha këtu që kjo agjenci nuk do të fillojë menjëherë, por do të fillojë më 2015. Po, është shumë me rëndësi që të definohet koncepti i kësaj agjencie. Për mua, instituti për promovimin dhe zhvillimin e shkencës në Republikën e Kosovës, por gjithsesi nëse formohet një institut i tillë, atëherë të evitohet kolezioni i kompetencave me këta dy mekanizma, që veç janë paralele.

Me një hipertrofi të institucioneve ne nuk mund ta përparojmë shkencën. Mund ta përparojmë shkencën duke i përcaktuar përgjegjësitë konkrete të këtyre institucioneve dhe duke i promovuar politikat e Qeverisë në fushën e shkencës, nëpërmjet institucioneve përkatëse me kompetenca të precizuara.

KRYETARI: Sadri Ferati e ka fjalën.

SADRI FERATI: Faleminderit, kryetar!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë,

Unë do të flas shkurt. Vetëm do ta përcjell edhe një herë frymën që e ka udhëhequr komisioni, në bashkëpunim edhe me ekspertë, edhe me përfaqësues të ministrisë, në raport me këto dy amendamente.

Pra, tek amendamenti 40 është parë e arsyeshme dhe është elaboruar, dhe mua më vjen mirë. Unë i përshëndes kolegët që kanë dashur ta bëjnë një hap përtej projektligjit, propozim-ligjit që ne e kemi pasur, pra duke dhënë mbështetje që institucioni të jetë një institucion i veçantë, që do ta mbulojë këtë fushë dhe t'i krijohet atij autonomia e nevojshme.

Ne e kemi ditur se ekziston edhe një departament në kuadër të ministrisë, por edhe e dimë se ku është kjo fushë. Prandaj, krijimi i një institucioni që do ta ketë edhe pavarësinë dhe ku njerëzit në konkurrencë, njerëzit e shkencës do ta udhëheqin vetveten në kuadër edhe të konkurrenive, projekteve e bashkëpunimeve, unë mendoj se kjo është e dobishme.

Ndërsa, sa i përket amendamentit 5, është parë një rezistencë, një rezistencë në kuptimin nganjëherë edhe e shpjeguar me arsye nga Komisioni i Buxhetit dhe Financave. Prandaj, propozimi deri në 0.7% nuk e ka pas idenë që të mbetet zero, por nëse sot për sot, tani nuk kemi akoma institucion të fuqishëm, që do të mundte t'i përdorë përnjëherë 10 milionë, atëherë e kemi lënë mundësinë që brenda disa vjetësh të përgatitet, të fuqizohet ky institucion, që të fillojë ta përdorë pastaj 0.7-shin, ose edhe të bjerë amendamenti 5 dhe të figurojë amendamenti i propozuar nga ministria 0.7, është në rregull.

Tani unë nuk po dua të lidhem për 0.7, 0.6 ose 0.8, por ka një diçka. Ne jemi në kundërthënie edhe me vetveten në këtë pikë. Ne i kemi kushtet e sakta ligjore, se një

kandidat për doktoraturë duhet të ketë punime shkencore dhe të rangut të caktuar. Në anën tjetër, atyre njerëzve nuk u mundësojmë me asnjë minimum mbështetje që ata ta kenë atë nivel shkencor para se të kalojnë në gradë, por edhe vazhdimi i krijimtarisë shkencore tek ata profesionistë.

Prandaj, domethënë, kjo pjesë ose duhet të mbetet pra 0.7, por formulimet që sipas nevojës, unë mendoj, prapë lënë vend që ne të fillojmë pas disa vjetëve ta konstatojmë stagnimin momental që e kemi.

Prandaj, unë mendoj që edhe neni 40, edhe neni 5, e fuqizojnë punën kërkimore-shkencore. Faleminderit!

KRYETARI: Safete Hadërgjonaj e ka fjalën. Ju kisha lutur të jeni pak më konkretë, se mendoj që ka mjaft të paraqitur dhe po e shoh që debati i mirëfilltë nuk është bërë atje ku është dashur, në komisione.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuari zoti kryeministër,

Zëvendëskryeministër,

Ministër,

Të nderuar deputetë,

E ndiej për obligim ta jap mendimin dhe qëndrimin Komisionit për Buxhet dhe Financa, i cili i ka paraqitur edhe rekomandimet këtu.

Dhe, dua të them që Komisioni për Buxhet dhe Financa ka vërejtur që neni 5 i Projektligjit dhe neni 40, që përfshin amendamentet e Komisionit FunkSIONAL, përmbajnë implikime shtesë buxhetore.

Në këtë rast e kemi organizuar një takim të përbashkët me Komisionin FunkSIONAL, në mënyrë që t'i shqyrtojmë këto dy çështje dhe të arrijmë në përfundime të përbashkëta.

Dua t'i falënderoj anëtarët e Komisionit për Buxhet dhe Financa, sepse ndiej për obligim, sepse kur është çështja te qëndrueshmëria buxhetore kanë vlerësuar gjithmonë me profesionalizëm dhe me përgjegjësi. Prandaj, ndiej për obligim që t'i falënderoj në këtë drejtim.

Ne i kemi analizuar shumë me kujdes të dyja nenet, për të cilat bëhet fjalë, nenin dhe amendamentin e propozuar, dhe e kemi riformuluar amendamentin, të cili në fakt është miratuar nga të dyja komisionet, në takimin e përbashkët.

Neni 5, më tutje ka ndryshuar në Komisionin FunkSIONAL, pasi jemi dakorduar të dyja komisionet, që të shkojë varianti i Komisionit për Buxhet dhe Financa. Ne i kemi shprehur shqetësimet tona dhe kemi kërkuar që të rregullohet neni 40, meqenëse Komisioni FunkSIONAL nuk është pajtuar që të hiqet ai, sepse edhe për ne ka qenë e papranueshme, meqenëse do të ketë kosto shtesë buxhetore.

Mua më vjen keq që njerëzit e shkencës vlerësojnë pozitivisht, kurse njerëzit që fare nuk merren me shkencën, në fakt, nuk po dinë as çfarë po thonë, as çfarë po flasin. Komisioni ka vlerësuar se nuk është praktikë e mirë dhe nuk është në interes të ruajtjes së qëndrueshmërisë buxhetore përcaktimi i përqindjeve buxhetore për financimin e zbatimit të një ligji dhe propozoj që ky nen të riformulohet, në bazë të të cilit Qeveria e Kosovës duhet të sigurojë mjete të nevojshme, sipas projekteve apo programeve për financimin e veprimtarive kërkimore-shkencore, inovacione, për financimin e realizimit kombëtar të shkencës, si dhe meqë ka mbetur të funksionojë Agjencia Shtetërore për Kërkime Shkencore dhe për financimin e Këshillit Kombëtar.

Prandaj, Komisioni për Buxhet dhe Financa rekomandon që të miratohet amendamenti, të cilin e ka propozuar dhe e ka miratuar unanimisht Komisioni për Buxhet dhe Financa.

Unë jua them edhe një gjë. Nëse ne duam që t'i japim prioritet shkencës dhe duam t'i ndajmë 3% të GDP-së, pse të na bie në kundërshtim me ligjin, të cilin po e miratojmë. Prandaj, i kisha lutur të gjithë deputetët që ta miratojnë amendamentin, të cilin e ka propozuar Komisioni për Buxhet dhe Financa.

KRYETARI: Faleminderit! Dua t'i them edhe unë disa fjalë.

(Ndërprerje e shkurtër e incizimit)

Unë mendoj, po e them fjalën e fundit, të parën - që këtë ligj nuk duhet ta miratojmë sot, për faktin se ne i kemi dy mekanizma institucionalë që merren me çështje shkencore. Një në kuadër të ministrisë dhe një të miratuar, një këshill të miratuar për shkencë nga Kuvendi i Kosovës.

Dhe, konsideroj që për t'u miratuar ky ligj, pasi kemi dhe jemi duke i financuar këto dy institucione, një në kuadër të ministrisë dhe një që i përgjigjet Kuvendit, do të duhej ta bëjmë një studim. Vërtet, a kemi kapacitete që ne ta kemi një këshill apo një agjenci shkencore, kush janë ata shkencëtarë që do të merren dhe do të bëhen pjesë e kësaj agjencie, dhe cilat janë pastaj mundësitë e financimit dhe në cilat fusha vërtet kemi kapacitete që të investojmë për këto çështje?

Pasi ta kemi një studim të këtillë, ne vërtet do të duhej që ta miratojmë një ligj për ta krijuar një agjenci. Por, jo t'i kemi tre mekanizma, sepse, shikoni, unë e kam bindjen se kërkesa, kështu siç ka ardhur, nuk ka ardhur për të bërë shkencë, se të gjithë e dimë nivelin e shkencës. Pyetja e parë, që duhet ta bëjmë është: "A jemi në gjendje t'i shfrytëzojmë të arriturat shkencore?", dhe "A kemi njerëz që t'i shfrytëzojmë të arriturat shkencore?", e pastaj t'i hyjmë kësaj çështjeje.

Jemi të vetëdijshëm që duhet ta kemi një agjenci që merret me çështjet e hulumtimit, të inovacioneve, e tjera, e tjera... Por, kështu, krijimin e shumë mekanizmave, pothuajse me të njëjtën fushëveprim, unë e marr vetëm si mundësi për të punësuar njerëz dhe për ta krijuar një administratë që nuk i plotëson kushtet. S'kemi ne mundësi as ta financojmë.

Çdo agjenci, sido që të jetë e pavarur, i përgjigjet Parlamentit, apo në kuadër të ministrisë, ka nevojë ta ketë administratën. Pa administratë, absolutisht është punë që nuk bëhet. A duam të punësojmë njerëz të papunë, apo duam të merremi me shkencë? Unë mendoj që pa një studim të mirëfilltë, nga këta mekanizma që i kemi, dhe të na vijë një studim nga këta mekanizma që i kemi, ne po e miratojmë, përndryshe unë frikohem që i duplifikojmë institucionet për hulumtime shkencore dhe, në fakt, në vend se ta kemi një agjenci për hulumtime shkencore, ne i bëjmë tri dhe, në fakt, s'e kemi asnjë.

Prandaj, unë mendoj që nuk duhet krijuar. Nëse i kemi dy mekanizma, nuk duhet ta krijojmë të tretin dhe duhet ta përfillim rekomandimin ose amendamentin e Komisionit Funkcional. Dhe, pastaj, nëse vërtet duhet një agjenci e tillë, atëherë le të bëhet një studim dhe, mbi bazën e një studimi, ne ta kemi një raport dhe, mbi bazën e tij, ta bëjmë edhe një ligj të ri.

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, zoti Xhavit Haliti.)

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryesues!

Unë, pa dashur të ndaj mendim se cili është edhe opinionin dhe qëndrimi i vetë ndryshimit të këtij projektligji, apo edhe ideve të reja, që janë paraqitur nga Komisioni Funkcional, më lejoni të them se për mendimin tim ky ligj do të jetë i paimplementueshëm në praktikë.

Arsyet pse e them këtë, sepse ndryshimet, edhe përmbajtjesore, edhe konceptuale, që janë paraqitur e tregojnë këtë.

Nga 91 amendamente që i ka pasur projektligji, 40 janë fshirë tërësisht. 46 amendamente janë bërë. Është në kundërshtim edhe me Rregulloren e Kuvendit. Dhe, kjo nënkupton që edhe propozimet për amendamente, që duhet të jenë, nuk e përmbajnë edhe referimin ndaj dispozitës së projektligjit, edhe formulimin e saktë të amendamenteve, edhe arsyetimin e ndryshimit të propozuar.

Ne i kemi 40 nene që janë propozuar të fshihen dhe nuk është dhënë arsyetimi se përse ato duhet të fshihen.

E dyta, edhe për themelimin e kësaj agjencie është dashur ta kemi një arsyetim. E dëgjova profesorin Ramë Vataj, por nuk ishte i qartë, sipas Rregullores së Kuvendit dhe qëllimit, i cili ka ardhur në fillim nga vetë sponsoruesi.

Unë mendoj që ky ligj i ka dy rrugë tani, ose duhet të shkojë në lexim të tretë, ose duhet të tërhiqet nga sponsoruesi dhe të krijohet një ligj tërësisht i ri, me këto koncepte të paraqitura nga Komisioni Funkcional. Përndryshe, është në kundërshtim edhe me dispozitat, edhe me themelimin e organeve qendrore, dhe do të jetë i pazbatueshëm në praktikë.

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi.)

KRYETARI: Halit Krasniqi e ka fjalën.

HALIT KRASNIQI: Faleminderit, kryetar!

Në fillim kur u hap debati, nuk ishte në fokusin tim, që të merrja pjesë në diskutim. Gjatë trajtimit që iu bë tash materies dhe gjatë meditimimit tim që bëra me diskutimet, erdha në një konkluzion, të cilin nuk mund të mos e them tani, për të kontribuar në debat.

Mua më duket një ide e kristaltë. Qasjet nebuloze nga pak, që pak a shumë nuk mund të mbulohen, e bëjnë këtë koncept tani shumë të diskutueshëm, por arsyetimin që e dëgjuam nga paraqitësi më parë, nuk më lë të qetë pa thënë se kjo ide e begaton Qeverinë, i begaton institucionet tona. Mund të jetë me kosto buxhetore, por favore do t'i krijojë shoqërisë, zhvillime do t'i ofrojë shkencës dhe perspektivë njerëzve, që kanë ide dhe qasje shkencore dhe prirje shkencore.

Unë mendoj që duhet t'u jepet shans njerëzve, të cilët kanë prirje, vokacion dhe përkushtim shkencor. Institucioneve tona duhet t'u hapet mundësia që ta zhvillojnë e ta begatojnë shkencën më tutje.

Është një shans i shoqërisë sonë për emancipim dhe zhvillim shkencor dhe për emancipim të përgjithshëm. Unë mendoj që duhet të hidhet në votim dhe seanca ta thotë fjalën e vet, nëpërmjet votës. Faleminderit!

KRYETARI: Sabri Hamiti e ka fjalën.

SABRI HAMITI: Faleminderit, zoti kryetar!

Po, ajo që desha ta them, ajo faktikisht u tha, nëse bashkohet fjala juaj me të Armend Zemajt.

Edhe proceduralisht ka kaq shumë ndryshime, që është pak problem se si të krijohet teksti i pastër i votueshëm. Duhet ta shohim në kuadrin ligjor, domethënë në kuadrin e procedurave dhe të Rregullores, a mund të kalojnë kaq anulime nenesh, pa një shqyrtim.

Dhe, e dyta, edhe një herë po insisto, në rast se Kuvendi mendon që Kosovës i duhet agjencia për kërkime shkencore, unë votoj për të, veçse edhe një herë po them, nëse nuk është grup administrativ, po qendër e kërkimeve shkencore, ajo duhet të formohet me ligj. Dhe, nëse hyn këtu, duhet të thuhet: do të formohet agjencia për këtë, këtë, këtë... dhe kjo formohet me ligj të veçantë, përndryshe s'ka kuptim.

E puna e lartësisë së financimit, megjithatë, ne në dorë i kemi dy variante, një të njërit komision, një të tjetrit. Nëse të dyja komisionet bëhen në një fjalë, atëherë votohet mendimi i tyre karshi Qeverisë, se Qeveria ka ofruar tjetër gjë, komisionet tri variante. Faleminderit!

(Ndërprerje e shkurtër e incizimit)

KRYETARI: Ramë Vataj e ka fjalën.

RAMË VATAJ: Faleminderit, zoti kryetar!

Unë me keqardhje dua të them se prej të gjithë parafolësve, diskutuesve të mi, përveç profesor Sabri Hamitit, tjetër kurrkush s'ë ka kuptuar misionin e agjencisë.

Më vjen keq, edhe profesorë universitarë flasin dhe i përziejnë misionet. Duhet ta dini që Këshilli i Ministrisë është këshill profesional në ministri, nuk merret me shkencë. Këshilli Kombëtar i Shkencës është këshill në Qeveri, i cili e ka hartuar një program kombëtar të shkencës, që e keni miratuar ju në vitin 2010. Dhe, nëse thoni që nuk ka para, nuk nevojiten para se s'bëhet shkencë. Në programin kombëtar të shkencës i keni pasur të dhënat për vitin 2013. Janë dashur të ndahen 4 268 880 euro për vitin 2014, janë paraparë me atë program kombëtar të shkencës rreth 5 400 mijë euro.

Të gjitha janë të detajuara aty. Domethënë, është një program, një dokument obligativ për Qeverinë, se ju e keni miratuar programin kombëtar të shkencës, që atëherë e kemi punuar ne në ministri me Këshillin Kombëtar të Shkencës. Dhe, mos thoni që nuk ka shkencë e s'ka nevojë të ndahet, të ndahet sa ka nevojë.

Programi Kombëtar i Shkencës jep në detaje sa duhet të holla. Agjencia Shtetërore për Hulumtime Shkencore nuk merret me shkencë dhe mos e përzieni me agjencitë tjera, se nëse funksionon si në vendet tjera, duhen më së shumti 3-5 punëtorë.

(Ndërhyrje nga salla: Një agjenci, a?)

Po, në kuptimin, ajo i koordinon programet... Më vjen keq që ju s'merreni me shkencë. Agjencia Kombëtare e Shkencës është organ që i koordinon projektet ndërkombëtare me projektet e shkencëtarëve vendorë. Është një lloj sikur bankë, që i mban të hollat dhe një grup koordinues që është prej punëtorëve shkencorë, është bordi, që nuk është i punësuar në agjenci, do të jetë Bordi Shkencor i Agjencisë, që do të jetë prej Akademisë së Shkencave, Këshillit Kombëtar të Shkencës, Ministrisë së Arsimit, Ministrisë së Industrisë, të Shëndetësisë... të gjitha ministrive që kanë nevojë për shkencën e Kosovës.

Dhe, këto i ndajnë projektet shkencore në bazë një planifikimi që e bën agjencia. Agjencia duhet ta ketë vetëm një mirëmbajtës, që është administrativ, që i koordinon projektet shkencore, të shkencëtarëve dhe, siç thashë, në Komisionin Evropian, me programin kornizë, shtatëshe, është në Evropë. Komisioni Evropian nuk i jep asnjë institucion qeveritar të holla, është një agjenci që do të koordinohen dhe është veç një lloj qarkulluesi. Nuk merret me shkencë.

Prandaj, mos e bëni tragjike, se nuk jeni duke e kuptuar çfarë është kjo. Nuk kemi thënë që këtu duhet të jetë një agjenci, siç i kemi këtu. Aty koordinohen programet në bazë të një planifikimi, që ka programi kombëtar i shkencës, nxirren projektet, konkurrojnë shkencëtarët, ndahen projektet. Duhet t'i ndani, kurrkush nuk merret me shkencë, përveç Akademisë së Shkencave, që e kemi me këtë ligj, që po harroni. Me universitetet, institutet, nuk merret Agjencia Shtetërore për Hulumtime Shkencore, as nuk merret

Këshilli Kombëtar i Shkencës, se është organ këshillëdhënës, as Këshilli Shkencor i Ministrisë.

Prandaj, mos i merrni tragjike, se nuk është që do të jetë për punësim. Kjo është sikur e kanë vendet tjera në botë dhe, po më duket, nuk jeni duke e kuptuar çka është agjencia. Nuk do të jetë vend për të punësuar njerëz, vend për të koordinuar projekte shkencore me një buxhet, që e ndan Qeveria e Republikës së Kosovës, e në bazë të atij projekti hapen programet, hapen konkurset dhe njerëzit konkurrojnë, kur e dinë sa buxhet ka aty.

Pra, po më vjen keq... Deri tash ma mori mendja se s'e morët vesh çfarë është qëllimi i saj.

KRYETARI: Ministri e ka fjalën. Urdhëro, Idriz Vehapi e ka fjalën.

IDRIZ VEHAPI: Faleminderit, zoti kryetar!

Unë besoj që profesor Vataj dhe profesor Hamiti kanë dhënë sqarime të mjaftueshme. Unë veç dua të theksoj se kjo agjenci i duhet Kosovës.

Veç, si do ta rregullojmë, unë do të ju njoftoj juve se ne jemi komision funksional. Kemi kërkuar që agjencia të jetë krejt e pavarur, se edhe ashtu duhet të jetë. Por, në bashkëpunim me Komisionin për Buxhet e Financa jemi marrë vesh që për momentin, kjo agjenci të jetë në kuadër të Ministrisë së Arsimit dhe të mos jetë kod i veçantë buxhetor, po të jetë nënkod buxhetor për një periudhë transitore. Vetëm kaq!

KRYETARI: Ministri e ka fjalën.

MINISTRI RAMË BUJA: Unë ju falënderoj të gjithëve për diskutimet.

Ju vendosni për këtë çështje, se si do të bëhet ligji. Dhe, unë jam ekzekutuesi, por po ju them që debatet janë të mira, por nuk pati nevojë kaq shumë.

Unë po ju them që profesor Hamiti tha diçka, që mund ta kapërcejmë pa pasur nevojë të bëjmë shumë fjalë, për faktin se në këtë nen, në të vërtetë në amendamentin 40 specifikohet, që agjencia formohet me ligj të veçantë. Dhe, kur e sheh Kuvendi ta bëjë këtë ligj të veçantë dhe ta sqarojë se Rama, më falni të nderuar deputetë, po përpiqet ta sqarojë me fjalë, por ndryshe do të sqarohet me ligjin që do të bëhet për këtë agjenci të caktuar dhe kusht është kundër-agjencia, por të bëhet në mënyrë të mirëfilltë si duhet bërë.

Ndërsa, për amendamentin 5 dhe atë që e ka propozuar Komisioni për Buxhet dhe Financa të votohet këtu, kjo është e qartë. Nuk kemi pse debatojmë më gjatë. O njëra, o tjetra! Ju e keni analizuar besoj, si komision apo si komisione, dhe ne kemi propozuar atë që kemi propozuar, ju vendosni dhe ne e bëjmë ekzekutimin. Faleminderit!

(Ndërprerje e shkurtër e incizimit)

KRYETARI: Unë mendoj që duhet precizuar saktë nenin 40. Mund të jetë - të formohet agjencia e pavarur, por me ligj të veçantë dhe të gjitha ato tjerat të mos jenë aty.

A jeni dakord? Atëherë, shkojmë në votim. Të pranishëm janë 74 deputetë.

Amendamenti 1.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 2.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 3.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 4.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 5, i kemi dy propozime. Propozimin e Komisionit Funksional dhe propozimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa. Po shkojmë me votim elektronik.

Së pari e votojmë amendamentin e Komisionit Funksional. Regjia, votojmë tash!

Me 28 për, 38 kundër, një abstenim, nuk miratohet amendamenti 5.

E votojmë amendamentin e Komisionit për Buxhet dhe Financa! Votojmë tash!

(Ndërprerje e shkurtër e incizimit)

Atëherë, nuk votohet amendamenti 5 as i Komisionit Funksional, as i Komisionit për Buxhet dhe Financa. Mbetet teksti i propozuar nga Qeveria. Rezultati për këtë të dytin është:

Me 20 për, 43 kundër, dy abstenime, domethënë nuk kalon asnjëri amendament. Mbetet siç ka qenë ai i propozuesit.

Amendamenti 6.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 7.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 8.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 9.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 10.

Kundër? Një. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 11.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 12.

Kundër? Një. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 13.

Kundër? Një. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 14.

Kundër? Një. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 15.

Kundër? Një. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 16.

Kundër? Një. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 17.

Kundër? Një. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 18.

Kundër? Një. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 19.

Kundër? Një. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 20.

Kundër? Një. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 21.

Kundër? Një. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 22.

Kundër? Një. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 23.

Kundër? Një. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 24.

Kundër? Një. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 25.

Kundër? Një. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 26.

Kundër? Një. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 27.

Kundër? Një. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 28.

Kundër? Një. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 29.

Kundër? Një. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 30.

Kundër? Një. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 31.

Kundër? Një. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 32.

Kundër? Një. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 33.

Kundër? Një. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 34.

Kundër? Një. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 35.

Kundër? Një. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 36.

Kundër? Një. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 37.

Kundër? Një. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 38.

Kundër? Një. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 39.

Kundër? Një. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 40.

Agjencia Shtetërore për Kërkime Shkencore themelohet me ligj të veçantë. Ky është amendamenti, këto pjesët tjera shlyhen. Kush është për? Faleminderit! Kundër, a ka? Një. Miratohet amendamenti 40. Të pranishëm janë 87 deputetë.

Amendamenti 41.

Kundër? Një. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 42.

Kundër? Një. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 43.

Kundër? Një. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 44.

Kundër? Një. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 45.

Kundër? Një. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 46.

Kundër? Një. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Tani e votojmë ligjin në tërësi. Të pranishëm janë 87 deputetë. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Konstatohet se me 73 vota për, një kundër dhe 2 abstenime, Kuvendi miratoi Ligjin për veprimtari kërkimore dhe shkencore.

Vazhdojmë me pikën tetë të rendit të ditës:

8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për sigurinë e përgjithshme të produkteve

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për sigurinë e përgjithshme të produkteve dhe Kuvendit ia kanë rekomanduar miratimin me amendamentet e propozuara.

E ftoj kryetarin e Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, Zenun Pajaziti, që ta arsyetojë raportin me rekomandime.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, kryetar!

Kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, në disa mbledhje të veta të mbajtura radhazi e ka trajtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për sigurinë e përgjithshme të produkteve. Konsiderohet se është një ligj i mirë, që siguron që produktet tona të jenë më të sigurta në treg. Prandaj, e ka miratuar dhe njëherësh e ka sjell këtë raport për aprovim në seancë plenare në Kuvend. Faleminderit!
KRYETARI: Faleminderit! Shkojmë në amendamente.

Amendamenti 1.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 2.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 3.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 4.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 5.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 6.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 7.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 8.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 9.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 10.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 11.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 12.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Dhe tani e votojmë ligjin në tërësi. Të pranishëm 70 deputetë. Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Konstatoj se me 64 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, Kuvendi e miratoi Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për sigurinë e përgjithshme të produkteve.

Vazhdojmë me pikën e nëntë të rendit të ditës:

9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për minierat dhe mineralet

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për minierat dhe mineralet dhe Kuvendit ia kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

E ftoj kryetarin e Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, Zenun Pajaziti, që ta arsyetojë raportin me rekomandime.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, kryetar!

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, një ndër projektligjet që e ka trajtuar ndoshta në kohëzgjatje më së shumti është ky. Duhet theksohet se ka qenë nismë e vetë Kuvendit, e Komisionit, për plotësimin dhe ndryshimin e këtij projektligji me dakordimin po ashtu të Qeverisë. Në ndërkohë, kemi pasur edhe shumë punë, shumë mbështetje edhe nga institucione të ndryshme, edhe nga palët e interesuara, Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale e të tjerë. Rrjedhimisht, Komisioni ka arritur në fazën finale, e kemi nxjerrë para jush një dokument, një projektligj i cili konsiderojmë që i bën mirë kësaj fushe, aq më tepër në disa sfera, në disa pika, në të cilat nuk ka qenë mirë i rregulluar deri më tash.

Më lejon të shpjegoj që në një prej amendamenteve, amendamenti 11 i ka dy propozime të anëtarëve të Komisionit, të cilat nuk kanë kaluar në Komisionin Funkcional. Ndërsa ka qenë edhe një çështje që është mjaft delikate, e për të cilën Qeveria e ka pasur propozimin e vet, në ndërkohë që në Komision ka shkuar një propozim tjetër. Në momentin e fundit, ose në fazën e fundit, Qeveria, përkatësisht Ministria e Zhvillimit Ekonomik e ka pasur një propozim të veçantë me shkrim për ndryshimin e dy amendamenteve dhe rrjedhimisht ka kërkuar që projektligji të mbetet në versionin siç ka qenë. Është fjala për shfrytëzimin në masë të vogël, ose për shfrytëzimin privat të mineraleve. Unë kisha kërkuar, zoti kryetar, meqenëse ministri është këtu, ta sqarojë këtë propozim në mënyrë që eventualisht sot, meqë po votojmë, ta votojmë versionin më të mirë. Pra, kërkoj nga vetë ministri që këtu para nesh ta sqarojë edhe një herë për çka është fjala, meqenëse Komisioni nuk ka pasur vullnet, nuk e ka miratuar propozimin e tillë të Qeverisë. Faleminderit!

KRYETARI: Ministër, veç shkurt mundësisht, se Komisioni është dashur ta ftojë ministrin edhe atje ta rregullojë.

MINISTRI BESIM BEQAJ: Faleminderit, kryetar!

I nderuar kryeministër,

Zëvendëskryeministër,

Unë dua ta falënderoj Komisionin për punën e bërë, sepse me të vërtetë e ka bërë një ligj jashtëzakonisht të mirë. Ajo çka ne i kemi sugjeruar Komisionit si ministri përgjegjëse për krijimin e këtyre politikave është që amendamenti 10 të ndryshohet dhe realisht neni 14 të fshihet në tërësi, të mbetet sipas ligjit bazik.

Ndërsa amendamenti 30, gjithashtu, të ndryshohet, duke e fshirë nenin 31 në tërësi. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Vazhdojmë. Ju njoftoj se për këtë Projektligj janë propozuar 40 amendamente. Për amendamentin numër 11, kur të arrijmë, i kemi dy propozime: propozimin e deputetit Lutfi Zharku, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONal, dhe propozimin e deputetit Visar Ymeri, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONal.

Të pranishëm janë 76 deputetë.

Amendamenti 1.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 2.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 3.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 4.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 5.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 6.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 7.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 8.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 9.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 10.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Në amendamentin 10 nuk e kam asnjë propozim këtu. Në rregull, shpjegoje edhe një herë.

MINISTRI BESIM BEQAJ: Faleminderit, kryetar!

Te amendamenti 10, propozimi të cilin Qeveria e ka dërguar edhe në Komision, i cili është diskutuar, por nuk ka kaluar, propozimi ynë është që amendamenti 10, të hiqet komplet neni 14, pra të fshihet dhe të mbetet sipas ligjit bazik. Ky është amendamenti i kërkuar nga Qeveria, sepse konsiderojmë që e pasuron ligjin dhe ju jep mundësi shumë më të mira investimeve në aspektin afatgjatë dhe ruajtjes së mineraleve natyrore, si pasuri shtetërore e Republikës së Kosovës.

Njëkohësisht, neni 30, amendamenti i propozuar nga Qeveria, është që amendamenti 30 të ndryshohet dhe të fshihet, ku realisht fshihet neni 31 dhe hiqet komplet si i tillë. Mbetet sipas ligjit bazik. Pra, 10-shi dhe 30-shi fshihen, 10 fshihet, neni 14 në tërësi. Faleminderit!

KRYETARI: Nga Komisioni, Zenun Pajaziti e ka fjalën.

ZENUN PAJAZITI: Zoti kryetar!

Propozoj që të hidhet në votim propozimi i Qeverisë dhe propozimi i Komisionit siç është.

KRYETARI: Atë të Komisionit një herë e votuam, veç nëse e votojmë edhe një herë.

ZENUN PAJAZITI: Jo, jo, nuk kemi votuar. Të hidhen në votim të dyja propozimet.

KRYETARI: Mirë, shkojmë me elektronikë. Ai e ka kërkuar për të 11-tin dhe për 10-tin. Urdhëro, Visar Ymeri e ka fjalën.

VISAR YMERI: Siç e përmendi edhe ministri, e tash zoti Pajaziti po flet në cilësinë e kryetarit të Komisionit, por pa mbështetjen e tij në fakt, se Komisioni e ka dhënë fjalën e vet, pra Komisioni ka vendosur që të mos kalojë amendamenti i kërkuar nga Qeveria, që është e vërtetë se është kërkuar prej grupit punues. Pra, ky amendamentim. Disa herë e kemi diskutuar në Komision dhe në fakt ky rregullim i tillë i kësaj çështjeje ka ardhur, jo si kërkesë e Komisionit, por e Komisionit të Pavarur për Miniera e Minerale. Ata kanë bërë kërkesë që të rregullohet kjo çështje me ligj dhe këtu është fjala për shfrytëzimin në sasi të vogla të thëngjillit për amvisëri, gjë që është duke ndodhur e parregulluar aktualisht dhe KPMM-ja ka kërkuar nga Komisioni që ta gjejë një mënyrë të përbashkët që ta rregullojë këtë çështje dhe njëfarë mënyrë t'i legalizojë këta shfrytëzues të mineraleve energjetike, e ky ka qenë ai rregullimi, për të cilin jemi marrë vesh në Komision. Bile, sa më kujtohet mua, kjo çështje është votuar dy herë, edhe propozimi i Qeverisë dhe në mbledhjen e fundit të Komisionit ka ardhur prapë propozimi i Qeverisë, të cilin me shumicë votash Komisioni e ka hedhë poshtë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Shkojmë në votim. Komente, mirë. Kush po do komente? Ardian Gjini e ka fjalën.

ARDIAN GJINI: Zoti kryetar!

Kur duam të votojmë, e dimë cila është rregulla në Kuvend. Kur kërkohet fjala, duhet të jepet fjala. Nuk bëhet nami, prandaj nuk e di pse duhet t'i komplikojmë temat kështu. Është propozimi i Komisionit dhe vetëm propozimi i Komisionit hidhet në votim. Nuk hidhen dy propozime në votim. Nëse njëri nuk kalon, kalon ai tjetri. Është tepër e saktë kjo punë. Komisioni ka propozuar të kalojë ky amendament, ndërsa sot Qeveria propozon publikisht të mos kalojë. Është tepër e qartë. Nuk e di pse duhet dhënë njëfarë note, të mos dijë kush çfarë po voton. Faleminderit!

KRYETARI: E votojmë amendamentin 10 me elektronikë. Deputetë, përgatituni për votim.

(Reagime)

Këtu e kemi vetëm amendamentin e Komisionit. Nëse nuk kalon amendamenti i Komisionit, mbetet i Qeverisë. Kjo është e qartë. Ne e votojmë amendamentin 10 të Komisionit Funksional. Votojmë tash!

Me 29 vota për, 41 kundër, nuk kalon amendamenti 10. Mbetet si ka qenë i propozuar.

Amendamenti 11.

I kemi dy propozime. Propozimi i parë është i deputetit Lutfi Zharku, pa përkrahjen e Komisionit Funksional. Votojmë tash!

(Reagime)

Jo, qysh s'kanë votuar? Unë i kam përpara për t'i lexuar. Ishalla deputetët i kanë lexuar. Për arsyetim, Lutfi Zharku. Mirë, domethënë Teuta e zëvendëson Lutfi Zharkun.

TEUTA SAHATQIJA; Faleminderit, kryetar!

Mendoj që është e rëndësishme që të shpjegohet ky amendament, pasi do të votohet.

Propozimi që ka ardhur prej Qeverisë ka të bëjë me nenin 18.7, në të cilin thuhet që Qeveria vendos cili është investim i konsiderueshëm dhe kjo bën që Qeveria ta zgjedhë kompaninë dhe i tejkalon të gjitha procedurat e rregullta.

Ndërsa, pas kësaj kërkon që Kuvendi me vota ta japë licencën, pra një votim politik, që për ne është i papranueshëm. Dhe ky nen kundërshtohet edhe nga Banka Botërore. Licenca duhet të japë KPMM-ja, që e ka për detyrë, e jo Kuvendi me votim ta arsyetojë e t'i japë leje ndonjë kompanie që e ka përzgjedhur Qeveria.

Prandaj, Kuvendi nuk duhet të përzihet në kompetenca, por ta ruajë pavarësinë e këtij trupi të pavarur. Pra, kërkojmë që të votohet amendamenti numër 11 i deputetit Lutfi Zharku dhe të evitohet ky problem. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Amendamentin do ta arsyetojë edhe deputeti Visar Ymeri.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar!

Ka të bëjë me të njëjtën çështje, po unë, dorën në zemër, e kam kuptuar ndryshe nenin, e jo siç e shpjegoi zonja Sahatqija. Këtu flitet për një përjashtim apo suspendim të procedurave të konkurrencës për mineralet energjetike, që e ka propozuar Qeveria si ndryshim-plotësim për Ligjin për miniera dhe minerale, ku fillimisht, në propozimin origjinal të Qeverisë ka qenë që ajo ka të drejtë të marrë vendim në rast se kjo është në përputhje, siç thuhet këtu, pra për të siguruar sigurinë e furnizimit energjetik, ose tërheqjen e investimeve të konsiderueshme direkte dhe këtë vendim pastaj Qeveria në njëfarë mënyre të merret vesh, ta zëmë, me një kompani serioze për këtë çështje dhe drejtpërdrejt t'ia japë të drejtën e shfrytëzimit të mineraleve kësaj kompanie, me kusht që ajo t'i përmbushë kërkesat, kriteret e KPMM-së për marrjen e licencës.

Këtu, pra, i kemi dy propozime dhe të dyja propozimet janë të ndryshme në atë se kush duhet ta marrë vendimin përfundimtar. Grupi punues e ka modifikuar propozimin origjinal të Qeverisë dhe e ka futur këtu edhe Kuvendin që ta marrë vendimin përfundimtar karshi këtij vendimi të Qeverisë. Pra, një vendim i Qeverisë duhet të vijë në Kuvend dhe të miratohet.

Dhe, pastaj dy propozime i kemi në këtë nen: propozimi i zotit Zharku është që të hiqet Kuvendi, pra që vendimin për këtë investim të caktuar të mos e marrë Kuvendi, ndërkohë që propozimi im është plotësisht i kundërt - është që Kuvendi ta marrë këtë vendim, jo me shumicë të thjeshtë, por me 2/3. Tash unë po e arsyetoj pse kam menduar kështu.

Pra, janë dy ndryshime që ia kam bërë këtij neni të projektligjit për plotësim-ndryshim. Ndryshimi i parë është se e kam hequr fjalën ose tërheqjen e investimeve të konsiderueshme direkte, meqenëse është një term shumë i gjerë dhe lë shumë për të kuptuar aty çka nënkuptojmë me investime të konsiderueshme direkte, çka është ajo - është 10 milionë, 15 milionë, 20 milionë, 5 milionë, 2 milionë, dhe ndryshimi i dytë që e përmenda është që Kuvendi kur ta marrë vendimin, ta marrë të me 2/3, meqenëse këtu po flasim për njërin prej resurseve më të rëndësishme strategjike që e ka Kosova, e që janë mineralet energjetike, pra thëngjilli. Atëherë në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe në përputhje me logjikën e një kontrolli më demokratik karshi këtyre resurseve, që merret me Kushtetutë, konsiderohen të jenë resurse që i gëzon populli i Kosovës. Kam menduar që më e mira në këtë mes do të kishte qenë që Kuvendi ta marrë këtë vendim, jo me shumicë të thjeshtë, por me 2/3, meqenëse po flasim për një çështje që ka rëndësi për interesin e përgjithshëm strategjik të Kosovës, qoftë në ekonomi, por edhe në aspektin e kontrollit politik.

Arsyeja e dytë pse mendoj që duhet të bëhet kjo është kontrolli demokratik përmbi këto resurse, domethënë që ka të bëjë me kufizimin e mundësisë që Qeveria e Kosovës, duke qenë se është Ekzekutiv, pra jo vetëm kjo qeveri, por cilado qoftë ajo, të mos e ketë aq të lehtë të hyjë në marrëveshje kontraktuale me njërin prej investitorëve për t'ia dhënë në shfrytëzim afatgjatë resurset energjetike apo mineralet energjetike që i ka Kosova.

Dhe, rrjedhimisht, kam menduar që në kuadër, edhe nëpërmjet një logjike të balancës të fuqive dhe pushteteve, do të duhej të ishte Kuvendi me shumicë të cilësuar që ta marrë këtë vendim, në mënyrë që interesi i Kosovës ose mundësia për ta mbrojtur dhe avancuar interesin e Kosovës të jetë më e madhe.

Pra, konsideroj që 2/3 e Kuvendit është e domosdoshme në këtë mënyrë të të logjikuarit për ekonomi, për shkak se natyrisht që unë mendoj, dhe ne si grup mendojmë, që zgjidhja më e mirë për këtë çështje do të ishte krijimi i një korporate publike të thëngjillit në Kosovë, e cila pastaj do t'i kontrollonte të gjitha resurset minerale energjetike të Kosovës dhe në këtë mënyrë ajo si kompani e si korporatë do ta kishte pastaj mundësinë që të hyjë në marrëveshje kontraktuale me investitorë të ndryshëm për t'ua mundësuar atyre shfrytëzimin e thëngjillit të Kosovës, apo më mirë të them për t'ua shitur atyre thëngjillin e Kosovës për investimet e tyre dhe për angazhimin e tyre ekonomik.

Mirëpo, në kushtet çfarë jemi duke vepruar, pra me këtë mënyrë të funksionimit të shtetit dhe të logjikës ekonomike, zgjidhja më e mirë e mundshme tash për tash do të kishte me qenë kjo që të paktën 2/3 e deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës ta kenë të drejtën ekskluzive për të marrë vendime kaq të rëndësishme afatgjate dhe strategjike për ekonominë e Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Kryetari i Grupit të Aleancës, Ardian Gjini e ka fjalën. Kush është lajmëruar ia jap fjalën, vetëm pritni!

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryetar!

E kemi një sistem tepër interesant për këtë punë. Propozimi i Qeverisë po del që është për t'i anashkaluar institucionet e pavarura dhe procedurat aktuale të tenderimit. T'i kryejë punët vetë.

Në kushte normale nuk do të ishte ndonjë dilemë e madhe, domethënë përgjegjësia e tjera, e tjera, kur janë në rregull ka vende që e kanë, por ne nuk mund të bëjmë ashtu për shkak se kemi dilema tepër të mëdha se si të vazhdohet më tutje.

Propozimi i dytë, domethënë në njëfarë forme gati sa e tërheq prapë në të njëjtën vijë këtë sistem.

Propozimi i tretë e bën të pamundshme të merret ndonjë vendim. Po më duket që është goxha problem me hyjmë total në ndryshim të këtij ligji për shkak se cilido variant, përpos mënyrës ekzistuese, që e kemi, do të prodhojë probleme tepër të mëdha, ose bllokadë totale, ose shkuarje të shpejtë, siç u tha më përpara të aseteve dhe ta keni të qartë të gjithë. Nuk po flasim veç për thëngjillin. Ka edhe tema tjera, të cilat do të jenë pjesë e procedurave, nëse ky amendament kalon.

Unë nuk e di pse Kuvendi i Kosovës duhet të bëjë këso punësh. Nuk e di pse Qeveria duhet të bëjë këso punësh. Nëse ka ngecur 1, 2 ose 3 projekte, për 2 po e dimë, të tretin ndoshta nuk po dimë, nuk ka mundësi dhe nuk është e nevojshme ta çoroditim krejt sistemin për ta kaluar një breg të vogël. Duhet votuar kundër krejt Projektligjin për

ndryshim të ligjit për shkak se po duket që për derë të vogël ka hyrë një problem tepër i madh. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Sala Berisha-Shala.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit, kryetar!

Unë, meqenëse kam qenë pjesë e grupit punues të këtij projektligji prej fillimit, po e shoh të arsyeshme ta sqaroj opinionin publik, para së gjithash, por edhe kolegët deputetë, të cilët po shihet se nuk janë shumë të familjarizuar me këtë materie.

Po më vjen çudi pse zoti Gjini po kërkon të mos votohet fare ligji, sepse ky draftligj, kështu si i tillë, si ka ardhur, është shumë avancues, krahasuar me ligjin që ka qenë në fuqi.

Kur jemi te amendamenti në fjalë, unë dua t'ua përkujtoj kolegëve deputetë se ligji në fuqi te neni 18 i parasheh licencat që u nënshtrohen dhënies me proces konkurrues. Draftligjin, të cilin e ka punuar Komisioni Funkcional Parlamentar, është më i avancuar me propozimin e Qeverisë, e cila parasheh për mineralet energjetike, përkatësisht linjitin, që t'i nënshtrohet procesit konkurrues, por në qoftë se nuk ka më shumë të interesuar, të merret vendim, t'ia japë një investitori potencial dhe ky vendim të vijë në Kuvend, gjë që konsiderojmë se është demokratike dhe pastaj i njëjti vendim duhet t'u nënshtrohet procedurave të licencimit për hulumtim dhe për shfrytëzim në KPMM.

Prandaj, është mirë ta kuptojnë, edhe kolegja Teuta Sahatqija, edhe Ardian Gjini, se Kuvendi nuk jep licenca, por vetëm e merr një vendim si organi më i lartë demokratik dhe ligjvënës dhe pastaj të gjitha procedurat për licencim dhe kriteret që janë të parapara i lëshon KPMM-ja.

Tjetër? Propozimi i Lutfi Zharkut ia heq këtë mundësi Kuvendit si institucion demokratik dhe ligjvënës dhe ia lë vetëm Qeverisë dhe kjo mendoj që i rrezikon investitorët potencialë, sepse asnjë investitor nuk të vjen në qoftë se i mbetet kompetencë vetëm Qeverisë, por edhe në kushte demokratike që të mbetet dhe të merret vendim vetëm në Qeveri, sepse resurset, pasuritë nëntokësore, edhe me Kushtetutë janë pasuri të qytetarëve të Kosovës.

Dhe, propozimi tjetër, që është diametralisht i kundërt, i zotit Visar Ymeri, është 2/3 e Kuvendit ta miratojnë vendimin e Qeverisë, e duhet ta dimë se votimi me 2/3 në këtë rast është antikushtetues, sepse dihet se cilat çështje në Kuvend rregullohen me 2/3.

Prandaj, unë ju ftoj, kolegë deputetë, që ta votoni propozimin e Qeverisë, që e ka miratuar edhe Komisioni Funkcional, edhe Grupi Punues. Ligji i rregullon edhe shumë çështje tjera. Më lejoni në këtë rast veç t'i përmendi se çfarë zgjidhjesh ofron, në krahasim me ligjin që është në fuqi.

Ky ligj ofron zgjidhje shumë të rëndësishme që ka pasur mungesë të bazës ligjore për hulumtimin e naftës dhe të gazit. I shkurtton afatet e marrjes së licencave, me çka e krijon

një klimë të favorshme për biznese, të cilat bazohen në shfrytëzimin e pasurive nëntokësore dhe janë një shtyllë e madhe për zhvillimin ekonomik.

KRYETARI: Deputete, je jashtë rendit të ditës. Ne e kemi veç amendamentin 11.

SALA BERISHA-SHALA: Në qoftë se jam e qartë, unë kërkoj ta votoni propozimin e Komisionit Funkcional dhe të mos i votoni dy amendamentet, që i kanë dhënë Lidhja Demokratike dhe “Vetëvendosja”, të cilat janë pa përkrahjen e Komisionit Funkcional.

KRYETARI: Nejse, ai është një amendament. Ministër, e ke fjalën.

MINISTRI BESIM BEQAJ: Faleminderit, kryetar!

I nderuar kryeministër,

Dua ta bëj një sqarim se nuk kemi shkuarje prapa sa i përket procesit të transparencës. Ligji ekzistues, i cili është ligji bazik për miniera dhe minerale i jep të drejtë në këto rrethana Qeverisë për të negociuar, kur shihet se është çështja për siguri energjetike. Edhe pa shkuar në Kuvend, me një vendim të Qeverisë do të shkonte për ta arsyetuar KPMM-ja për dhënien e licencës me autorizim. Pra, ligji ekzistues e lejon edhe pa e pasur mundësinë për të shkuar në Kuvend.

Dua ta lexoj vetëm një pjesë të paragrafit që është dhënë në projekt-propozim të ligjit. Thotë: Komiteti i PPP-së i rekomandon Qeverisë vendimin për aprovim, me të cilin konstaton se ka interes publik në lëshimin e kësaj licence për një investitor specifik. Qeveria e nxjerr një vendim të tillë, të cilin e dërgon për miratim në Kuvend, e pas miratimit nga Kuvendi, KPMM-ja ia lëshon licencën e nevojshme investitorit.

(Reagime)

Sigurisht! Unë po e lexoj dokumentin, i cili e shpjegon shumë qartë dhe normalisht të gjitha ato gjëra, të cilat janë të parapara me këtë ligj, janë që ky ligj t’u mundësojë investitorëve një siguri më të madhe dhe ajo çka është jashtëzakonisht e rëndësishme është që vendimet për asete nacionale të interesit nacional merren në Kuvendin e Republikës së Kosovës por pjesa profesionale, e cila duhet të bëhet sa i përket dhënies së licencës, mbetet në KPMM, që është autoriteti i cili lëshon licenca për shfrytëzime të resurseve të tjera. Pra, ne bëjmë ftesë që të votohet amendamenti, i cili ka kaluar në Komision Funkcional dhe të mos aprovohen amendamentet, të cilat janë propozuar nga “Vetëvendosja” dhe LDK-ja. Faleminderit!

KRYETARI: Një amendament e kemi. Ju lutem, nuk kemi shumë amendamente. Fjalën për replikë e ka Visar Ymeri.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar!

Unë vetëm desha ta qartësoj një gjë. Nuk po e di se prej nga e ka marrë zonja deputete Sala këtë vlerësimin antikushtetues të amendamentit, që e kam propozuar unë, për shkak se, me sa jemi të informuar, ky ligj ka kaluar tashmë në Komisioni për Legjislacion dhe ata nuk kanë vlerësuar të ketë shpërputhje ndërmjet asnjërit prej amendamenteve dhe

Kushtetutës. Dhe, në këtë drejtim konsideroj se vlerësimi si antikushtetues i këtij amendamenti nuk është i qëndrueshëm fare për shkak se edhe me Kushtetutë, për t'ua tërhequr vëmendjen te neni 65, kompetencat e Kuvendit, pika 14 thotë që Kuvendi vendos për çështjet me interes të përgjithshëm. Unë nuk di a ka çështje me interes më të përgjithshëm dhe më të rëndësishëm për Kosovën se sa, kush dhe si do t'i shfrytëzojë ato asete strategjike, siç i përmendi ministri resurset e mineraleve energjetike të Kosovës.

Pra, konsideroj që pikërisht me votimin e këtij amendamenti, Kuvendi, jo vetëm që vendos për interes të përgjithshëm, por madje ia mundëson që vetë të marrë vendime të rëndësishme karshi kësaj çështjeje dhe t'ia kufizojë këtë ekskluzivitet Qeverisë, që është në interes, jo vetëm të Kuvendit, por të Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Ardian Gjini, replikë.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, kryetar!

Nuk e di çka ka të paqartë këtu edhe për ministrin, edhe për deputeten Sala Berisha-Shala. E kemi tepër të qartë. Qeveria po do t'i japë vetes mundësi të negociojë kontrata me një ofertues, nëse nuk ekzistojnë dy ofertues, ose tre, ose më tepër. Tepër e qartë është. Dhe është tepër e qartë pse po mendojmë që kështu është keq. Për shkak se historia e Qeverisë suaj, zoti ministër, është aq e keqe në këtë drejtim, sa nuk po u zëmë besë hiç. Nuk ka të bëjë kjo me parime, por ka të bëjë me ju, nuk mund t'u zëmë besë. Dhe kaq është pse. Nëse keni diçka të paqartë tjetër, mund t'u them ende. Faleminderit!

KRYETARI: Deputetja Teuta Sahatqija e ka fjalën.

TEUTA SAHATQIJA: Faleminderit, kryetar!

Mendoj që asnjëri deputet këtu nuk duhet ta marrë të drejtën e të shndërrohet në mësues apo mësuese të deputetëve tjerë. Secili deputetë e ka të drejtën të flasë. Mësueset edhe mësuesit i kemi kaluar moti. Përndryshe, në qoftë se ia nis, atëherë le të shkojë e le t'i mësojë edhe ata të Bankës Botërore që na kanë dërguar secilit prej nesh, e le të bëhet mësuesja edhe e saj.

Në anën tjetër, ku është dallimi? Ministrin, kur foli, e pritja deri te fjala, në të cilën në mënyrë shumë elegante e tejkaloi dhe tha 'KPMM-ja lëshon'. Nuk thuhet në propozimin tuaj 'KPMM-ja lëshon', po e lexoj: "Pas miratimit nga Kuvendi, KPMM duhet t'i lëshojë", domethënë me atë votimin politik Kuvendi e urdhëron KPMM-në, që duhet të lëshojë licencë". Në propozimin e zotit Lutfi Zharku, në të njëjtin vend thuhet që i rekomandon KPMM-së lëshimin e licencës për investime, me kusht që investitori të përmbushë. Këtu nuk e kemi fjalën për investime, por për lëshimin e licencës dhe mënyrën se si do të lëshohet licenca.

Prandaj, mendoj që duhet të votohet dhe kërkoj prej deputetëve ta votojnë amendamentin numër 11 të deputetit Lutfi Zharku, pa tendencë për t'i mësuar deputetët çfarë duhet dhe çfarë nuk duhet të bëjnë.

KRYETARI: Zenun Pajaziti e ka fjalën. Vetëm ju lutem, ata që e marrin fjalën nga dy herë, le të flasin shkurt.

ZENUN PAJAZITI: Mendoj që ka ardhur një kohë kur edhe me intonacion po interpretohet ajo që është shkruar këtu. Mendoj që duhet të jetë shumë e qartë.

E para, grupi punues ka punuar shumë gjatë dhe gjithë faktorët relevantë, përveç deputetëve, Qeverisë, KPMM-së, kanë qenë të pranishëm për ta bërë një version, të cilin sot e keni para jush, të aprovuar prej Komisionit FunkSIONAL, i cili po kërkohet për t'u votuar. Ka pasur edhe propozime të deputetëve, që janë propozime të veçanta, të cilat nuk kanë kaluar në Komision.

Propozimi i Grupit Punues dhe rrjedhimisht i Komisionit është në njëfarë mënyre një qëndrim i ndërmjetëm. Është fjala për investime shumë të mëdha që mund të bëhen në Kosovë dhe ato as të mos mbeten prej ndryshimeve elementare nëpër Qeveri, po as mos të mbeten për t'i numëruar ose për t'i nxjerrë votat 2/3 e tjerë.

Është edhe një diçka që duhet të sqaroj këtu, se u interpretua keq. Pasi të miratohet në Kuvend, KPMM-ja e lëshon licencën, por pa anashkaluar. Lexojeni mirë! Pa i anashkaluar të gjitha ato kritere që janë me dispozita të aplikueshme të këtij ligji. Pra, nuk ia jep mundësinë KPMM-së në mënyrë të njëanshme të japë licencë, por kërkon të aprovohet, ose kërkohen kriteret të cilat janë të sakta në ligj dhe thuhet po ashtu për KPMM-në.

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën.

MINISTRI BESIM BEQAJ: Faleminderit, kryetar!

Kryeministër,

Ministër, deputetë, vetëm për hir, edhe të deputetëve, edhe të opinionit - ligji aktual i lejon Qeverisë të shkojë të negociojë pa e sjellë këtë vendim në Kuvend. Ajo çka jemi kah kërkojmë ne me këtë ligj, është të mos jetë i vetëm vendimi i Qeverisë për një veprim të tillë, por vendimi të merret në Parlament. Kjo është kërkesa sa i përket pjesës së parë.

Ndërsa deputeti Pajaziti e tha shumë mirë që, nëse e lexojmë tërë fjalinë, thotë: KPMM duhet t'ia lëshojë licencën atij investitori me kusht që kushtet e licencës të jenë në përputhshmëri me dispozitat e aplikueshme të këtij ligji dhe investitori i përmbush të gjitha kriteret e kualifikimit, të përcaktuara sipas këtij ligji. Faleminderit!

KRYETARI: Shkojmë në procedurën e votimit.

Amendamenti 11.

I kemi dy propozime: propozimi i parë është i deputetit Lutfi Zharku, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. Të pranishëm janë 88 deputetë.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Me 22 vota për, 55 kundër, 1 abstenim, nuk kalon amendamenti, propozimi i deputetit Lutfi Zharku.

Tani e kemi propozimin e deputetit Visar Ymeri, pa përkrahjen e Komisionit Funkcional. Votojmë tash!

Me 29 vota për, 49 kundër, 1 abstenim, nuk miratohet as amendamenti i propozuar nga deputeti Visar Ymeri. Mbetet siç ka qenë.

Vazhdojmë.

Amendamenti 12.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 13.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 14.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 15.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 16.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 17.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 18.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 19.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 20

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 21.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 22.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 23.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 24.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 25.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 26.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 27.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 28.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 29.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 30. Zenun Pajaziti e ka fjalën.

ZENUN PAJAZITI: Le të shkohet në votim, zoti kryetar, sikur në amendamentin 10, meqenëse është një propozim i ministrit për 2 këto amendamente.

KRYETARI: E hedhim në votim me elektronikë amendamentin 30, i Komisionit. Të pranishëm janë 84 deputetë. Votojmë tash!

Konstatohet se me 26 vota për, 44 kundër, 2 abstenime, nuk kalon amendamenti 30.

Amendamenti 31.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 32.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 33.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 34.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 35.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 36.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 37.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 38.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 39.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 40.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Lus deputetët dhe regjinë që ta votojmë ligjin në tërësi. Të pranishëm në sallë janë 84 deputetë, 48 me kartelë. Votojmë tash!

Konstatohet se me 44 vota për, 16 kundër, 2 abstenime, Kuvendi e miratoi Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për minierat dhe mineralet.

Pika e dhjetë e rendit të ditës:

10. Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit për Radiotelevizionin e Kosovës

Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 25 mars 2013, ka kërkuar nga grupet parlamentare që Kuvendit deri më 28 mars 2013 t'i propozojë deputetët për anëtarë të Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit.

Komisionit duhet të përbëhet prej 9 anëtarësh. I ftoj kryetarët grupeve parlamentare që t'i propozojnë deputetët për anëtarë të Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës.

Fjalën e ka kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, deputeti Adem Grabovci.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, kryetar!

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës për këtë Komision i propozon Idriz Vehapin dhe Xhevahire Izmakun.

KRYETARI: Kryesues, cilin prej tyre e propozoni?

ADEM GRABOVCI: Zotin Idriz Vehapi.

KRYETARI: Lidhja Demokratike e Kosovës, kryetari Ismet Beqiri.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zoti kryetar!

Ne i propozojmë dy deputetë: zonjën Lirije Kajtazi dhe zotin Ali Sadriu.

KRYETARI: Deputetja Lirije, do të thotë zëvendëskryesues? A jeni dakord Lidhja Demokratike? Mirë. Lëvizja “Vetëvendosje”, e keni një propozim.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar!
Grupi Parlamentar i “Vetëvendosje” e propozon Albulena Haxhiun.

KRYETARI: Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e ndërroi kryetarin. Xhevahire Izmaku është kryetare. Grupi parlamentar i AAK-së, kryetari Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryetar!
Grupi Parlamentar i Aleancës e propozon deputeten Teuta Haxhiu për anëtare të Komisionit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!
Grupi Parlamentar i Koalicionit për Kosovë të Re, kryetarja Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, kryetar!
Koalicioni për Kosovë të Re propozon deputetin Jeton Svirca.

KRYETARI: Faleminderit!
Grupi Parlamentar SLS, Sasha a është këtu?

SAŠA MILOSAVLJEVIĆ: Hvala predsedniče!
SLS predlaže Jelenu Bontić za člana ad hoc komisije.

KRYETARI: Faleminderit! Grupi “6+”?

MYFERA SHINIK: Grupi “6+” e propozon deputetin Fikrim Damka.

KRYETARI: Faleminderit!
Na duhet një votim formal. 81 deputetë janë të pranishëm. Votojmë tash!
Votojmë me elektronikë.

Konstatohet se me 65 vota për, 2 kundër, 1 abstenim, u miratua Komisioni ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit për Radiotelevizionin e Kosovës.

Kërkohej nga Komisioni ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës që të veprojnë në përputhje me nenin 26, pika 2,3 të Ligjit, nr. 04/L-046 për Radiotelevizionin e Kosovës.

E kemi pikën e njëmbëdhjetë:

11. Formimi i Komisionit ad hoc për formimin e Komisionit Hetimor Parlamentar sipas kërkesës të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, mbështetur edhe nga deputetët e tjerë

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, i mbështetur edhe nga deputetët e tjerë, gjithsej 41 deputetë nënshkrues, në bazë të nenit 77, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 4, pika 3 të Ligjit për hetimet parlamentare, nenit 69, pika 2, dhe nenit 71, pika 1 të Rregullores së Punës së Kuvendit, ka kërkuar formimin e Komisionit Hetimor Parlamentar lidhur me faturimin e shpenzimit të rrymës elektrike për muajin janar 2013, kohës së llogaritjes sipas tarifës së lirë të njësorëve digjitalë dhe masave të ndërmarra në lidhje me këtë rast.

Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e përbashkët me kryetarët e grupeve parlamentare, të mbajtur më 25 mars 2013, ka kërkuar nga grupet parlamentare që deri në mbledhjen e sotme t'i propozojnë deputetët për anëtarë të Komisionit Hetimor Parlamentar.

KËSHILLË JURIDIKE:

Përbërja e Komisionit është definuar me nenin 8 të Ligjit për hetimin parlamentar, sipas të cilit:

- Komisioni përbëhet nga jo më pak se 7 dhe jo më shumë se 15 anëtarë;
- Numri i anëtarëve të Komisionit duhet të jetë gjithnjë tek,
- Çdo grup parlamentar i Kuvendit përfaqësohet në komision me së paku me 1 anëtarë,
- Në parim, gjatë përcaktimit të përbërjes së Komisionit, duhet të merret parasysh proporcioni i përfaqësimit të grupeve parlamentare në Kuvend.

Megjithatë, Komisioni duhet të përbëhet nga deputetë të partive të pozitës dhe të opozitës në raport sa më të përafërt të përfaqësimit. Diferenca e anëtarëve të përgjithshëm në raportin pozitë-opozitë në Kuvend nuk mund të jetë më shumë se 1 anëtar i Komisionit.

Sipas nenit 10, paragrafit 1 të Ligjit për hetimin parlamentar, kryesuesi emërohet nga Kuvendi me rastin e themelimit të Komisionit. Kryesuesi zgjidhet nga radhët e njërit grup parlamentar, i cili nuk është iniciator i Komisionit hetimor dhe nuk i përket partisë së koalicionit qeverisës. Zëvendëskryesuesi emërohet nga Kuvendi me propozim të iniciatorit, ose grupit iniciator të Komisionit.

Tani e kemi formulën: 9 dhe 11. Nëse shkojmë me formulën 9, dy grupet më të mëdha parlamentare i propozojnë nga 2 kandidatë, të tjerat nga 1. Nëse shkojmë me 11, dy grupet parlamentare më të mëdha propozojnë nga 3 dhe tjerat gjithashtu nga 1.

Si po shkojmë, me 9 apo 11?

Njëmbëdhjetë. Pasi kërkuesi është Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike, fjalën e ka kryetari Ismet Beqiri.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zoti kryetar!

E keni marrë propozimin, propozimi ynë është 11 dhe qëndrojmë në këtë propozim dhe, nëse më lejoni, do t'i bëja edhe propozimet tash, apo ta arsyetoj këtë kërkesë që e kemi, sepse që të gjithë e dimë që...

KRYETARI: Formulën që e keni propozuar, bie ndesh pak me ligjin, prandaj ne po shkojmë në 12. Unë çfarë ka propozuar, e dini edhe ju. Urdhëro kryetar, e ke fjalën.

ISMET BEQIRI: Unë po e them propozimin tonë, pastaj të shohim cila pjesë bie ndesh me Rregulloren.

Duke u mbështetur në nenin përkatës të Kushtetutës dhe në qëndrimin, përkatësisht përfundimin e Kryesisë së Kuvendit të Kosovës, të datës 25 mars 2013, lidhur me kërkesën e Grupit Parlamentar të LDK-së për formimin e Komisionit Hetimor Parlamentar, grupi ynë parlamentar, në mbështetje të autorizimeve dhe kompetencave të veta, propozon që deputetët e Grupit Parlamentar, zonja Teuta Sahatqija dhe Ali Sadriu të jenë anëtarë të Komisionit, ndërsa atë që e thatë ju, formulë për grupet tjera, që është e qartë që bëjnë 9, në propozimin tonë kërkojmë që në këtë grup të shtohen: përpos nëntëve, edhe dy të tjerë, edhe atë dy deputetë të pavarur, sepse edhe ata janë deputetë të këtij Parlamenti dhe e përfaqësojnë dikë këtu, edhe atë Muhamet Mustafa dhe Agim Kuleta.

Për kryetar të Komisionit Hetimor Parlamentar ne e propozojmë zotin Muhamet Mustafa, ndërkaq si grup iniciues, që na takon, për zëvendëskryetar e propozojmë zonjën Teuta Sahatqija. Të ju them edhe që në marrëveshje me deputetët e pavarur, unë kam biseduar me ta, ata janë të pavarur dhe, fundi i fundit, Komisioni i tillë do të duhej të ishte, ata kanë pranuar që të jenë pjesë e këtij Komisioni. Faleminderit!

KRYETARI: Unë nuk kam problem me asnjërin nga ata, por kam problem vetëm me ligjin. Pika 3 e ligjit thotë: Çdo grup parlamentar i Kuvendit përfaqësohet në Komision me së paku një anëtar. Nuk i parasheh deputetë pa grup parlamentar. Nëse shkojmë me 11, grupi i Partisë Demokratike dhe ai i Lidhjes Demokratike t'i propozojnë nga 3 anëtarë.

Atëherë shkojmë sipas rendit. Kuvendi le të marrë vendim. A po shkojmë me 11 anëtarë? Kush është për? Kundër, a ka? Shumica absolute ishte për 11 anëtarë. Tash i propozojmë.

Kryetari i Grupit, Adem Grabovci, e ka fjalën.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, kryetar!

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike normalisht se e përkrah formimin e këtij Komisioni, me besimin se do t'i ndihmojë organet kompetente që ta konstatojnë shkallën e përgjegjshmërisë dhe fajtorët për faturat në KEK për situatën e krijuar. Ne në këtë Komision i propozojmë:

1. Ramiz Lladrovcin,
2. Behar Selimin dhe
3. Fadil Demakun.

KRYETARI: Kryetari i Lidhjes Demokratike, Ismet Beqiri e ka fjalën.

ISMET BEQIRI: Faleminderit! Ne i propozojmë:

1. Zonjën Teuta Sahatqija,
2. Zotin Ali Sadriun dhe
3. Zotin Muhamet Mustafa.

Edhe një herë po e përsëris, si grup iniciues, ne propozojmë që zoti Mustafa ta kryesojë këtë Komision, ndërkaq zëvendëse të jete zonja Sahatqija. Faleminderit!

KRYETARI: Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje”, deputetja Albulena Haxhiu.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit kryetar!
Lëvizja “Vetëvendosje” e propozon Visar Ymerin në këtë Komision. Faleminderit!

KRYETARI: Grupi Parlamentar Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, Ardian Gjini e ka fjalën.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryetar!
E propozojmë deputeten Donika Kada-Bujupi për anëtare të Komisionit. Faleminderit!

KRYETARI: Koalicioni për Kosovë të Re, deputetja Myzejene Selmani, kryetare e Grupit, e ka fjalën.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit kryetar!
Duke marrë parasysh se Koalicioni për Kosovë të Re e përkrah çështjen e formimit të Komisionit Hetimor Parlamentar, mirëpo gjatë debatit atë ditë ka qenë çështja e faturimit të shpenzimit të rrymës elektrike për janar 2013, koha e llogaritjes sipas tarifës së lirë, nuk e dimë në çështjen e dimrit çfarë tarifash të lira mund të ketë pas kur të gjithë e dimë se a ty është çështja që tarifat në kohën e dimrit janë më të shtrenjta, mirëpo prapëseprapë ne e përkrahim këtë Komision dhe e propozojmë zonjën Suzana Novobërdaliu.

KRYETARI: Faleminderit! Grupi SLS-së, Sasha Milosavleviq e ka fjalën.

SAŠA MILOSAVLJEVIĆ: Hvala predsedniče!
SLS predlaže Gorana Marinkovića za člana te Komisije.

KRYETARI: Faleminderit! Grupi “6+”, kryetarja Myfera ka fjalën.

MYFERA SHINIK: Faleminderit, kryetar!
Grupi “6+” e propozon deputetin Albert Kinolli

KRYETARI: Faleminderit! I kemi pra të propozuar 11 anëtarë deputetë për anëtarë të Komisionit Hetimor. Të pranishëm i kemi 81 deputetë. Shkojmë në një votim formal. Veç ta sqaroj, kryesues a kryetar është Muhamet Mustafa, zëvendëskryesues është Teutë Sahatqija, të tjerët janë anëtarë të Komisionit.

Kush është për? Faleminderit! A ka kundër? Janë tri vota kundër. Me shumicë absolute, u formua Komisioni.

Kërkohet nga Komisioni Hetimor Parlamentar që të veprojë në përputhje me Ligjin nr. 03/L-176 për hetim parlamentar dhe Kuvendit t’ia paraqesë raportin me rekomandime në afat prej 2 muajve nga dita e formimit.

Ju i keni kërkuar dy muaj, por mirë. Ta kenë parasysh dy muaj, nëse nuk mund për dy muaj, e vazhdojnë. A jeni dakord? Në rregull.

(Reagime nga salla)

Edhe pak durim! Kalojmë në pikën e dymbëdhjetë:

12. Zgjedhja e nënkryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës nga radha e komuniteteve joshumicë

Deputeti Enis Kervan e ka njoftuar Kryesinë e Kuvendit se e ka liruar pozitën e nënkryetarit të Kuvendit.

E ftoj kryetaren e Grupit Parlamentar “6+”, Myfera Shinik, që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë qëndrimin e Grupit Parlamentar për marrëveshjen e arritur për caktimin e nënkryetarit të Kuvendit nga radhët e komuniteteve të tjera, që nuk janë shumicë. Deputete, e ke fjalën!

MYFERA SHENIK: Faleminderit, kryetar!

Në bazë të kësaj shkrese, sipas marrëveshjes të grupit të deputetëve jo shumicë dhe joserb, turk, boshnjak dhe ashkali, dhe deputetit Etem Arifi, nga Partia e Ashkalinjve për Integrim, më 1 mars 2013, kemi arritur marrëveshje për vendin e anëtarit të Kryesisë me rotacion dhe atë si në vijim dhe këtë e vërtetojnë nënshkrimet tona të poshtëshënuara:

1. Enis Kervan,
2. Myfera Shinik,
3. Fikrim Damka,
4. Albert Kinolli,
5. Rasim Demiri,
6. Etem Arifi dhe
7. Duda Bala

KRYETARI: Kë e propozoni?

MYFERA SHINIK: E propozojmë Rasim Demirin.

KRYETARI: Këtë e keni për 6 muaj, pas gjashtë muajve e keni të propozuar Albert Kinollin.

Ne e votojmë marrëveshjen tuaj. Nuk ka diskutim, ju lutem! Po ju tregoj që Grupi Joformal i Grave nuk përzihet në këtë çështje. Është çështje e komuniteteve joshumicë. Prandaj, unë po kërkoj nga çdo grup formal dhe joformal të jetë në detyrën e përgjegjësive që e ka. Mos të dalë jashtë përgjegjësive të veta.

Për përzgjedhjen e nënkryetarit të Kuvendit, sipas nenit 67, paragrafi 4 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nevojitet shumica e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit, pra së paku 61 vota. Të pranishëm janë 81 deputetë.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash!

(Reagime nga salla)

Kjo nuk është punë imja, por e Kuvendit, prandaj ju them që asnjë grup formal e joformal nuk do të duhej të përzihet në këtë çështje. Ju lutem, nuk ka kaluar. Duhet 61 vota. Nuk janë aq sa duhet, “për” janë 45, “kundër” 6, të tjerët nuk kanë votuar. Jo, për këtë seancë nuk kemi votim tjetër.

Mirupafshim në seancën e radhës!

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*